



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

Udhëzues për nenin 5 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut

E drejta për liri dhe siguri

Përditësuar më 31 gusht 2025

Përgatitur nga Kancelaria. Nuk detyron për Gjykatën.

Botuesit ose organizatat që dëshirojnë ta përkthejnë dhe/ose ta riprodhojnë të plotë a pjesërisht këtë raport, në trajtë botimi të shtypur apo elektronik, ftohen që të plotësojnë formularin e kontaktit: [kërkesë për riprodhim ose ribotim të një përkthimi](#) për informacion mbi procedurën e autorizimit.

Nëse dëshironi të dini për përkthimet e Udhëzuesve të praktikës gjyqësore që janë në proces, ju lutemi që të shih listën e [përkthimeve në proces](#).

Ky Udhëzues fillimisht u hartua në gjuhën angleze. Ai përditësohet rregullisht dhe më së fundi më 31 gusht 2025. Mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Udhëzuesit e praktikës gjyqësore mund t'i shkarkoni në <https://ks.echr.coe.int>. Për përditësime të botimit ju lutemi që të ndiqni llogarinë X të Gjykatës në https://x.com/ECHR_CEDH.

Ky përkthim është përgatitur dhe botuar në kuadër të Projektit të Këshillit të Evropës “*Rritja e kapaciteteve të gjyqësorit për zbatimin më të mirë të standardeve të së drejtës për liri dhe siguri në Shqipëri*” financuar nga **Fondi I Mirëbesimit për të Drejtat e Njeriut**, i cili bashkon tetë shtete anëtare të Këshillit të Evropës: Finlandën, Gjermaninë, Irlandën, Luksemburgun, Holandën, Norvegjinë, Zvicrën dhe Mbretërinë e Bashkuar.

© Këshilli i Europës/Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, 2026

Tabela e Përmbajtjes

Shënim për lexuesit	6
I. Fusha e zbatimit	8
A. Privimi i lirisë.....	8
B. Kriteret që duhen zbatuar.....	9
C. Masat e marra në burg	10
D. Kontrolli i sigurisë së pasagjerëve ajrorë.....	10
E. Privimi i lirisë në raste të tjera, përveç arrestimit formal ose të paraburgimit	10
F. Detyrime pozitive lidhur me privimin e lirisë.....	11
II. Ligjshmëria e privimit nga liria sipas nenit 5 § 1.....	12
A. Qëllimi i nenit 5.....	12
B. Pajtueshmëria me të drejtën kombëtare	12
C. Shqyrtimi i pajtueshmërisë me të drejtën kombëtare	13
D. Parime të përgjithshme	13
E. Parimi i sigurisë juridike	13
F. Mungesa e arbitraritetit.....	15
G. Vendim gjykate.....	15
H. Arsyetimi i vendimeve dhe kërkesa e mungesës së arbitraritetit	16
I. Shembuj të metash procedurale të pranueshme	16
J. Vonesa në ekzekutimin e vendimit të lirimit.....	17
III. Privimet e lirisë të lejuara nga neni 5 § 1	17
A. Burgimi që pason dënimin.....	17
1. Ekzistenca e dënimit	17
2. Gjykata kompetente	18
3. Burgimi duhet të vijë“pas” një dënimi.....	18
4. Ndikimi i proceseve të ankimimit	19
B. Burgimi për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata ose mospërbushje të një detyrimi të parashikuar me ligj.....	20
1. Moszbatimi i një urdhri të dhënë nga gjykata	20
2. Përbushja e një detyrimi të parashikuar me ligj.....	21
C. Paraburgimi.....	22
1. Qëllimi i arrestimit ose paraburgimit.....	22
2. Kuptimi i “dyshimit të arsyeshëm”	23
3. Termi “vepër penale”	25
D. Ndalimi i një të mituri	26
1. Të përgjithshme	26
2. Mbikëqyrja arsimore.....	26
3. Autoriteti kompetent ligjor	27
E. Ndalimi për arsye mjekësore ose sociale.....	27
1. Të përgjithshme	27
2. Parandalimi i përhapjes së një sëmundjeje ngjitëse.....	28

3. Ndalimi i personave të sëmurë mendërisht	28
4. Ndalimi i një të alkoolizuari dhe i një narkomani	31
5. Endacakët.....	31
F. Ndalimi i të huajve	31
1. Ndalimi për parandalimin e hyrjes së paautorizuar në territor	31
2. Ndalimi i një personi për qëllim dëbimi ose ekstradimi	33

IV. Garancitë për personat e privuar nga liria 35

A. Njoftimi i arsyeve të arrestimit (neni 5 § 2).....	35
1. Zbatueshmëria	35
2. Qëllimi	35
3. Cilëve persona duhet t’u jepen arsyet.....	35
4. Arsyet duhet të jepen “ sa më shpejt”	36
5. Mënyra e dhënies së arsyeve.....	36
6. Niveli i kërkuar i arsyeve	36
7. Në një gjuhë që kupton.....	37
B. E drejta për t’u çuar menjëherë përpara një gjyqtari (neni 5 § 3).....	38
1. Qëllimi i dispozitës	38
2. Kontroll gjyqësor i shpejtë dhe automatik.....	38
3. Natyra e zyrtarit gjyqësor të përshtatshëm.....	39
4. Pavarësia	40
5. Kërkesa procedurale	40
6. Kërkesa substanciale.....	40
a. Kontrolli i i themelit të paraburgimit	40
b. Kompetenca për të urdhëruar lirimin.....	41
C. E drejta për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ose për t’u liruar në pritje të gjyqimit (neni 5 § 3)	41
1. Periudha që duhet të merret parasysh.....	41
2. Parime të përgjithshme	42
3. Përligjja e çdo lloj periudhe paraburgimi.....	43
4. Shkaqet për paraburgimin vazhdues	43
a. Rreziku i arratisjes.....	43
b. Pengimi i procedimit.....	44
c. Përsëritja e veprave penale	44
d. Ruajtja e rendit publik	44
5. Kujdesi i veçantë (diligjenca e posaçme)	45
6. Masa alternative	45
7. Garancia pasurore.....	45
8. Paraburgimi i të miturve	46
D. E drejta për shqyrtimin pa vonesë të ligjshmërisë së paraburgimit nga një gjykatë (neni 5 § 4).....	46
1. Qëllimi i dispozitës	46
2. Zbatueshmëria e dispozitës	47
3. Natyra e kontrollit (shqyrtimit) të kërkuar	48
4. Garanci procedurale	50
5. Kërkesa për “shpejtësi”.....	52
a. Periudha që duhet të merret në konsideratë.....	53
b. Elemente të rëndësishme që duhet të merren parasysh në vlerësimin e shpejtësisë.....	53
E. E drejta e dëmshpërblimit për paraburgim të paligjshëm (neni 5 § 5).....	54

1. Zbatueshmëria	54
2. Mjeti juridik gjyqësor	55
3. Mundësia e dëmshpërblimit.....	55
4. Natyra e dëmshpërblimit	55
5. Ekzistenca e dëmit	56
6. Shuma e dëmshpërblimit.....	56
Lista e çështjeve të cituara.....	57

Shënim për lexuesit

Ky Udhëzues është pjesë e serisë së Udhëzuesve për Konventën të botuar nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (këtu e më poshtë "Gjykata", "Gjykata Europiane" ose "Gjykata e Strasburgut") për të informuar profesionistët e së drejtës mbi vendimet e themelit dhe vendimet e pranueshmërisë të dhëna nga Gjykata e Strasburgut. Ky Udhëzues i veçantë analizon dhe përmbledh praktikën gjyqësore për Nenin 5 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (këtu e më poshtë "Konventa" ose "Konventa Europiane"). Këtu lexuesit do të gjejnë parimet kyçe në këtë fushë dhe precedentët përkatës.

Praktika gjyqësore e cituar është përzgjedhur mes vendimeve kryesuese, kryesore dhe/ose të kohëve të fundit.*

Vendimet e Gjykatës shërbejnë jo vetëm për të vendosur për ato çështje të paraqitura para saj, por, në përgjithësi, për të sqaruar, mbrojtur dhe zhvilluar rregullat e vendosura nga Konventa, duke kontribuar kështu në respektimin e angazhimeve të ndërmarra nga Shtetet si Palë Kontraktuese (*Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 154, 18 janar 1978, Seria A nr. 25, dhe, së fundmi, *Jeronovičs kundër Letonisë* [DHM], nr. 44898/10, § 109, 5 korrik 2016).

Pra, misioni i sistemit të krijuar nga Konventa është të përcaktojë çështje të politikave publike me interes të përgjithshëm, duke rritur kështu standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe duke zgjeruar jurisprudencën e të drejtave të njeriut në të gjithë komunitetin e Shteteve të Konventës (*Konstantin Markin kundër Rusisë* [DHM], § 89, nr. 30078/06, GJEDNJ 2012). Në fakt, Gjykata ka theksuar rolin e Konventës si një "instrument kushtetues i rendit publik europian" në fushën e të drejtave të njeriut (*Bosphorus Hava Yolları Turizm ve Ticaret Anonim Şirketi kundër Irlandës* [DHM], nr. 45036/98, § 156, GJEDNJ 2005-VI, dhe së fundmi, *N.D. dhe N.T. kundër Spanjës* [DHM], nr. 8675/15 dhe 8697/15, § 110, 13 shkurt 2020).

Protokolli nr. 15 i Konventës së fundmi e përfshiu parimin e subsidiaritetit në Preambulën e Konventës. Ky parim "imponon përgjegjësi të përbashkët ndërmjet Shteteve Palë dhe Gjykatës" në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe autoritetet kombëtare dhe gjykatat duhet ta interpretojnë dhe të zbatojnë legjislacionin e brendshëm në një mënyrë që çon në zbatimin e plotë të të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë dhe Protokollet e saj (*Grzęda kundër Polonisë* [DHM], § 324).

Ky Udhëzues përmban referenca për fjalë kyçe për secilin nen të cituar të Konventës dhe Protokolleve të saj Shtesë. Çështjet ligjore të trajtuara në secilin rast janë përmbledhur në një *Listë fjalësh kyçe*, të zgjedhura nga një fjalor termash të marrë (në shumicën e rasteve) direkt nga teksti i Konventës dhe Protokolleve të saj.

Baza e të dhënave HUDOC e praktikës gjyqësore të Gjykatës mundëson kërkimin sipas fjalëve kyçe. Kërkimi me këto fjalë kyçe mundëson gjetjen e një grupi dokumentesh me përmbajtje të ngjashme ligjore (arsyetimet dhe konkluzionet e Gjykatës në secilën çështje përmbledhen përmes fjalëve kyçe). Fjalët kyçe për çështje të veçanta mund të gjenden duke klikuar në Detajet e Çështjes në HUDOC. Për më shumë informacion rreth bazës së të dhënave HUDOC dhe fjalëve kyçe, ju lutemi shih *manualin e përdoruesit të HUDOC*.

Praktika gjyqësore e cituar mund të jetë në njërin ose të dyja gjuhët zyrtare (Anglisht dhe Frëngjisht) të Gjykatës dhe Komisionit Europian të të Drejtave të Njeriut. Përveçse kur tregohet ndryshe, të gjitha referencat bëhen për një vendim themeli të dhënë nga një Dhomë e Gjykatës. Shkurtimi "(vend. pran.)" tregon që citimi është marrë nga një vendim i Gjykatës dhe "[DHM]" që çështja është gjykuar nga Dhoma e Madhe. Vendimet e Dhomës që nuk ishin përfundimtare kur u publikua ky përditësim janë shënuar me një yll ().

Neni 5 i Konventës - E drejta për liri dhe siguri

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet e mëposhtme dhe në përputhje me procedurat e parashikuara me ligj:

- a) kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;
- b) kur arrestohet ose burgoset ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;
- c) kur është arrestuar dhe paraburgosur për t’u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka dyshim i arsyeshëm se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;
- d) kur një i mitur ndalohet ligjërisht, për qëllim edukimi të mbikëqyrur, ose për ndalimin e tij të ligjshëm, me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor;
- e) kur individët ndalohen ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve;
- f) kur një person arrestohet ose ndalohet ligjërisht, me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose për një person kundër të cilit është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi;

2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.

3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatësi ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet nga garanci për t’u paraqitur para gjykatës.

4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.

5. Çdo person, që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, ka të drejtën e zbatueshme të dëmshpërblimit.

Fjalët kyçe të HUDOC

1. Liria e personit (5-1) – Siguria e personit (5-1) – Privimi i lirisë (5-1) – Procedura e parashikuar me ligj (5-1) – Arrestim ose burgim i ligjshëm (5-1)
 - (a) Dënim (5-1-a) – Pas dënimit (5-1-a) – Gjykata kompetente (5-1-a)
 - (b) Urdhër i ligjshëm i një gjykate (5-1-b) – Moszbatimi i urdhrit të gjykatës (5-1-b) – Garantimi i përmbushjes së detyrimit të parashikuar me ligj (5-1-b)
 - (c) sjellja përpara autoritetit gjyqësor kompetent (5-1-c) - Vepër penale (5-1-c) - Motive të arsyeshme (5-1-c) - E nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale (5-1-c) - E nevojshme që të largohet pas kryerjes së saj (5-1-c)
 - (d) I mitur (5-1-d) - Edukimi i mbikëqyrur (5-1-d) - Sjellja përpara autoritetit kompetent ligjor (5-1-d)
 - (e) Parandalimi i përhapjes së sëmundjeve infektive (5-1-e) - Personave të sëmurë mendërisht (5-1-e) - Alkoolistë (5-1-e) - Narkomanëve (5-1-e) - Endacakë (5-1-e);
 - (f) Ndalim i hyrjes së paautorizuar në vend (5-1-f) - Dëbim (5-1-f) - ekstradim (5-1-f)
2. Informacion brenda një afati sa më të shkurtër (5-2) - Informacion në një gjuhë që ai e kupton (5-2) - Informacion për akuzën.
3. Gjyqtar ose zyrtari tjetër që ushtron funksione gjyqësore (5-3) - I sjellë përpara një gjyqtari ose zyrtari tjetër (5-3) - Gjykim brenda një afati të arsyeshëm (5-3) - Lirimi në pritje të gjykimit (5-3) - Kohëzgjatja e paraburgimit (5-3) - Arsyetimi i paraburgimit (5-3) - Lirimi me kusht (5-3) - Garanci për t'u paraqitur para gjykatës (5-3).
4. Rishikim i ligjshmërisë së burgimit (5-4) - T'i drejtohet gjykatës (5-4) - Rishikimi nga gjykata (5-4) - Shpejtësia e rishikimit (5-4) - Garancitë procedurale të rishikimit (5-4) - Urdhër lirimi (5-4)
5. Dëmshpërblim (5-5)

I. Fusha e zbatimit

Neni 5 paragrafi 1 i Konventës

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet e mëposhtme dhe në përputhje me procedurat e parashikuara me ligj: ...”

Fjalët kyçe të HUDOC

Liria e personit (5-1) – Siguria e personit (5-1) – Privimi i lirisë (5-1) – Procedura e parashikuar me ligj (5-1) – Arrestim ose burgim i ligjshëm (5-1)

A. Privimi i lirisë

1. Duke shpallur “të drejtën e lirisë”, neni 5 i referohet lirisë fizike të personit; synimi i tij është të sigurojë që askush të mos privohet nga kjo liri në mënyrë arbitrare. Ai nuk ka të bëjë me kufizimet e thjeshta ndaj lirisë së lëvizjes, të cilat rregullohen nga neni 2 i Protokollit nr.4 (*De Tommaso kundër Italisë* [DHM], 2017, § 80; *Creangă kundër Rumanisë* [DHM], 2012, § 92; *Engel dhe të tjerë kundër Holandës*, 1976, § 58).

2. Dallimi ndërmjet kufizimeve ndaj lëvizjes që janë mjaftueshëm të rënda për t'u cilësuar si privimi i lirisë sipas nenit 5 § 1 dhe kufizimeve të thjeshta të lirisë që i nënshtrohen vetëm nenit 2 të Protokollit nr.4 ka të bëjë me shkallën ose intensitetin dhe jo me natyrën apo thelbin (*De Tommaso kundër Italisë* [DHM], 2017, § 80; *Guzzardi kundër Italisë*, 1980, § 93; *Rantsev kundër Qipros dhe Ruisë*, 2010, § 314; *Stanev kundër Bullgarisë* [DHM], 2012, § 115).

3. Një privim lirie nuk kufizohet vetëm me rastin klasik të burgimit pas arrestimit ose dënimit, por mund të marrë shumë forma të tjera (*Guzzardi kundër Italisë*, 1980, § 95).

B. Kriteret që duhen zbatuar

4. Gjykata nuk e konsideron veten të lidhur nga konkluzionet juridike të nxjerra nga autoritetet vendase nëse ka pasur apo jo privim nga liria, ajo bën një vlerësim të pavarur të situatës (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 2016, § 71; *H.L. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2004, § 90; *H.M. kundër Zvicrës*, 2002, §§ 30 dhe 48; *Creangă kundër Rumanisë* [DHM], 2012, § 92).

5. Për të vendosur nëse personi është "privuar nga liria" sipas kuptimit të nenit 5, pikënisja duhet të jetë situata e tij konkrete dhe duhet të merret parasysh një gamë e gjerë e kriterëve siç janë lloji, kohëzgjatja, pasojat dhe mënyra e zbatimit të masave në fjalë (*De Tommaso kundër Italisë* [DHM], 2017, § 80; *Guzzardi kundër Italisë*, 1980, § 92; *Medvedyev dhe të tjerë kundër Francës* [DHM], 2010, § 73; *Creangă kundër Rumanisë* [DHM], 2012, § 91).

6. Kërkesa për të mbajtur parasysh "llojin" dhe "mënyrën e zbatimit" të masës në fjalë i mundëson Gjykatës të vlerësojë kontekstin dhe rrethanat specifike që shoqërojnë llojet e kufizimit të lirisë përveç modelit tipik të izolimit në qeli. Në fakt, konteksti në të cilin merret masa përbën një faktor të rëndësishëm pasi në shoqëritë moderne shpeshherë ndodhin situata ku publikut mund t'i kërkohet të përballlet me disa kufizime të lirisë së lëvizjes ose të vetë lirisë personale në interesin e së mirës së përbashkët (*De Tommaso kundër Italisë* [DHM], 2017, § 81; *Nada kundër Zvicrës* [DHM], 2012, § 226; *Austin dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2012, § 59).

7. Në përcaktimin e dallimit mes kufizimit të lirisë së lëvizjes dhe privimit të lirisë në kontekstin e izolimit të huajve në zonat e tranzitit të aeroportit dhe qendrat e pritjes për identifikimin dhe regjistrimin e migrantëve, faktorët e marrë parasysh nga Gjykata mund të përmbledhen si vijon: i) situata individuale e kërkuarve dhe zgjedhjet e tyre, ii) regjimi ligjor i zbatueshëm i vendit përkatës dhe qëllimi i tij, iii) kohëzgjatja përkatëse, veçanërisht duke pasur parasysh qëllimin dhe mbrojtjen procedurale që gëzojnë kërkuarët në pritje e sipër të ngjarjeve, dhe iv) natyra dhe shkalla e kufizimeve faktike të vendosura ose të përjetuara nga kërkuarët (*Z.A. dhe të tjerë kundër Rusisë* [DHM], 2019, § 138; *Ilias dhe Ahmed kundër Hungarisë* [DHM], 2019, § 217; *R.R. dhe të tjerë kundër Hungarisë*, 2021, § 74).

8. Edhe masat e synuara për mbrojtje ose të marra në interes të personit përkatës mund të konsiderohen privimi nga liria (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 2016, § 71).

9. Qëllimi i masave të marra nga autoritetet për privimin e lirisë personale, nuk është vendimtar për vlerësimin nëse ka pasur realisht privim nga liria. Gjykata e merr parasysh këtë vetëm në një fazë të mëvonshme të analizës së saj, kur shqyrton pajtueshmërinë e masave me nenin 5 § 1 (*Rozhkov kundër Rusisë (nr. 2)*, 2017, § 74).

10. Koncepti i privimit të lirisë në kuptimin e nenit 5 § 1 përmban si një *aspekt objektiv* të izolimit të një personi brenda një hapësire të kufizuar për një periudhë jo të papërfillshme kohe, ashtu edhe një *aspekt subjektiv*, që lidhet me faktin se personi nuk ka dhënë pëlqimin e tij të vlefshëm për kufizimin në fjalë (*Storck kundër Gjermanisë*, 2005, § 74; *Stanev kundër Bullgarisë* [DHM], 2012, § 117).

11. Faktorët përkatës objektivë që duhet të merren parasysh përfshijnë mundësinë për t'u larguar nga zona e kufizuar, intensitetin e mbikëqyrjes dhe të kontrollit të ushtruar mbi lëvizjet e personit të privuar, nivelin e izolimit të tij, si edhe mundësinë e kontakteve shoqërore (*Guzzardi kundër Italisë*, 1980, § 95; *H.M. kundër Zvicrës*, 2002, § 45; *H.L. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2004, § 91; *Storck kundër Gjermanisë*, 2005, § 73). Megjithatë, në rastin e një fëmije 8-vjeçar që u la vetëm në një rajon policie për më shumë se njëzet e katër orë, nuk ishte e nevojshme të vlerësohej nëse ai ishte mbajtur në ambiente të mbyllura dhe të ruajtura, pasi nuk mund të pritej që ai të largohej vetë nga rajoni i policisë (*Tarak dhe Depe kundër Turqisë*, 2019, § 61).

12. Kur faktet tregojnë privimin e lirisë sipas kuptimit të nenit 5 § 1, kohëzgjatja relativisht e shkurtër e paraburgimit nuk ndikon në këtë konkluzion (*Rantsev kundër Qipros dhe Ruisë*, 2010, § 317; *Iskandarov kundër Ruisë*, 2010, § 140, *Zelčs kundër Letonisë*, 2020, § 40).

13. Elementi i shtrëngimit në ushtrimin e kompetencave policore të ndalimit dhe kontrollit është tregues i privimit të lirisë, pavarësisht kohëzgjatjes së shkurtër të masës (*Krupko dhe të tjerë kundër Ruisë*, 2014, § 36; *Foka kundër Turqisë*, 2008, § 78; *Gillan dhe Quinton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2010, § 57; *Shimovolos kundër Ruisë*, 2011, § 50; *Brega dhe të tjerë kundër Moldavisë*, 2012, § 43).

14. Fakti që një person nuk është i prangosur, i mbajtur në qeli ose kufizuar fizikisht në ndonjë mënyrë tjetër, nuk përbën element vendimtar për të përcaktuar nëse kemi të bëjmë me rastin e privimit të lirisë (*M.A. kundër Qipros*, 2013 § 193).

15. E drejta e lirisë është shumë e rëndësishme në një shoqëri demokratike, kështu që një person nuk mund ta humbasë mbrojtjen që ofron Konventa vetëm për faktin se është dorëzuar vetë për t'u izoluar, sidomos kur ky person është ligjërisht i paaftë për të dhënë pëlqimin apo për të kundërshtuar veprimin propozuar (*H.L. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2004, § 90; *Stanev kundër Bullgarisë* [DHM], 2012, § 119; shih gjithashtu *N. kundër Rumanisë* 2017, §§ 165-167, ku vazhdimi i mbajtjes së kërkuesit në situatë paraburgimi pas vendimit për lirimin e tij u gjet arbitrar, edhe pse kërkuesi kishte pranuar të qëndronte në burg derisa shërbimet sociale të gjenin zgjidhje të duhur për situatën e tij).

16. Fakti që një person nuk ka zotësi juridike nuk do të thotë domosdoshmërisht që ai është i paaftë të kuptojë dhe të japë pëlqimin e vet për situatën në të cilën ndodhet (*Stanev kundër Bullgarisë* [DHM], 2012, § 130; *Shtukurov kundër Ruisë*, 2008, §§ 107-109; *D.D. kundër Lituanisë*, 2012, § 150).

C. Masat e marra në burg

17. Masat disiplinore të caktuara brenda burgut, të cilat kanë pasoja mbi kushtet e burgimit nuk mund të vlerësohen se përbëjnë privime lirie. Këto masa, në rrethanat normale, duhet të konsiderohen si ndryshime të kushteve të burgimit të ligjshëm dhe janë jashtë fushëveprimit të nenit 5 § 1 të Konventës (*Stoyan Krastev kundër Bullgarisë*, 2020, § 38); *Bollan kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend. pran.), 2000; shih edhe *Munjaz kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, ku izolimi i kërkuesit në spital të sigurisë së lartë nuk përbën privim lirie të mëtejshëm).

D. Kontrolli i sigurisë së pasagjerëve ajrorë

18. Kur një pasagjer ndalohet nga punonjësit kufitarë gjatë kontrollit kufitar në një aeroport për të sqaruar situatën e tij dhe kur ky ndalim nuk e ka tejkalluar kohën rreptësisht të nevojshme për të kryer formalitetet përkatëse, nuk lind asnjë çështje sipas nenit 5 të Konventës (*Gahramanov kundër Azerbajxhanit* (vend. pran.), 2013, § 41; *O.M. dhe D.S. kundër Ukrainës* 2022, §§ 113-120, ku masat e kontrollit dhe mbikëqyrjes, zgjatën rreth njëmbëdhjetë orë në lidhje me personat që udhëtonin me dokumente identiteti të falsifikuara, nuk përbënin privim lirie; shih, për krahasim, *Kasparov kundër Ruisë*, 2016, ku ndalimi për pesë orë i kërkuesit shkoi shumë përtej kohës rreptësisht të nevojshme për verifikimin e formaliteteve që normalisht lidhen me udhëtimin me avion).

E. Privimi i lirisë në raste të tjera, përveç arrestimit formal ose të paraburgimit

19. Çështja e zbatueshmërisë së nenit 5 ka lindur në një larmi rrethanash, duke përfshirë:

- Vendosjen e individëve në një institucion psikiatrie ose kujdesi social (*De Wilde, Ooms dhe Versyp kundër Belgjikës*, 1971; *Nielsen kundër Danimarkës*, 1988; *H.M. kundër Zvicrës*, 2002;

H.L. kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2004; *Storck kundër Gjermanisë*, 2005; *A. dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, 2011; *Stanev kundër Bullgarisë* [DHM], 2012);

- dërgimin e një personi nga personeli para-mjekësor dhe punonjësit e policisë në spital (*Aftanache kundër Rumanisë*, 2020);
- mbajtjen në zona tranziti në aeroport (*Z.A. dhe të tjerë kundër Rusisë* [DHM], 2019; *Amuur kundër Francës*, 1996; *Shamsa kundër Polonisë*, 2003; *Mogoş dhe të tjerë kundër Rumanisë* (vend. pran.), 2004; *Mahdid dhe Haddar kundër Austrisë* (vend. pran.), 2005; *Riad dhe Idiab kundër Belgjikës*, 2008);
- mbajtjen në zona tranziti në kufirin tokësor (*Ilias dhe Ahmed kundër Hungarisë* [DHM], 2019; *R.R. dhe të tjerë kundër Hungarisë*, 2021);
- marrjen në pyetje në rajon policie (*Cazan kundër Rumanisë*, 2016; *I.I. kundër Bullgarisë*, 2005; *Osypenko kundër Ukrainës*, 2010; *Salayev kundër Azerbajxhanit*, 2010; *Farhad Aliyev kundër Azerbajxhanit*, 2010; *Creangă kundër Rumanisë* [DHM], 2012; *Bogay dhe të tjerë kundër Ukrainës*, 2025);
- vendosjen në automjetin e policisë për të përpiluar një raport për shkelje administrative (*Zelčs kundër Letonisë*, 2020);
- izolimin në një oborr gjatë një demonstrate (*Siedlecka kundër Polonisë*, 2025);
- ndalimet dhe kontrollimet nga policia (*Foka kundër Turqisë*, 2008; *Gillan dhe Quinton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2010; *Shimovolos kundër Rusisë*, 2011);
- kontrollin e banesës (*Stănculeanu kundër Rumanisë*, 2018);
- shoqërimin policor (*Rozhkov kundër Rusisë (nr. 2)*, 2017; *Tsvetkova dhe të tjerë kundër Rusisë*, 2018);
- masat e kontrollit të turmës të marra nga policia për shkaqe të rendit publik (*Austin dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2012; *Auray dhe të tjerë kundër Francës*, 2024);
- arrestin në shtëpi (*Buzadji kundër Republikës së Moldavisë* [DHM], 2016; *Mancini kundër Italisë*, 2001; *Lavents kundër Letonisë*, 2002; *Nikolova kundër Bullgarisë (nr. 2)*, 2004; *Dacosta Silva kundër Spanjës*, 2006).
- mbajtjen e migrantëve që vijnë me rrugë detare në ambiente pritëse dhe në anije (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 2016);
- mbajtjen e migrantëve të parregullt në ambiente për azilin (*J.R. dhe të tjerë kundër Greqisë*, 2018);
- bllokimin në nivel kombëtar për shkak të pandemisë Covid-19 (*Terheş kundër Rumanisë* (vend. pran.), 2021);
- urdhrat e ndalim-qarkullimit në banesë të nxjerra sipas legjislacionit për gjendje të jashtëzakonshme (*Domenjoud kundër Francës*, 2024).

F. Detyrime pozitive lidhur me privimin e lirisë

20. Neni 5 § 1, fjalia e parë përcakton një detyrim pozitiv mbi Shtetin që jo vetëm të përmbahet nga ndërhyrja aktive në cenimin e të drejtave në fjalë, por edhe të ndërmarrë hapa të përshtatshëm për të ofruar mbrojtje kundër ndërhyrjeve të paligjshme në këto të drejta për çdo person brenda juridiksionit të tij (*El-Masri kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [DHM], 2012, § 239).

21. Prandaj Shteti është i detyruar të marrë masa që sigurojnë mbrojtje efektive të personave vulnerabël, duke përfshirë hapa të arsyeshëm për të parandaluar një privim nga liria për të cilën autoritetet kanë ose duhet të kenë dijeni (*Storck kundër Gjermanisë*, 2005, § 102).

22. Shteti ngarkohet me përgjegjësi në qoftë se ai lejon heshturazi privimin e një personi nga liria nga disa individë apo në qoftë se ai nuk vepron për t'i dhënë fund një situatë të tillë (*Riera Blume dhe të tjerë kundër Spanjës*, 1999; *Rantsev kundër Qipros dhe Rusisë*, 2010, §§ 319-21; *Medova kundër Rusisë*, 2009, §§ 123-25).

II. Ligjshmëria e privimit nga liria sipas nenit 5 § 1

A. Qëllimi i nenit 5

23. Qëllimi kryesor i nenit 5 është të parandalojë privimin arbitrar ose të papërligjur të lirisë (*Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2)* [DHM], 2020, § 311; *S., v. dhe A. kundër Danimarkës* [DHM], 2018, § 73; *McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2006, § 30). E drejta për liri dhe siguri personale ka rëndësi shumë të madhe në një “shoqëri demokratike”, në kuptimin e Konventës (*Medvedyev dhe të tjerë kundër Francës* [DHM], 2010, § 76; *Ladent kundër Polonisë*, 2008, § 45).

24. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se paraburgimi i një individ pa njohjen e këtij fakti nga autoritetet përbën mohim i plotë i garancive thelbësisht të rëndësishme të përcaktuara nga neni 5 i Konventës dhe një shkelje tepër të rëndë të kësaj dispozite (*El-Masri kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [DHM], 2012, § 233; *Al Nashiri kundër Polonisë*, 2014, § 529; *Belozorov kundër Rusisë dhe Ukrainës*, 2015, § 113). Mosregjistrimi i disa të dhënave si: data, ora, vendndodhja e paraburgimit, emri i të paraburgosurit, arsyet e ndalimit dhe emri i personit që e ka kryer atë, duhet parë si i papajtueshëm, *inter alia*, me vetë qëllimin e nenit 5 të Konventës (*Kurt kundër Turqisë*, 1998, § 125). Gjithashtu është i papajtueshëm me kërkesën e ligjshmërisë sipas Konventës (*Angelova kundër Bullgarisë*, 2002, § 154).

25. Asnjë privim lirie nuk është i ligjshëm nëse nuk bëhet për një nga shkaqet e lejueshme të përcaktuara në nënparagrafët nga (a) deri në (f) të nenit 5 § 1 (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 2016, § 88; shih edhe, mes çështjeve të fundit, *Aftanache kundër Rumanisë*, 2020, §§ 92-100; *I.S. kundër Zvicrës*, 2020, §§ 46-60).

26. Tre drejtime arsyetimi mund të identifikohen në praktikën gjyqësore të Gjykatës: natyra shteruese e përjashtimeve, që duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë (strikte) dhe që nuk lejon gamën e gjerë të përligjeve sipas dispozitave të tjera (nenet 8 deri në 11 të Konventës në veçanti); theksi i përsëritur mbi ligjshmërinë e paraburgimit, si procedurale ashtu edhe materiale, që kërkon respektim të kujdesshëm të parimit të shtetit të së drejtës; dhe tek rëndësia e reagimit të menjëhershëm ose të shpejtë të kontrollit gjyqësor të nevojshëm (sipas nenit 5 §§ 3 dhe 4) (*Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2)* [DHM], 2020, § 312; *S., v. dhe A. kundër Danimarkës* [DHM], 2018, § 73; *Buzadji kundër Republikës së Moldavisë* [DHM], 2016, § 84).

27. Sa i përket paraburgimit që ndodh gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar, garancitë sipas nenit 5 duhet të interpretohen duke marrë parasysh kontekstin dhe dispozitat e së drejtës ndërkombëtare humanitare (*Hassan kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2014, §§ 103-106).

28. Nëse një rast i caktuar i privimit të lirisë nuk përshtatet brenda kufijve të njërit prej nënparagrafëve të nenit 5, siç është interpretuar nga Gjykata, ajo nuk mund të justifikohet duke iu referuar nevojës për të balancuar interesat e Shtetit me ato të personit të ndaluar (*Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DHM], 2017, § 298).

B. Pajtueshmëria me të drejtën kombëtare

29. Për të përmbushur kërkesën e ligjshmërisë, privimi i lirisë duhet të bëhet “sipas një procedure të parashikuar me ligj”.

Konventa i referohet në thelb të drejtës kombëtare, por edhe, sipas rastit, standardeve të tjera të zbatueshme ligjore, përfshirë ato që burojnë në të drejtën ndërkombëtare (*Medvedyev dhe të tjerë kundër Francës* [DHM], 2010, § 79; *Toniolo kundër San Marinos dhe Italisë*, 2012, § 46; *Aydın Sefa Akay kundër Turqisë*, 2024, §§ 115-129) ose në të drejtën europiane (*Paci kundër Belgjikës*, 2018, § 64 dhe *Pirozzi kundër Belgjikës*, 2018, §§ 45-46, në lidhje me paraburgimin bazuar në një Urdhër Arresti European). Në të gjitha rastet, Konventa vendos detyrimin për t'iu përmbajtur normave materiale dhe procedurale (ligjeve) përkatëse (*ibid.*).

30. Për shembull, Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 5 në një çështje ku autoritetet nuk kishin paraqitur kërkesën për zgjatje të afatit të një vendimi paraburgimi brenda afatit kohor të parashikuar nga ligji (*G.K. kundër Polonisë*, 2004, § 76). Në të kundërt, shkelja e pretenduar e një qarkoreje [udhëzimi] e cila kishte të bënte me mënyrën se si duhej të kryheshin hetimet për disa kategori veprash penale nuk e vinte në pikëpyetje vlefshmërinë e bazës ligjore të brendshme për arrestimin dhe më pas paraburgimin (*Talat Tepe kundër Turqisë*, 2004, § 62). Kur gjykata e faktit kishte refuzuar lirimin e kërkuarit pavarësisht vendimit të Gjykatës Kushtetuese që e gjente të paligjshëm paraburgimin e tij, vazhdimësia e paraburgimit të kërkuarit nuk mund të konsiderohej si “në përputhje me një procedurë të parashikuar nga ligji” (*Şahin Alpay kundër Turqisë*, 2018, § 118; *Mehmet Hasan Altan kundër Turqisë*, 2018, § 139). Shkelje e nenit 5 § 1 u gjet edhe kur kërkuari u mbajt në psikiatri përtej afatit kohor të përcaktuar nga legjislacioni i brendshëm i miratuar dhe hyrë në fuqi pas nxjerrjes së urdhrit të shtrimit të tij, ku paligjshmëria e mbylljes në psikiatri u pranua nga gjykatat e brendshme (*Cramesteter kundër Italisë*, 2024, §§ 53-56).

C. Shqyrtimi i pajtueshmërisë me të drejtën kombëtare

31. Ndonëse u takon në radhë të parë autoriteteve kombëtare, sidomos gjykatave, që ta interpretojnë dhe ta zbatojnë të drejtën e brendshme, qëndrimi është i ndryshëm lidhur me raste ku mosrespektimi i së drejtës vendase përbën shkelje të Konventës. Në rastet kur neni 5 § 1 i Konventës është në rrezik, Gjykata duhet të ushtrojë një kompetencë të caktuar shqyrtimi për të kontrolluar nëse është respektuar apo jo e drejta e brendshme (*Creangă kundër Rumanisë* [DHM], 2012, § 101; *Baranowski kundër Polonisë*, 2007, § 50; *Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1996, § 41). Në këtë mënyrë, Gjykata duhet të ketë parasysh situatën ligjore që ka ekzistuar në kohën materiale (*Włoch kundër Polonisë*, 2000, § 114).

Gjykata, në vlerësimin e vlefshmërisë së vendimit për paraburgim e të dyshuarit që ndodhej jashtë vendit, për 30 ditë, ka pranuar si në përputhje me nenin 5, praktikën e gjykatave vendase për të llogaritur periudhën e paraburgimit nga data e ekstradimit të të dyshuarit në vend të datës së arrestimit të tij në Shtetin e ekstradimit (*Gilanov kundër Republikës së Moldavisë*, 2022, §§ 51-56).

D. Parime të përgjithshme

32. Kërkesa për ligjshmëri nuk përmbushet vetëm me zbatimin e së drejtës vendase përkatëse; sepse duhet që edhe vetë e drejta vendase të jetë në përputhje me Konventën, duke përfshirë edhe parimet e përgjithshme të shprehura ose të nënkuptuara të saj (*Plesó kundër Hungarisë*, 2012, § 59).

Parimet e përgjithshme të nënkuptuara nga Konventa, të cilave u referohet praktika gjyqësore lidhur me nenin 5 § 1 janë parimi i shtetit të së drejtës dhe, i lidhur me këtë të fundit, ai i sigurisë juridike, parimi i proporcionalitetit dhe parimi i mbrojtjes kundër arbitraritetit, që për më tepër është qëllimi i vetë nenit 5 (*Simons kundër Belgjikës* (vend. pran.), 2012, § 32).

E. Parimi i sigurisë juridike

33. Në rastin e privimit të lirisë, është veçanërisht e rëndësishme që të respektohet parimi i përgjithshëm i sigurisë juridike. Kështu, është thelbësore që kushtet e privimit të lirisë sipas së drejtës vendase të jenë të përcaktuara qartësisht dhe që vetë ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij,

në mënyrë që të përmbushet standardi i "ligjshmërisë" i përcaktuar nga Konventa, një standard i cili kërkon që i gjithë ligji të jetë mjaftueshëm i saktë sa t'i japë mundësi çdo personi që – nëse ekziston nevoja, me këshillimin e duhur – të parashikojë, në një masë të arsyeshme me rrethanat, pasojat që mund të rrjedhin nga një veprim i caktuar (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 2016, § 92; *Del Río Prada kundër Spanjës* [DHM], 2013, § 125; *Creangă kundër Rumanisë*, 2012, § 120; *Medvedyev dhe të tjerë kundër Francës* [DHM], 2010, § 80).

34. Parimi i sigurisë juridike mund të cenohet nëse gjykatat vendase fusin përjashtime në praktikën e tyre gjyqësore, të cilat bien ndesh me formulimin e dispozitave ligjore ose bëjnë një interpretim të gjerë që mohon garancitë procedurale të parashikuara me ligj (*Aydin Sefa Akay kundër Turqisë*, 2024, § 115).

35. Kështu neni 5 § 1 nuk i referohet thjesht të drejtës vendase, ai ka të bëjë gjithashtu edhe me "cilësinë e ligjit", që nënkupton se nëse legjislacioni kombëtar lejon privimin e lirisë, ai duhet të jetë mjaftueshëm i aksesueshëm, i saktë dhe i parashikueshëm në zbatimin e tij. Faktorët e rëndësishëm për vlerësimin e "cilësisë së ligjit" - që në disa raste njihen si "garanci kundër arbitraritetit" - përfshijnë ekzistencën e dispozitave të qarta ligjore për të urdhëruar paraburgimin, për të zgatur paraburgimin dhe për të caktuar afate kohore për paraburgimin; si dhe ekzistencën e një mjet juridik efektiv me anë të të cilit kërkuesi mund të kundërshtojë "ligjshmërinë" dhe "kohëzgjatjen" e vazhimit të paraburgimit të tij (*J.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2016, § 77).

36. Për shembull, praktika e mbajtjes së një personi në paraburgim sipas një aktakuze pa ndonjë bazë specifike në legjislacionin kombëtar ose në praktikën gjyqësore përbën shkelje të nenit 5 § 1 (*Baranowski kundër Polonisë*, 2007, §§ 50-58). Po kështu, praktika e përtëritjes automatike të paraburgimit, pa ndonjë bazë të saktë ligjore, bie ndesh me nenin 5 § 1 (*Svipsta kundër Letonisë*, 2006, § 86). Në të kundërt, mbajtja në paraburgim e një personi mbi bazën e një vendimi të Dhomës Akuzuese që shqyrton akuzën dhe urdhëron hetime të mëtejshme, pa nxjerrë një urdhër formal paraburgimi, nuk përbënte shkelje të nenit 5 (*Laumont kundër Francës*, 2001, § 50).

37. Dispozitat që interpretohen nga autoritetet vendase në mënyrë inkohente dhe kundërthënëse në masën që përjashtojnë njëra-tjetrën, nuk e përmbushin standardin e kërkuar nga Konventa për "cilësinë e ligjit" (*Nasrullojev kundër Rusisë*, 2007, § 77; *Ječius kundër Lituonisë*, 2000, §§ 53-59). Megjithatë, në mungesë të praktikës gjyqësore, Gjykata nuk është e thirrur që të bëjë interpretimin e saj të ligjit kombëtar. Prandaj, ajo mund të hezitojë të konkludojë se gjykatat kombëtare kanë dështuar të veprojnë në përputhje me një procedurë të parashikuar nga ligji (*Włoch kundër Polonisë*, 2000, §§ 114-16; *Winterwerp kundër Holandës*, 1979, §§ 48-50).

38. Ndonëse notat verbale diplomatike përbëjnë një burim të së drejtës ndërkombëtare, paraburgimi i ekuipazhit në bazë të këtyre notave nuk është e ligjshme në kuptimin e nenit 5 § 1 të Konventës, për sa kohë ato nuk janë mjaftueshëm të sakta dhe të parashikueshme. Në veçanti, mungesa e një reference të posaçme për arrestimin dhe paraburgimin e mundshëm të pjesëtarëve të një ekuipazhi shkel kërkesat e sigurisë juridike dhe të parashikueshmërisë sipas nenit 5 § 1 të Konventës (*Medvedyev dhe të tjerë kundër Francës* [DHM], 2010, §§ 96-100).

39. Kërkesat e sigurisë juridike bëhen edhe më të rëndësishme kur një gjyqtar privohet nga liria (*Baş kundër Turqisë*, 2020, § 158). Nëse e drejta vendase ka ofruar mbrojtje gjyqësore ndaj anëtarëve të gjyqësorit për të ruajtur ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre, është thelbësore që këto rregullime të respektohen në mënyrën e duhur. Duke pasur parasysh vendin e rëndësishëm që zë gjyqësori mes organeve të shtetit në një shoqëri demokratike, rëndësisë në rritje që i jepet ndarjes së pushteteve dhe nevojës për të ruajtur pavarësinë e gjyqësorit, Gjykata duhet të jetë veçanërisht e kujdesshme ndaj mbrojtjes së anëtarëve të gjyqësorit kur shqyrton mënyrën se si është zbatuar një vendim paraburgimi nën këndvështrimin e dispozitave të Konventës (*Alparslan Altan kundër Turqisë*, 2019, § 102; *Turan dhe të tjerë kundër Turqisë*, 2021, § 82). Parimet e vendosura në praktikën gjyqësore të Gjykatës lidhur me pavarësinë e gjyqësorit vendas zbatohen *mutatis mutandis* në drejtim

të gjyqtarëve dhe gjykatave ndërkombëtare, pavarësia e të cilëve është po ashtu një *conditio sine qua non* për administrimin e duhur të drejtësisë (*Aydin Sefa Akay kundër Turqisë*, 2024, § 113).

F. Mungesa e arbitraritetit

40. Po ashtu, çdo privim lirie duhet të jetë në përputhje me qëllimin e mbrojtjes së individit nga arbitrariteti (*S., v. dhe A. kundër Danimarkës* [DHM], 2018, § 74; *Witold Litwa kundër Polonisë*, 2000, § 78).

41. Koncepti i “arbitraritetit” në nenin 5 § 1 shtrihet përtej mospërputhjes me të drejtën kombëtare, prandaj privimi i lirisë mund të jetë i ligjshëm, sipas të drejtës vendase, por në të njëjtën kohë arbitrar dhe rrjedhimisht në kundërshtim me Konventën (*Creangă kundër Rumanisë*, 2012, § 84; *A. dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2009, § 164).

42. Koncepti i arbitraritetit ndryshon në një farë mase sipas llojit të privimit për të cilin bëhet fjalë. Gjykata ka vënë në dukje se arbitrariteti mund të lindë: kur ka pasur ndonjë element keqbesimi ose mashtrimi nga ana e autoriteteve; kur vendimi për paraburgim dhe zbatimi i tij nuk përputhen në mënyrë të mirëfilltë me qëllimin e kufizimeve të lejuara nga nënparagrafi përkatës i nenit 5 § 1; kur nuk ka lidhje ndërmjet shkakut të lejuar të privimit nga liria mbi të cilin është mbështetur, me vendin dhe kushtet e paraburgimit; si dhe kur nuk ka asnjë lidhje proporcionaliteti ndërmjet shkakut të paraburgimit dhe vetë paraburgimit (për një pasqyrë të detajuar të parimeve kryesore shih *James, Wells dhe Lee kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, §§ 191-95; *Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2008, §§ 68-74).

43. Shpejtësia me të cilën gjykatat vendase zëvendësojnë një vendim paraburgimi që i ka kaluar afati ose që është gjetur me të meta, është një element tjetër i rëndësishëm për të vlerësuar nëse paraburgimi i një personi duhet të konsiderohet arbitrar (*Mooren kundër Gjermanisë* [DHM], 2009, § 80). Kështu, Gjykata, në kontekstin e nënparagrafit (c) vlerëson se një periudhë më pak se një muaj ndërmjet përfundimit të afatit të vendimit fillestar të paraburgimit dhe nxjerrjes së një vendimi paraburgimi të ri të arsyetuar, pas kthimit të çështjes nga një gjykatë apeli në një shkallë më të ulët, nuk e bën arbitrar paraburgimin e kërkuesit (*Minjat kundër Zvicrës*, 2003, §§ 46 dhe 48). Në të kundërt, një periudhë më shumë se një vit, pas kthimit të çështjes nga gjykata e apelit në një gjykatë të shkallës më të ulët, gjatë së cilës kërkuesi ka qenë në një gjendje pasigurie për shkaqet e paraburgimit të tij, e kombinuar me mungesën e afatit kohor për rishqyrtimin e paraburgimit të tij nga gjykata më e ulët, e bën arbitrar paraburgimin e kërkuesit (*Khudoyorov kundër Rusisë*, 2005, §§ 136-37).

G. Vendim gjykate

44. Një periudhë paraburgimi, në parim, konsiderohet se është “e ligjshme” në qoftë se është e bazuar në një vendim ose urdhër gjykate. Paraburgimi i bazuar në një vendim gjykate, që më vonë është gjetur i paligjshëm nga një gjykatë më e lartë, mund të mbetet përsëri i vlefshëm sipas legjislacionit të brendshëm (*Bozano kundër Francës*, 1986, § 55). Paraburgimi mund të mbetet në pajtim me “procedurën e parashikuar nga ligji” edhe pse gjykatat vendase kanë pranuar se ka pasur të meta në procedurat e paraburgimit, por gjithsesi e kanë cilësuar paraburgimin si të ligjshëm (*Erkalo kundër Holandës*, 1998, §§ 55-56). Kështu, të metat në vendimin e paraburgimit nuk e shndërrojnë domosdoshmërisht të paligjshme periudhën përkatëse të paraburgimit në kuptim të nenit 5 § 1 (*Yefimenko kundër Rusisë*, 2013, §§ 102-08; *Ječius kundër Lituanisë*, 2000, § 68; *Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1996, §§ 42-47).

45. Gjykata bën dallimin ndërmjet vendimeve të gjykatave vendase që janë brenda kompetencës së tyre dhe vendimeve që janë në tejkalim të kompetencës (*ibid.*, §§ 43 et seq.). Vendimet e paraburgimit janë gjetur *ex facie* të pavlefshme në raste ku pala e interesuar nuk është njoftuar siç duhet për seancën (*Khudoyorov kundër Rusisë*, 2005, § 129), gjykatat vendase kishin dështuar të kryenin hetimin mbi mjetet financiare siç kërkohet nga ligji kombëtar (*Lloyd dhe të tjerë kundër Mbretërisë së*

Bashkuar, 2005, §§ 108 dhe 116), ose gjykatat më të ulëta nuk kanë vlerësuar si duhet alternativat e arrestit në burg (*ibid.*, § 113). Nga ana tjetër, kur nuk ka prova që sjellja e gjykatave kombëtare përbënte “parregullsi të rëndë ose të dukshme”, Gjykata është shprehur që paraburgimi ka qenë i ligjshëm (*ibid.*, § 114).

H. Arsyetimi i vendimeve dhe kërkesa e mungesës së arbitraritetit

46. Mungesa ose pamjaftueshmëria e arsytimit në vendimet e paraburgimit është një nga elementet që merret parasysh nga Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e paraburgimit sipas nenit 5 § 1 (*S., v. dhe A. kundër Danimarkës* [DHM], 2018, § 92). Rrjedhimisht, mungesa e çdo shkakut të dhënë nga autoritetet gjyqësore në vendimet që autorizojnë paraburgimin për një periudhë të zgjatur mund të jetë i papajtueshëm me parimin e mbrojtjes nga arbitrariteti të parashikuar nga neni 5 § 1 (*Stašaitis kundër Lituaniës*, 2002, §§ 66-67). Po kështu, një vendim tejet lakonik i cili nuk përmend ndonjë dispozitë ligjore që do të përligjte paraburgimin nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme nga arbitrariteti (*Khudoyorov kundër Rusisë*, 2005, § 157).

47. Megjithatë, Gjykata mund të vlerësojë paraburgimin e kërkuarit në përputhje me legjislacionin e brendshëm pavarësisht mungesës së arsyeve në vendimin e paraburgimit nëse gjykatat vendase kanë qenë të bindura se ekzistonin disa shkaqe për paraburgimin e kërkuarit (*Minjat kundër Zvicrës*, 2003, § 43). Përveç kësaj, kur gjykatat vendase kishin shfuqizuar vendimin gjyqësor të paraburgimit për mungesë të arsyeve, por kanë vlerësuar që ekzistojnë disa shkaqe për paraburgimin e kërkuarit, refuzimi për të urdhëruar lirimin e të paraburgosurit dhe kthimi i çështjes në gjykatat më të ulëta për të vendosur në lidhje me ligjshmërinë e paraburgimit nuk përbën shkelje të nenit 5 paragrafit 1 (*ibid.*, § 47).

48. Ka shkelje të nenit 5 § 1 kur mungesa e arsyeve për urdhërimin e paraburgimit shoqërohet me dështimin për të caktuar kohëzgjatjen e tij. Megjithatë, gjykatave kombëtare nuk iu kërkohet të caktojnë një kohëzgjatje paraburgimi në vendimet e tyre, pavarësisht se si është rregulluar çështja në ligjin vendas (*Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DHM], 2017, § 199; *Oravec kundër Kroacisë*, 2017, § 55). Ekzistenca ose mungesa e afateve kohore është një prej disa faktorëve që Gjykata mund të marrë parasysh në vlerësimin e saj nëse ligji vendas ka qenë i parashikueshëm në zbatimin e tij dhe nëse ka ofruar garanci kundër paraburgimit arbitrar (*J.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2016, § 90; *Meloni kundër Zvicrës*, 2008, § 53.)

49. Për më tepër, autoritetet duhet të vlerësojnë masa më pak ndërhyrëse se paraburgimi (*Ambruszkiewicz kundër Polonisë*, 2006, § 32).

I. Shembuj të metash procedurale të pranueshme

50. Të metat procedurale të mëposhtme janë vlerësuar se nuk e bëjnë paraburgimin e kërkuarit të paligjshëm:

- Dështimi për t'i njoftuar zyrtarisht vendimin e paraburgimit të akuzuarit nuk përbën "parregullsi të rëndë ose të dukshme" në kuptimin përjashtimor të treguar nga praktika gjyqësore meqë autoritetet kishin pasur me të vërtetë bindjen që kërkuarit i është njoftuar vendimi (*Maturana kundër Italisë*, 2008, § 79; por shih *Voskuil kundër Holandës*, 2007, ku Gjykata gjeti shkelje sepse kërkuari nuk ishte njoftuar për vendimin e paraburgimit brenda afatit kohor të parashikuar me ligj: tre ditë dhe jo njëzet e katër orë);
- një gabim i thjeshtë shkrimi në një urdhër arresti ose vendim paraburgimi që është korrigjuar më vonë nga një autoritet gjyqësor (*Nikolov kundër Bullgarisë*, 2003, § 63; *Douiyeb kundër Holandës* [DHM], 1999, § 52);
- zëvendësimi i shkakut formal për paraburgosjen e kërkuarit nën dritën e fakteve të përmendura nga gjykatat për të mbështetur konkluzionet e tyre (*Gaidjurgis kundër Lituaniës* (vend. pran.), 2001). Megjithatë, mungesa e dhënjes së arsyeve të përshtatshme për një

zëvendësim të tillë mund ta çojë Gjykatën në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 (*Calmanovici kundër Rumanisë*, 2008, § 65).

J. Vonesa në ekzekutimin e vendimit të lirimit

51. Është e paimagjinueshme që në një Shtet që i nënshtrohet shtetit të së drejtës, një person të vazhdojë të jetë i privuar nga liria ndonëse ekziston një urdhër gjyqësor për lirimin e tij (*Assanidze kundër Gjeorgjisë* [DHM], 2004, § 173). Megjithatë, Gjykata e pranon që vonesa për ekzekutimin e një urdhri për lirimin e personit të paraburgosur është e kuptueshme dhe shpesh e pashmangshme. Por, autoritetet kombëtare duhet të përpiqen ta mbajnë në minimum të mundshëm (*Giulia Manzoni kundër Italisë*, 1997, § 25).

Formalitetet administrative që kanë të bëjnë me lirimin nuk mund të përlligjin vonesën prej më shumë se disa orësh (*Ruslan Yakovenko kundër Ukrainës*, 2015, § 68, kur ka pasur një vonesë prej dy ditësh, dhe *Quinn kundër Francës*, 1995, §§ 39-43, në lidhje me një vonesë prej njëmbëdhjetë orësh në ekzekutimin e urdhrit të lirimit të kërkuesit “menjëherë”).

Arrestimi i gabuar i personave kur nuk ekziston më arsyeja për ndalimin e tyre, si rezultat i të metave administrative në përcjelljen e dokumentacionit ndërmjet disa organeve të ndryshme të Shtetit, përbën shkelje të nenit 5, edhe pse për një kohë të shkurtër (*Kerem Çiftçi kundër Turqisë*, 2021, §§ 32-34, ku kërkuesi u mbajt i ndaluar për rreth një orë e gjysmë bazuar në një urdhër arresti i cili ishte tërhequr një muaj më parë.)

III. Privimet e lirisë të lejuara nga neni 5 § 1

A. Burgimi që pason dënimin

Neni 5 paragrafi 1 (a) i Konventës

“1. ... Askush nuk mund të privohet nga liria, përveçse në rastet e mëposhtme dhe në përputhje me procedurat e parashikuara me ligj:

a) kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;

Fjalët kyçe të HUDOC

Privimi i lirisë (5-1) – Procedura e parashikuar me ligj (5-1) – Arrestim ose burgim i ligjshëm (5-1)

(Dënim (5-1-a) – Pas dënim (5-1-a) – Gjykata kompetente (5-1-a)

1. Ekzistenca e dënimit

52. Neni 5 § 1 (a) zbatohet për çdo “dënim” që çon në privim nga liria të shpallur i shpallur nga një gjykatë dhe nuk bën dallim bazuar në natyrën ligjore të veprës penale për të cilën personi është shpallur fajtor pavarësisht klasifikimit si penal ose disiplinor nga legjislacioni i brendshëm i Shtetit në fjalë. (*Engel dhe të tjerë kundër Holandës*, 1976, § 68; *Galstyan kundër Armenisë*, 2007, § 46).

53. Termi do të thotë edhe gjetje të fajit edhe caktim të masës së dënimit ose një mase tjetër që përfshin privimin e lirisë (*Del Río Prada kundër Spanjës* [DHM], 2013, § 125; *James, Wells and Lee kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 189; *M. kundër Gjermanisë*, 2009, § 87; *Van Droogenbroeck kundër Belgjikës*, 1982, § 35; *B. kundër Austrisë*, 1990, § 38).

54. Çështjet e dënimit të përshtatshëm në parim janë jashtë fushës së zbatimit të Konventës. Nuk i takon Gjykatës që të vendosë cila është masa e duhur për burgimin që zbatohet për një vepër penale të caktuar. Megjithatë, masat që lidhen me ekzekutimin e një dënimi ose përshtatjen e tij mund të prekin të drejtën e lirisë të mbrojtur nga neni 5 § 1 sepse kohëzgjatja aktuale e privimit të lirisë varet nga zbatimi i tyre (*Aleksandr Aleksandrov kundër Ruisë*, 2018, § 22; *Khamtokhu dhe Aksenchik kundër Ruisë* [DHM], 2017, §§ 55-56).

55. Dispozita nuk i ndalon Shtetet Kontraktuese për ekzekutimin e urdhrave të paraburgimit të dhëna nga gjykatat kompetente jashtë territorit të tyre (*X. kundër Gjermanisë*, vendim i Komisionit i 14 dhjetorit 1963). Ndonëse Shtetet Kontraktuese nuk janë të detyruara që të verifikojnë nëse procedimet në një Shtet të huaj që kanë çuar te ky dënim, i plotëson të gjitha kërkesat e nenit 6 (*Drozd dhe Janousek kundër Francës dhe Spanjës*, 1992, § 110), dënimi nuk mund të jetë rezultati i një mohimi flagrant të drejtësisë (*Ilaşcu dhe të tjerë kundër Moldavisë dhe Ruisë* [DHM], 2004, § 461). Nëse dënimi është rezultat i procedurave që kanë qenë "dukshëm në kundërshtim me dispozitat e nenit 6, ose parimet e parashikuara në të", privimi i lirisë nuk do të përliqet sipas nenit 5 paragrafit 1 (a) (*Willcox and Hurford kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend. pran.), 2013, § 95, me shembuj të formave të drejtësisë që përbëjnë mohim flagrant të drejtësisë; shih edhe *Stoichkov kundër Bullgarisë*, 2005, §§ 56-58, dhe *Vorontsov dhe të tjerë kundër Ukrainës*, 2021, §§ 42-49 në lidhje me zbatimin e parimit në proceset e brendshme).

2. Gjykata kompetente

56. Termi "gjykatë" tregon organe të cilat paraqesin jo vetëm tipare themelore të përbashkëta, ku më e rëndësishmja është pavarësia e ekzekutivit dhe e palëve ndaj çështjes, por edhe garancitë e një procedure gjyqësore (*Weeks kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1987, § 61; *De Wilde, Ooms dhe Versyp kundër Belgjikës*, 1971, § 78). Megjithatë, format e procedurës nuk është e thënë të jenë domosdoshmërisht identike në secilën nga rastet ku kërkohet ndërhyrja e gjykatës. Për të vendosur nëse një proces ofron ose jo garanci të mjaftueshme, duhet pasur parasysh natyra e veçantë e rrethanave në të cilat ai zhvillohet (*ibid*).

57. Përveç kësaj, organi në fjalë nuk duhet të ketë thjesht attribute këshillimore, por edhe kompetencën për të vendosur për ligjshmërinë e paraburgimit dhe për urdhërimin e lirimit në rast paraburgimi të paligjshëm (*X kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1981, § 61; *Weeks kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1987, § 61).

58. Një gjykatë nuk është "kompetente" nëse përbërja e saj nuk është e "përcaktuar me ligj" (*Yefimenko kundër Ruisë*, 2013, §§ 109-111).

3. Burgimi duhet të vijë "pas" një dënimi

59. Fjala "pas" nuk nënkupton thjesht që paraburgimi duhet ndjekë pas dënimit në aspektin kohor; gjithashtu, burgimi duhet të rezultojë, të ndjekë dhe të varet nga dënimi ose të ndodhë për shkak të dënimit. Me një fjalë, duhet të ekzistojë një lidhje e mjaftueshme shkakësore ndërmjet dënimit dhe privimit të lirisë në fjalë (*James, Wells dhe Lee kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 189; *Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1987, § 40; *Del Río Prada kundër Spanjës* [DHM], 2013, § 124).

60. Sidoqoftë, kjo lidhje shkakësore dobësohet gradualisht me kalimin e kohës dhe mund të shpëputet fare më në fund në rast se vendimi për moslirim ose për ri-burgim (përfshirë zgjatjen e paraburgimit parandalues) do të bazohej në shkaqe që nuk lidheshin me objektivat e ligjvënësit ose të gjykatës apo në një vlerësim të paarsyeshëm sa i përket këtyre objektiveve. Në këto rrethana, burgimi që do të ishte i ligjshëm në fillim do të shndërrohej në privim lirie që do të ishte arbitrar dhe, rrjedhimisht, jo në përputhje me nenin 5 (*ibid.*, § 124; and *H.W. kundër Gjermanisë*, 2013, § 102; *M. kundër Gjermanisë*, 2009, § 88, për vazhdimin e ndalimit parandalues; *W.A. kundër Zvicrës*, 2021, §§ 39-45,

ku urdhri për ndalimin parandalues të kërkuesit i dhënë në proces të rihapur nuk ishte në përputhje me qëllimet e dënimit të tij fillestar).

61. Gjykata ka gjetur që forma të ndryshme të paraburgimit parandalues përtej dënimit me burgim përbënin një paraburgim e kërkuesit "pas dënimit nga një gjykatë kompetente". Në këto rrethana, paraburgimi në fjalë nuk është pjesë e një mase ndëshkuese, por më së shumti rezulton nga një tjetër "masë që përfshin privimin e lirisë" (shih *Ruslan Yakovenko kundër Ukrainës*, 2015, § 51 me referenca të mëtejshme).

62. Vendimi për të mos liruuar të paraburgosurin mund të bëhet jo në përputhje me objektivat e vendimit të burgimit të gjykatës që ka dhënë dënimin nëse personi në fjalë vazhdon të mbahet i paraburgosur për shkak të rrezikut se ai ose ajo mund të kryejnë përsëri vepër penale, por personi njëkohësisht është privuar nga mjetet e nevojshme, siç janë terapia e përshtatshme për të treguar që ai ose ajo nuk është më i/e rrezikshëm (*Klinkenbuß kundër Gjermanisë*, 2016, § 47).

63. Arsyeshmëria e vendimit për të zgatur paraburgimin e një personi me qëllim mbrojtjen e publikut vihet në diskutim nëse gjykatat e brendshme kanë pasur në dispozicion elementë të pamjaftueshëm që të kenë justifikuar përfundimin që personi në fjalë ka qenë akoma i rrezikshëm për publikun, sidomos për shkak se gjykatat nuk arritën të merrnin të përditësuar mendimin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm të ekspertit. Çështja nëse ekspertiza mjekësore ishte e përditësuar nuk ka gjetur përgjigje nga Gjykata në mënyrë statike, por varet nga rrethanat specifike të rastit, sidomos, nëse ka pasur ndryshime që mund të kenë qenë të rëndësishme në situatën e kërkuesit që nga ekzaminimi i fundit nga një ekspert (*D.J. kundër Gjermanisë*, 2017, §§ 59-61). Për më tepër, kur autori i veprës penale është mbajtur në të njëjtin institucion për një kohë të konsiderueshme dhe trajtimi i tij terapeutik ka arritur në një bllokim, është veçanërisht e rëndësishme konsultimi me një ekspert të jashtëm në mënyrë që të merren propozime të reja për fillimin e trajtimit të nevojshëm (*Tim Henrik Bruun Hansen kundër Danimarkës*, 2019, §§ 77-78).

64. Një i pandehur konsiderohet i burgosur "pas dënimit nga një gjykatë kompetente" sipas kuptimit të nenit 5 § 1 (a) pasi vendimi gjyqësor të jetë shpallur në shkallën e parë, edhe kur ai nuk është ende i zbatueshëm dhe mbetet i ankimueshëm. (*Ruslan Yakovenko kundër Ukrainës*, 2015, § 46). Shprehja "pas dënimit" nuk mund të interpretohet sikur kufizohet vetëm me rastin e një dënimi të formës së prerë, sepse kjo do të përjashtonte arrestimin e personave të dënuar që janë paraqitur për gjykimin, ndërsa janë në gjendje të lirë. Nuk mund të anashkalohet fakti që fajësia e një personi të burgosur gjatë procesit në apel apo rekursit është përcaktuar gjatë një procesi gjyqësor të zhvilluar në përputhje me kërkesat e nenit 6 (*Wemhoff kundër Gjermanisë*, 1968, § 9).

65. Neni 5 § 1 (a) zbatohet kur persona me çrregullim mendor mbahen në spital psikiatrik pas dënimit (*Klinkenbuß kundër Gjermanisë*, 2016, § 49; *Radu kundër Gjermanisë*, 2013, § 97; *X kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1981, § 39). Megjithatë, nuk do të zbatohet për këto çështje pas deklarimit të pafajsisë (*Luberti kundër Italisë*, 1984, § 25).

4. Ndikimi i proceseve të ankimit

66. Një periudhë burgimi është, në parim, e ligjshme nëse ajo zbatohet në bazë të një vendimi gjyqësor. Vlerësimi i mëpasshëm se gjykata ka gabuar në bazë të së drejtës vendase, në dhënien e vendimit që ka urdhëruar burgimin nuk ndikon domosdoshmërisht me prapaveprim në vlefshmërinë e periudhës përkatëse të burgimi. Organet e Strasburgut kanë refuzuar të pranojnë kërkesat nga persona të dënuar për vepra penale, të cilët ankohen se gjykatat vendase të apelit i kanë gjetur dënimet e tyre të bazuara në gabime të faktit ose të ligjit (*Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1996, § 42). Megjithatë, burgimi pas dënimit është i paligjshëm në qoftë se nuk ka bazë në të drejtën e brendshme ose është arbitrar (*Tsirlis dhe Kouloumpas kundër Greqisë*, 1997, § 62).

B. Burgimi për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata ose mospërmbushje të një detyrimi të parashikuar me ligj

Neni 5 paragrafi 1 (b) i Konventës

“1. ... Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet e mëposhtme dhe në përputhje me procedurat e parashikuara me ligj:

...

b) kur arrestohet ose burgoset ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;

Fjalët kyçe të HUDOC

Privimi i lirisë (5-1) – Procedura e parashikuar me ligj (5-1) – Arrestim ose burgim i ligjshëm (5-1)

Urdhër i ligjshëm i një gjykate (5-1-b) – Moszbatimi i urdhrit të gjykatës (5-1-b) – Garantimi i përmbushjes së detyrimit të parashikuar me ligj (5-1-b)

1. Moszbatimi i një urdhri të dhënë nga gjykata

67. Zgjedhja e fjalëve në pjesën e parë të nenit 5 § 1 (b) prezumon që personi i arrestuar ose i paraburgosur duhet të ketë pasur mundësinë e zbatimit të një urdhri gjykate, por nuk e ka bërë këtë gjë (*Beiere kundër Letonisë*, 2011, § 49).

68. Individët nuk mund të mbajnë përgjegjësi për moszbatimin e urdhrave të gjykatës nëse nuk janë informuar asnjëherë lidhur me ato urdhëra (*ibid.*, § 50).

69. Refuzimi i një personi për t’iu nënshtruar disa masave apo për të ndjekur një procedure të caktuar përpara se të urdhërohet nga një gjykatë kompetente që t’i nështrohet nuk ka asnjë vlerë prezumuese në vendimet lidhur me respektimin e një urdhri të tillë gjykate (*Petukhova kundër Rusisë*, 2013, § 59).

70. Autoritetet e vendase duhet të ruajnë një ekuilibër të drejtë ndërmjet rëndësisë që në një shoqëri demokratike të sigurohet zbatimi i urdhrave të ligjshme të një gjykate dhe rëndësisë së të drejtës për liri. Faktorët që duhet të merren parasysh përfshijnë qëllimin e urdhrit, mundësinë praktike të përmbushjes të urdhrit dhe kohëzgjatjen e burgimit. Çështja e proporcionalitetit merr rëndësi të veçantë në tërëinë e skemës së gjërave (*Gatt kundër Maltës*, 2010, § 40).

71. Organet e Konventës kanë zbatuar pjesën e parë të neni 5 § 1 (b) për raste që kishin të bënin, ndër të tjera, me mospagimin e një gjobe të vendosur nga një gjykatë (*Velinov kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, 2013; *Airey kundër Irlandës*, vendim i Komisionit i 7 korrikut 1977), me mospranimin për t’iu nënshtruar ekzaminimit mjekësor në lidhje me shëndetin mendor (*X. kundër Gjermanisë*, vendim i Komisionit i 10 dhjetorit 1975), apo me nënshtrimin ndaj një analize gjaku të urdhëruar nga një gjykatë (*X. kundër Austrisë*, vendim i Komisionit i 13 dhjetorit 1979), me dështimin për të zbatuar kufizimin e vendbanimit (*Freda kundër Italisë*, vendim i Komisionit i 7 tetorit 1980), me moszbatimin e vendimit për t’i dhënë fëmijët një prindi (*Paradis kundër Gjermanisë* (vend. pran.), 2007), me moszbatimin e urdhrave të detyrueshme (*Steel dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1998), me shkeljen e kushteve të garancisë pasurore (*Gatt kundër Maltës*, 2010) dhe me izolimin në një spital psikiatrik (*Trutko kundër Rusisë*, 2016 dhe *Beire kundër Letonisë*, 2011, ku procedurat e brendshme nuk kishin ofruar garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit).

2. Përmbushja e një detyrimi të parashikuar me ligj

72. Pjesa e dytë e nenit 5 § 1 (b) lejon burgimin vetëm për të “garantuar përmbushjen” e një detyrimi të parashikuar me ligj. Pra duhet të ketë një detyrim të papërmbushur për personin përkatës dhe që arrestimi dhe ndalimi i tij të bëhet për të garantuar përmbushjen e këtij detyrimi dhe të mos ketë natyrë ndëshkimore. Sapo të jetë përmbushur detyrimi përkatës, baza për paraburgim sipas nenit 5 § 1 (b) pushon së ekzistuari (*Vasileva kundër Danimarkës*, 2003, § 36; *S., v. dhe A. kundër Danimarkës* [DHM], 2018, §§ 80-81).

73. Neni 5 § 1 (b) i referohet përsëri së drejtës vendase për përmbajtjen e detyrimit, si dhe procedurës që duhet të ndiqet për vendosjen dhe përmbushjen e këtij detyrimi (*Rozhkov kundër Ruisë (nr. 2)*, 2017, § 89).

74. Detyrimi duhet të ketë natyrë specifike dhe konkrete (*Ciulla kundër Italisë*, 1989, § 36). Një interpretim i gjerë do të sillte pasoja që nuk përputhen me nocionin e shtetit të së drejtës (*S., v. dhe A. kundër Danimarkës* [DHM], 2018, § 83; *Engel dhe të tjerë kundër Holandës*, 1976, § 69; *Iliya Stefanov kundër Bullgarisë*, 2008, § 72).

75. Detyrimi për të mos kryer veprë penale mund të konsiderohet si “specifik dhe konkret” vetëm nëse janë saktësuar në mënyrë të mjaftueshme vendi dhe data e kryerjes së veprës penale, si dhe viktimat e mundshme të saj. Kur bëhet fjalë për një detyrim për të mos bërë diçka, në dallim nga një detyrim për të bërë një veprim specifik, është e nevojshme që, përpara se të arrihet në konkluzionin se një person nuk e ka përmbushur detyrimin në fjalë, personi përkatës të ketë qenë i vetëdijshëm për veprimin specifik të cilin ai ose ajo nuk duhej ta kishte kryer, si dhe personi të ketë treguar se nuk kishte vullnet për të mos e kryer atë (*Kurt kundër Austrisë* [DHM], 2021, § 185; *Ostendorf kundër Gjermanisë*, 2013, §§ 93-94).

Detyrimi për të mos kryer një veprë penale në të ardhmen e afërt nuk mund të konsiderohet mjaftueshëm konkret dhe specifik, sa kohë që nuk janë urdhëruar masa specifike të cilat nuk janë zbatuar (*S., v. dhe A. kundër Danimarkës* [DHM], 2018, § 83).

76. Në vështrim të Konventës, arrestimi do të pranohet vetëm nëse “detyrimi i parashikuar me ligj” nuk mund të përmbushet me masa më të buta (*Khodorkovskiy kundër Ruisë*, 2011, § 136). Përveç kësaj, parimi i proporcionalitetit kërkon gjithashtu që të ruhet një ekuilibër mes rëndësisë që në një shoqëri demokratike të garantohet përmbushja e menjëhershme e detyrimit për të cilin bëhet fjalë dhe rëndësisë së të drejtës për liri (*Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2008, § 70).

77. Në këtë vlerësim, Gjykata konsideron të rëndësishme çështjet që vijnë: natyrën e detyrimit që rrjedh nga legjislacioni përkatës, duke përfshirë objektin dhe qëllimin e tij themelor; personin e paraburgosur dhe rrethanat e veçanta që kanë çuar në paraburgimin e tij; si edhe kohëzgjatjen e paraburgimit (*S., v. dhe A. kundër Danimarkës* [DHM], 2018, § 75; *Vasileva kundër Danimarkës*, 2003, § 38; *Epple kundër Gjermanisë*, 2005, § 37).

78. Situatat e shqyrtuara sipas pjesës së dytë të nenit 5 § 1 (b) përfshijnë për shembull, detyrimin për t'iu nënshtruar kontrollit të sigurisë gjatë hyrjes në një vend (*McVeigh dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, raport i Komisionit i 18 marsit 1981), për të dhënë detaje të identitetit të tij personal (*Vasileva kundër Danimarkës*, 2003; *Novotka kundër Sllovakisë* (vend. pran.), 2003; *Sarigiannis kundër Italisë*, 2011), për t'iu nënshtruar një ekzaminimi psikiatrik (*Nowicka kundër Polonisë*, 2002), për t'u larguar nga një zonë e caktuar (*Epple kundër Gjermanisë*, 2005), për t'u paraqitur për pyetje në një rajon policie (*Iliya Stefanov kundër Bullgarisë*, 2008; *Osyenko kundër Ukrainës*, 2010 dhe *Khodorkovskiy kundër Ruisë*, 2011), për të ruajtur qetësinë, duke mos kryer një veprë penale (*Ostendorf kundër Gjermanisë*, 2013), si dhe për të treguar vendndodhjen e pronës së sekuestruar për të siguruar pagesën e detyrimeve tatimore (*Göthlin kundër Suedisë*, 2014).

C. Paraburgimi

Neni 5 paragrafi 1 (c) i Konventës

"1. ... Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet e mëposhtme dhe në përputhje me procedurat e parashikuara me ligj:

...

c) kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka dyshim i arsyeshëm se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;

Fjalët kyçe të HUDOC

Privimi i lirisë (5-1) – Procedura e parashikuar me ligj (5-1) – Arrestim ose burgim i ligjshëm (5-1) – Të çuarit përpara autoritetit gjyqësor kompetent (5-1-c) - Vepër penale (5-1-c) - Motive të arsyeshme (5-1-c) - E nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale (5-1-c) - E nevojshme që të largohet pas kryerjes së saj (5-1-c)

1. Qëllimi i arrestimit ose paraburgimit

79. Qëllimi "për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent" kualifikon të gjitha tre bazat alternative të arrestimit ose të paraburgimit që parashikohen në nenin 5 § 1 (c) (*Lawless kundër Irlandës (nr. 3)*, 1961, §§ 13-14; *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1978, § 196).

80. Një person mund të arrestohet sipas pjesës së parë të nenit 5 § 1 (c) vetëm në kontekstin e procedimit penal, me qëllim për ta çuar atë përpara autoritetit kompetent me dyshimin se ai ka kryer një vepër penale (*Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2)* [DHM], 2020, § 314; *Şahin Alpay kundër Turqisë*, 2018, § 103; *Ječius kundër Lituanisë*, 2000, § 50; *Schwabe dhe M.G. kundër Gjermanisë*, 2011, § 72).

81. Paraburgimi mund të funksionojë si masë parandaluese vetëm për sa kohë që është i përligjur për shkaqe të dyshimit të arsyeshëm në lidhje me një vepër penale ekzistuese për të cilën janë duke u zhvilluar procedime penale (*Kurt kundër Austrisë* [DHM], 2021, § 187).

82. Alternativa e dytë e asaj dispozite ("kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të shmanget kryerja e tij e një veprë penale") nuk lejon një politikë parandalimi të përgjithshëm të drejtuar kundër një individi ose një kategorie individësh që perceptohen nga autoritetet si të rrezikshëm ose që kanë prirje për të kryer akte të paligjshme. Ky shkak ndalimi nuk bën më shumë sesa u ofron Shteteve Kontraktuese një mjet për të parandaluar një vepër penale konkrete dhe specifike, sidomos në lidhje me vendin dhe kohën e kryerjes së saj dhe viktimën/viktimat e saj. Që një arrestim të përligjet sipas pjesës së dytë të nenit 5 § 1 (c), autoritetet duhet të tregojnë bindshëm se personi në fjalë me shumë gjasa do të kishte qenë i përfshirë në veprën penale konkrete dhe specifike, nëse kryerja e saj nuk do të ishte parandaluar nga arrestimi i tij (*Kurt kundër Austrisë* [DHM], 2021, § 186; *S., v. dhe A. kundër Danimarkës* [DHM], 2018, § 89 dhe 91).

83. Pjesa e dytë e nenit 5 § 1 (c) jep një shkak të dallueshëm për arrestim, pavarësisht nga ekzistenca e një "dyshimi i arsyeshëm se ai ka kryer një vepër penale". Pra zbatohet për paraburgimin parandalues jashtë procesit penal (*S., v. dhe A. kundër Danimarkës* [DHM], 2018, §§ 114-116, në lidhje me paraburgimin për të parandaluar dhunën ndaj spektatorëve).

84. Ekzistenca e qëllimit për ta çuar të dyshuarin përpara një gjykate duhet të konsiderohet pavarësisht nga realizimi i tij. Standardi i vendosur nga neni 5 § 1 (c) nuk presupozon që policia të ketë mbledhur prova të mjaftueshme për të ngritur akuza, qoftë në momentin e arrestimit, qoftë gjatë paraburgimit të tij (*Petkov dhe Profirov kundër Bullgarisë*, 2014, § 52; *Erdagöz kundër Turqisë*, 1997, § 51). Objekti i marrjes në pyetje gjatë paraburgimit sipas pikës (c) të paragrafit 1 të nenit 5 është që

të përparojë hetimi penal duke konfirmuar ose mënjanuar dyshimet konkrete ku mbështetet arrestimi (*Mehmet Hasan Altan kundër Turqisë*, 2018, § 125; *Brogan dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1988, §§ 52-54; *Labita kundër Italisë* [DHM], 2000, § 155; *O'Hara kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2001, § 36).

85. Kërkesa për "qëllimin" e sjelljes së një të paraburgosuri para gjykatës duhet të zbatohet me një shkallë fleksibiliteti për paraburgimin që parashikohet sipas pjesës së dytë të nenit 5 § 1 (c), në mënyrë që të mos zgjatet pa nevojë paraburgimi i shkurtër parandalues. Kur një person lirohet nga paraburgimi parandalues pas një periudhe kohore të shkurtër, qoftë sepse rreziku ka kaluar ose, për shembull, sepse ka skaduar një afat i shkurtër kohor i përcaktuar, kërkesa e qëllimit nuk duhet të përbëjë pengesë për paraburgimin parandalues (*S., v. dhe A. kundër Danimarkës* [DH], 2018, §§ 118-126).

86. Kur procedimet penale u pezulluan për një kohë të pacaktuar gjatë pandemisë Covid-19, baza e paraburgimit të kërkuesit gjatë periudhës në fjalë vazhdoi të jetë ai i çuarjes së tij para autoritetit gjyqësor kompetent (*Fenech kundër Maltës* (vend. pran.), 2021, §§ 83-88).

87. Paraburgimi sipas nenit 5 § 1 (c) duhet të jetë masë proporcionale për të arritur qëllimin e shprehur (*Ladent kundër Polonisë*, 2008, §§ 55-56). Autoriteteve të brendshme u takon të tregojnë bindshëm që paraburgimi është i nevojshëm. Kur autoritetet urdhërojnë paraburgimin e një individi në pritje e sipër të gjykimit për shkak të mosparaqitjes së tij ose të saj para tyre kur është thirrur, duhet të sigurohen që individi në fjalë të jetë njoftuar si duhet dhe t'i jetë dhënë kohë e mjaftueshme për ta zbatuar dhe të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të verifikuar nëse ai ose ajo në fakt është fshehur (*Vasiliciuc kundër Republikës së Moldavisë*, 2017, § 40).

88. Testi i domosdoshmërisë sipas pjesës së dytë të nenit 5 § 1 (c) kërkon që masat më pak të rënda se paraburgimi duhet të merren në konsideratë dhe jenë gjetur të pamjaftueshme për të mbrojtur interesin individual ose publik. Vepra penale në fjalë duhet të jetë me natyrë të rëndë, që sjell dëmtim dhe rrezik për jetën ose dëme të konsiderueshme materiale. Për më tepër, paraburgimi duhet të pushojë sapo të ketë kaluar rreziku, gjë që kërkon monitorim, ku kohëzgjatja e paraburgimit është gjithashtu një faktor i rëndësishëm (*S., v. dhe A. kundër Danimarkës* [DHM], 2018, § 161).

89. Shprehja "autoritet gjyqësor kompetent" ka të njëjtin kuptim si "gjyqtar ose një zyrtar tjetër i autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore" në nenin 5 § 3 (*Schiesser kundër Zvicrës*, 1979, § 29).

2. Kuptimi i "dyshimit të arsyeshëm"

90. "Arsyeshmëria" e dyshimit mbi të cilin duhet të bazohet arrestimi përbën një pjesë thelbësore të garancisë të përcaktuar në nenin 5 § 1 (c) (*Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2)* [DHM], 2020, § 314; *Mehmet Hasan Altan kundër Turqisë*, 2018, § 124; *Fernandes Pedrosa kundër Portugalisë*, 2018, § 87). Fakti që një dyshim ekziston në mirëbesim është i pamjaftueshëm në vetvete (*Sabuncu dhe të tjerë kundër Turqisë*, 2020, § 145).

91. "Dyshimet e arsyeshme" që është kryer një vepër penale presupozojnë ekzistencën e fakteve ose informacionit që do të bindte një vëzhgues objektiv se personi në fjalë mund të ketë kryer një vepër penale (*Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2)* [DHM], 2020, § 314; *Ilgar Mammadov kundër Azerbajxhanit*, 2014, § 88; *Erdagöz kundër Turqisë*, 1997, § 51; dhe *Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1990, § 32). Prandaj, dështimi i autoriteteve për të kryer një hetim të të mirëfilltë për faktet bazë të një çështjeje, me qëllim që të verifikojnë nëse ëse një ankesë ka qenë e bazuar - përbën shkelje të nenit 5 § 1 (c) (*Stepuleac kundër Moldavisë*, 2007, § 73; *Elçi dhe të tjerë kundër Turqisë*, 2003, § 674; *Moldoveanu kundër Republikës së Moldavisë*, 2021, §§ 52-57, ku kërkuesi ishte arrestuar dhe ndaluar me akuzën e mashtrimit pas mospagimit të borxhit të një palë e tretë).

92. Dyshimet duhet të jenë të përligjura me prova të verifikueshme dhe objektive. Referenca të paqarta dhe të përgjithshme të vendimet dhe dokumentet e autoriteteve për një dispozitë ligjore ose

"material të çështjes" të paspecifikuar nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme për të justifikuar "arsyeshmërinë" e dyshimit, në mungesë të një deklarimi specifik, informacioni ose ankimi (*Akgün kundër Turqisë*, 2021, §§ 156 dhe 175).

93. Ajo që është e arsyeshme varet nga të gjitha rrethanat, por faktet që krijojnë dyshimin nuk duhet të jenë të njëjtë nivel si ato që janë të nevojshme për të përligjur dënimin, apo edhe ngritjen e akuzës (*Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DHM], 2017, § 184).

94. Termi "të arsyeshme" gjithashtu do të thotë kufiri që dyshimi duhet të plotësojë për të bindur një vëzhgues objektiv për mundësinë e akuzave (*Kavala kundër Turqisë*, 2019, § 128).

95. Si rregull, problemet me "dyshimin e arsyeshëm" lindin në nivelin e fakteve. Më pas shtrohet pyetja nëse arrestimi dhe paraburgimi janë bazuar në elemente mjaftueshëm objektive për të justifikuar "dyshim të arsyeshëm" që kanë ndodhur faktet në fjalë. Përveç anës faktike, ekzistenca e "dyshimeve të arsyeshme" sipas kuptimit të nenit 5 § 1 (c) kërkon që faktet të konsiderohen në mënyrë të besueshme si të tilla që përfshihen në një nga nenet e ligjit në lidhje me sjelljen kriminale. Prandaj, qartazi nuk mund të ketë "dyshime të arsyeshme nëse aktet ose faktet e gjetura kundër personit të paraburgosur nuk përbëjnë krim në momentin që kanë ndodhur (*Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2)* [DHM], 2020, § 317; *Sabuncu dhe të tjerë kundër Turqisë*, 2020, §§ 146-147).

96. Për më tepër, nuk duhet të duket që vetë veprat e pretenduara të kenë lidhje me ushtrimin e të drejtave të ankuesve sipas Konventës (*Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2)* [DHM], 2020, § 318; *Sabuncu dhe të tjerë kundër Turqisë*, 2020, § 148; *Ragıp Zarakolu kundër Turqisë*, 2020, § 41). Kur një paraburgim i paligjshëm përbën ndërhyrje në njërin nga liritë e garantuara nga Konventa, ai nuk mund të konsiderohet në parim si një ndërhyrje e përcaktuar nga legjislacioni kombëtar (*Sabuncu dhe të tjerë kundër Turqisë*, 2020, § 230; shih gjithashtu *Karaca kundër Turqisë*, 2023, §§ 154-160, në lidhje me efektin e paraburgimit të ligjshëm të kërkesit në vlerësimin e ndërhyrjes në lirinë e tij të shprehjes sipas nenit 10 të Konventës).

97. Në vlerësimin nëse është përmbushur standardi minimal i dyshimit të arsyeshëm për të kërkuar për arrestimin e një individi, Gjykata merr parasysh kontekstin e përgjithshëm të fakteve të një çështjeje të caktuar, sidomos statusin e ankuesit, kronologjinë e ngjarjeve, mënyrën se si janë kryer hetimet dhe sjelljen e autoriteteve (*Ibrahimov dhe Mammadov kundër Azerbajxhanit*, 2020, §§ 113-131; shih gjithashtu *Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 4)*, 2025, §§ 207-208 për një kontekst të trazirave publike).

Standardi minimal nuk u përmbush kur arrestimi dhe paraburgimi i ankuesve mbi dyshimin për kryerjen e krimit të trazirave masive u njoftos nga arbitrariteti dhe u bë pjesë e një strategjie të autoriteteve për të penguar dhe për t'i dhënë fund protestave paqësore (*Shmorgunov dhe të tjerë kundër Ukrainës*, 2021, §§ 464-477).

Nuk u gjet asnjë dyshim i arsyeshëm kur ankuesi ishte viktimë e një arrestimi të kryer në masë (*en masse*) pa ndonjë vlerësim individual të kriminalizimit të veprimeve të tij (*Ishkhanyan kundër Armenisë*, 2025, §§ 158-162).

98. Ndërsa duhet të ekzistojë dyshim i arsyeshëm që në kohën e arrestimit dhe paraburgimit fillestar, duhet të tregohet gjithashtu, në rastet e zgjatjes së paraburgimit, se dyshimi ka vazhduar dhe ka mbetur i "arsyeshëm" gjatë gjithë paraburgimit (*Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2)* [DHM], 2020, § 320; *Ilgar Mammadov kundër Azerbajxhanit*, 2014, § 90).

99. Në kontekstin e terrorizmit, megjithëse Shteteve Kontraktuese nuk mund t'u kërkohej të përcaktojnë arsyeshmërinë e dyshimit ku mbështetet arrestimi i një terroristi të dyshuar, duke zbuluar burime konfidenciale informacioni, Gjykata ka vendosur se nevoja për përballjen me krimin të terrorizmit nuk mund të justifikojë shtrirjen e nocionit të "dyshimit të arsyeshëm" deri në atë pikë sa të cenohet garancia e siguruar nga neni 5 § 1 (c) (*O'Hara kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2001, § 35; *Baş kundër Turqisë*, 2020, § 184).

100. Mbledhja e mëpasshme e provave në lidhje me një akuzë të caktuar ndonjëherë mund të përforcojë një dyshim që lidh një kërkues me kryerjen e veprave penale të terrorizmit. Megjithatë, kjo nuk mund të formojë e vetme bazën e një dyshimi që përlligj paraburgimin. Në çdo rast, mbledhja e mëpasshme e këtyre provave nuk i shkarkon autoritetet kombëtare nga detyrimi i tyre për të ofruar një bazë të mjaftueshme faktike që të mund të përlligjë paraburgimin fillestar të një personi (*Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2)* [DHM], 2020, § 321). Ndërsa konteksti i një çështjeje duhet të merret parasysh në interpretimin dhe zbatimin e nenit 5, autoritetet nuk kanë *carta bianca* për të urdhëruar paraburgimin e një personi gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, pa ndonjë provë ose informacion të verifikueshëm ose pa një bazë të mjaftueshme faktike që përmbush kërkesat minimale të nenit 5 § 1 (c) (*Akgün kundër Turqisë*, 2021, § 184).

101. Dëshmitë e pa ndërlidhura që vijnë nga informatorë anonimë janë gjetur se nuk mund të përbëjnë një bazë të mjaftueshme për të bazuar “dyshimin e arsyeshëm” se kërkuesi ishte përfshirë në veprimtari mafioze (*Labita kundër Italisë* [DHM], 2000, §§ 156 et seq.). Në të kundërt, deklarata inkriminuese të bëra vite më parë, që më pas janë tërhequr nga të dyshuarit, nuk e kanë hequr ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme kundër kërkuesit. Për më tepër, kjo nuk pati ndonjë efekt në ligjshmërinë e urdhrit të arrestit (*Talat Tepe kundër Turqisë*, 2004, § 61). Gjykata ka pranuar gjithashtu se deklaratat konkrete dhe të detajuara të një dëshmitari anonim mund të përbëjnë një bazë të mjaftueshme faktike për dyshim të arsyeshëm në kontekstin e krimit të organizuar (*Yaygin kundër Turqisë* (vend. pran.), 2021, §§ 37-46).

3. Termi “vepër penale”

102. Termi “vepër” ka një kuptim autonom, identik me atë të "veprës penale" të përdorur në nenin 6. Klasifikimi i shkeljes sipas së drejtës së brendshme është një element që duhet merrë parasysh. Megjithatë, natyra e procedurës dhe rëndësia e masës ndëshkuese në fjalë janë gjithashtu të rëndësishme (*Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1996, § 56; *S., v. dhe A. kundër Danimarkës* [DHM], 2018, § 90).

D. Ndalimi i një të mituri

Neni 5 paragrafi 1 (d) i Konventës

"1. ... Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet e mëposhtme dhe në përputhje me procedurat e parashikuara me ligj:

...

d) kur një i mitur ndalohet ligjërisht, për qëllim edukimi të mbikëqyrur, ose për ndalimin e tij të ligjshëm, me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor;

Fjalët kyçe të HUDOC

Privimi i lirisë (5-1) – Procedura e parashikuar me ligj (5-1) – Arrestim ose burgim i ligjshëm (5-1)

I mitur (5-1-d) - Edukimi i mbikëqyrur (5-1-d) - Sjellja përpara autoritetit kompetent ligjor (5-1-d)

1. Të përgjithshme

103. Nocioni i të miturit, nën dritën e standardeve europiane dhe Rezolutës CM (72) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës (*X kundër Zvicrës*, vendim i Komisionit i 14 dhjetorit 1979), përfshin personat nën moshën 18 vjeç (*Koniarska kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend. pran.), 2000).

104. Nënparagrafi (d) nuk është vetëm një dispozitë që lejon ndalimin e një të mituri. Ajo përmban një shembull të veçantë, por jo shterues të rrethanave se kur mund të ndalohet një i mitur, përkatësisht për qëllim a) mbikëqyrjeje arsimore ose b) për ta çuar atë përpara autoritetit kompetent gjyqësor (*Mubilanzila Mayeka dhe Kaniki Mitunga kundër Belgjikës*, 2006, § 100).

2. Mbikëqyrja arsimore

105. Pjesa e parë e nenit 5 § 1 (d) autorizon privimin e lirisë së të miturit për interesin e tij, pavarësisht nëse është apo jo i dyshuar për kryerjen e një vepre penale, ose nëse është thjesht një i mitur "në rrezik" (*D.L. kundër Bullgarisë*, 2016, § 71).

106. Në kontekstin e ndalimit të të miturve, shprehja "mbikëqyrje arsimore" nuk duhet të barazohet në mënyrë të ngushtë me nocionet e mësimdhënies në klasë. Kjo mbikëqyrje duhet të përfshijë aspekte të shumta të ushtrimit të të drejtave prindërore nga autoriteti, për dobinë dhe mbrojtjen e personit përkatës (*P. dhe S. kundër Polonisë*, 2012, § 147; *Ichin dhe të tjerë kundër Ukrainës*, 2010, § 39; *D.G. kundër Irlandës*, 2002, § 80).

"Mbikëqyrje arsimore" duhet të përmbajë një aspekt të rëndësishëm e thelbësor të shkollimit në mënyrë që shkollimi, në përputhje me programin mësimor të shkollimit së zakonshëm, të jetë praktikë standarde për të gjithë të miturit e ndaluar, edhe kur janë në qendër ndalimi të përkohshëm për një periudhë të kufizuar kohore, me qëllim shmangien e boshllëqeve në shkollimin e tyre (*Blokhin kundër Rusisë* [DHM], 2016, § 170).

107. Ndalimi për "korigjimin e sjelljes" ose për nevojën e parandalimit të kryerjes së veprave të tjera penale nga një i mitur nuk është i lejueshëm sipas nenit 5 § 1 (d) të Konventës (*Blokhin kundër Rusisë* [DHM], 2016, § 171).

108. Nënparagrafi (d) nuk e pengon përdorimin e një mase të përkohshme paraburgimi që shërben si një hap paraprak i regjimit të mbikëqyrjes arsimore, pa përfshirë, në vetvete, mbikëqyrjejen arsimore. Megjithatë, në të tilla rrethana, paraburgimi duhet të pasohet pa vonesë nga zbatimi real i këtij regjimi në një mjedis (të hapur ose të mbyllur) të projektuar posaçërisht dhe me burime të mjaftueshme për këtë qëllim (*Bouamar kundër Belgjikës*, 1988, § 50; *D.K. kundër Bullgarisë*, 2020, §§ 78-84 ku Gjykata

e vlerësoi të pranueshëm qëndrimin e ankueses për dy ditë në një qendër krize për të miturit përpara transferimit të saj në një shkollë rehabilitimi me konvikt).

109. Gjithashtu, vendosja e të miturit në një institucion të mbyllur duhet të jetë proporcionale me qëllimin e "mbikëqyrjes arsimore". Ajo duhet të jetë masa e fundit, e marrë në interesin më të lartë të të miturit, me qëllim parandalimin e rrezikut serioz për zhvillimin e të miturit (*D.L. kundër Bullgarisë*, 2016, § 74).

110. Nëse Shteti ka zgjedhur një sistem mbikëqyrjeje arsimore që përfshin privimin e lirisë, ai është i detyruar të sigurojë infrastrukturë institucionale të përshtatshme, e cila duhet të përmbushë kërkesat e sigurisë dhe edukimit të sistemit në fjalë në mënyrë që të plotësohen kërkesat e nenit 5 § 1 (d) (*A. dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, 2011, § 69; *D.G. kundër Irlandës*, 2002, § 79).

Sa i përket zbatimit të një sistemi pedagogjik dhe arsimor të caktuar, Shtetit duhet t'i njihet një hapësirë e caktuar vlerësimi (*D.L. kundër Bullgarisë*, 2016, § 77).

111. Gjykata nuk vlerëson se një qendër ndalimi për të mitur, mund të konsiderohet, në vetvete, si "mbikëqyrjeje arsimore" nëse nuk ofrohen veprimtari edukative në të (*Ichin dhe të tjerë kundër Ukrainës*, 2010, § 39).

3. Autoriteti kompetent ligjor

112. Pjesa e dytë e nenit 5 § 1 (d) ka të bëjë me ndalimin e ligjshëm të një të mituri me qëllim për ta çuar atë përpara autoritetit kompetent gjyqësor. Sipas *travaux préparatoires*, (punimeve përgatitore) kjo dispozitë kishte për qëllim që të trajtonte ndalimin e të miturit përpara një procedure civile ose administrative, ndërsa neni 5 § 1 (c) duhej të zbatohet për paraburgimin lidhur me një procedim penal.

113. Megjithatë, paraburgimi i të miturit, akuzuar për një krim gjatë përgatitjes së një raporti psikiatrik të nevojshëm lidhur me vendimmarrjen për gjendjen e tij mendore, është vlerësuar si ndalim sipas nënparagrafit (d) me qëllim dërgimin e të miturit përpara autoritetit kompetent (*X. kundër Zvicrës*, vendim i Komisionit i 14 dhjetorit 1979).

E. Ndalimi për arsye mjekësore ose sociale

Neni 5 paragrafi 1 (e) i Konventës

"1. ... Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet e mëposhtme dhe në përputhje me procedurat e parashikuara me ligj:

...

e) kur individët ndalohen ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve;

Fjalët kyçe të HUDOC

Liria e personit (5-1) – Siguria e personit (5-1) – Privimi i lirisë (5-1) – Procedura e parashikuar me ligj (5-1) – Arrestim ose burgim i ligjshëm (5-1)

Parandalimi i përhapjes së sëmundjeve infektive (5-1-e) - Personave të sëmurë mendërisht (5-1-e) - Alkoolistë (5-1-e) - Narkomanëve (5-1-e) - Endacakë (5-1-e);

1. Të përgjithshme

114. Neni 5 paragrafi 1 (e) i Konventës i referohet disa kategorive personash, përkatësisht atyre që përhapin sëmundje ngjitëse, të sëmurëve mendorë, alkoolistëve, narkomanëve dhe endacakëve.

Ekziston një lidhje mes të gjithë këtyre personave në faktin se atyre mund t'u privohet liria me qëllim ofrimin e trajtimit mjekësor ose për shkak të arsyeve të diktuar nga politika sociale, ose si për shkaqe mjekësore, ashtu edhe për shkaqe sociale (*Enhorn kundër Suedisë*, 2005, § 43).

115. Arsyeja pse Konventa lejon që këtyre personave, të cilët të gjithë kanë probleme me jetesën në shoqëri, t'u privohet liria nuk është vetëm fakti se ata mund të përbëjnë rrezik për sigurinë publike, por edhe që interesat e tyre mund ta bëjnë të nevojshëm ndalimin e tyre (*ibid.*; *Guzzardi kundër Italisë*, 1980, § 98 *in fine*).

2. Parandalimi i përhapjes së një sëmundjeje ngjitëse

116. Kriteret thelbësore në dritën e të cilave duhet të vlerësohet “ligjshmëria” e ndalimit të një personi “që mund të përhapë një sëmundje ngjitëse” janë:

- nëse përhapja e sëmundjes ngjitëse përbën rrezik për sigurinë dhe shëndetin publik; dhe
- nëse ndalimi i personit të infektuar përbën mjetin e fundit për të penguar përhapjen e sëmundjes, pasi masa të tjera, më pak të rrepta, janë marrë tashmë parasysh e janë gjykuar si të pamjaftueshme për mbrojtjen e interesit publik.

Nëse këto kritere nuk përmbushen më, baza për privimin e lirisë pushon së ekzistuari (*Enhorn kundër Suedisë*, 2005, § 44).

3. Ndalimi i personave të sëmurë mendërisht

117. Termit “të sëmurë mendërisht” nuk mund t’i jepet një përkufizim i saktë, pasi psikiatria është një fushë në zhvillim, si nga pikëpamja mjekësore ashtu edhe nga sjelljet shoqërore. Megjithatë, ai nuk mund të interpretohet se lejon ndalimin e një personi, thjeshtë sepse pikëmapmjet ose sjellja e tij, devijon nga norma të pranuar (*Rakevich kundër Rusisë*, 2004, § 26).

Termit duhet t’i jepet një kuptim autonom, pa qenë e detyruar Gjykata nga interpretimi i termave të njëjtë ose të ngjashëm në rendin juridik vendas (*Petschulies kundër Gjermanisë*, 2016, §§ 74-77). Nuk është nevojshme që personi përkatës të ketë vuajtur nga një gjendje e tillë aq sa të përjashtonte ose ulte përgjegjësinë e tij penale kur kryen një vepër penale sipas së drejtës penale vendase (*Ilseher kundër Gjermanisë* [DHM], 2018, § 149).

118. Një person mund të privohet nga liria për shkak se është “i sëmurë mendërisht” vetëm nëse plotësohen të paktën tre kushtet minimale vijuese (*Ilseher kundër Gjermanisë* [DHM], 2018, § 127; *Stanev kundër Bullgarisë* [DHM], 2012, § 145; *D.D. kundër Lituanisë*, 2012, § 156; *Kallweit kundër Gjermanisë*, 2011, § 45; *Shtukaturov kundër Rusisë*, 2008, § 114; *Varbanov kundër Bullgarisë*, 2000, § 45; dhe *Winterwerp kundër Holandës*, 1979, § 39):

- duhet të provohet bindshëm me ekspertizë mjekësore objektive se personi është i sëmurë mendërisht, përveçse kur kërkohet ndalim emergjent;
- çrregullimi mendor i personit duhet të jetë i tillë që të justifikojë shtrimin e detyrueshëm. Duhet të provohet, pasur parasysh rrethanat e çështjes, se privimi i lirisë ka qenë i domosdoshëm;
- çrregullimi mendor, i verifikuar me ekspertizë mjekësore objektive duhet të vazhdojë gjatë gjithë periudhës së izolimit.

119. Neni 5 § 1 (e) i Konventës nuk specifikon veprimet e mundshme, të dënueshme sipas së drejtës penale, për të cilat një person mund të mbahet i shtruar për shkak se është “i sëmurë mendërisht”. Kjo dispozitë nuk identifikon as kryerjen e një vepre penale të mëparshme si parakusht për shtrimin e detyrueshëm (*Denis dhe Irvine kundër Belgjikës* [DHM], 2021, § 168).

120. Asnjë rast i privimit të lirisë së një personi që konsiderohet me çrregullim mendor nuk mund të vlerësohet si në përputhje me nenin 5 paragrafi 1 pika (e) të Konventës nëse është vendosur pa marrë

mendimin e një mjeku ekspert (*Ruiz Rivera kundër Zvicrës*, 2014, § 59; *S.R. kundër Holandës* (vend. pran.), 2012, § 31).

Kur nuk ekziston ndonjë mundësi tjetër, për shembull për shkak të refuzimit të personit përkatës për t'u paraqitur për ekzaminim, duhet të paktën të kërkohej një vlerësim i një mjeku ekspert mbi bazën e fallikullit së çështjes për gjendjen aktuale të shëndetit mendor të personit, në mungesë të kësaj nuk mund të pretendohet në mënyrë bindëse se personi është me çrregullim mendor (*D.C. kundër Belgjikës*, 2021, §§ 87, 98-101; *Constancia kundër Holandës* (vend. pran.), 2015, § 26, ku Gjykata lejoi që informacioni tjetër ekzistues të zëvendësohej me ekzaminimin mjekësor të gjendjes mendore të kërkuarit).

121. Për sa i përket kushtit të dytë si më sipër, shtrimi i detyruar i një personi të prekur nga një çrregullim mendor mund të jetë i nevojshëm, jo vetëm kur ky i fundit ka nevojë për terapi, trajtim mjekësor ose trajtim tjetër klinik për t'u kuruar ose për të lehtësuar gjendjen e tij, por edhe kur del se është e nevojshme që ai të kontrollohet dhe të mbikëqyret për të mos u lejuar, për shembull, që të dëmtojë veten ose të tjerët (*Ilseher kundër Gjermanisë* [DHM], 2018, § 133; *Hutchison Reid kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2003, § 52).

Neni 5 § 1, nënparagrafi (e) lejon shtrimin e detyruar të një personi me çrregullim mendor edhe nëse nuk parashikohet trajtim mjekësor, por kjo masë duhet të përligjet si duhet me rëndesën e gjendjes shëndetësore të personit dhe nevojën për të mbrojtur personin në fjalë ose të tjerët (*N. kundër Rumanisë*, 2017, § 151).

122. Një gjendje mendore duhet të paraqesë një shkallë të caktuar rëndese që të mund të konsiderohet çrregullim mendor "i vërtetë" (*Glien kundër Gjermanisë*, 2013, § 85). Për t'u kualifikuar si një çrregullim i vërtetë mendor për qëllimet e nënparagrafit (e), të paragrafit 1 të nenit 5, çrregullimi mendor në fjalë duhet të jetë aq i rëndë sa të kërkojë trajtim në një institucion të përshtatshëm për pacientët me probleme të shëndetit mendor. (*Ilseher kundër Gjermanisë* [DHM], 2018, § 129; *Petschulies kundër Gjermanisë*, 2016, § 76).

123. Për të vendosur nëse një person duhet shtruar apo jo, me detyrim, si "i sëmurë mendërisht", autoriteteve kombëtare u njihet një hapësirë e caktuar vlerësimi, sepse u takon atyre në radhë të parë që të vlerësojnë provat e paraqitura para tyre në një rast konkret (*Ilseher kundër Gjermanisë* [DHM], 2018, § 128; *Plesó kundër Hungarisë*, 2012, § 61; *H.L. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2004, § 98).

Autoriteti kompetent vendas duhet të shqyrtojë me rreptësi këshillën e ekspertit dhënë para tij dhe të marrë vendimin e vet nëse personi përkatës vuan nga një çrregullim mendor (*Ilseher kundër Gjermanisë* [DHM], 2018, § 132).

124. Koha relevante në të cilën sëmundja mendore e personit përkatës duhet të jetë përcaktuar në mënyrë bindëse për kërkesat e nënparagrafit (e) të paragrafit 1 të nenit 5 është data e dhënies së masës që e privon atë person nga liria për arsye të sëmundjes së tij mendore (*M.B. kundër Spanjës*, 2025, §§ 73 dhe 78; *Ilseher kundër Gjermanisë* [DHM], 2018, § 134; *O.H. kundër Gjermanisë*, 2011, § 78). Megjithatë, ndryshimet, nëse ka, në gjendjen mendore të personit të shtruar pas miratimit të vendimit fillestar të shtrimit të detyruar, duhet të merren parasysh (*Ilseher kundër Gjermanisë* [DHM], 2018, § 134). Raportet e mjekëve specialistë mbi të cilat mbështeten autoritetet duhet të jenë të përditësuara (*Kadusic kundër Zvicrës*, 2018, §§ 44 dhe 55).

125. Konventa nuk iu kërkon autoriteteve, kur vlerësojnë vazhdimësinë e çrregullimeve mendore, të marrin parasysh natyrën e veprimeve të kryera nga personi në fjalë, të cilat kanë çuar në shtrimin e tij ose të saj të detyrueshëm. (*Denis dhe Irvine kundër Belgjikës* [DHM], 2021, § 169).

126. Në rastin kur autoritetet kanë të dhëna mjekësore të cilat tregojnë se personi përkatës është kuruar, ato mund të kenë nevojë për pak kohë për të shqyrtuar nëse është e përshtatshme që t'i jepet fund shtrimit të tij (*Luberti kundër Italisë*, 1984, § 28). Sidoqoftë, vijimi i masës së privimit të lirisë për arsye thjesht administrative nuk përligjet (*R.L. dhe M.-J.D. kundër Francës*, 2004, § 129).

127. Izolimi i personave me e çrregullime mendore duhet të kryhet në një spital, klinikë ose institucion tjetër të përshtatshëm, të autorizuar për mbajtjen e këtyre personave (*L.B. kundër Belgjikës*, 2012, § 93; *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, § 44; *O.H. kundër Gjermanisë*, 2011, § 79).

Mungesa e hapësirave të disponueshme në një institucion të përshtatshëm nuk mund të justifikojë vazhdimin e mbajtjes në një burg të zakonshëm të një personi që vuan nga çrregullime psikiatrike. (*Sy kundër Italisë* (vend pranueshmërie), 2022, § 135).

128. Megjithatë, një person mund të vendoset përkohësisht në një institucion jo të miratuar posaçërisht për shtrimin e të sëmurëve mendorë përpara se të transferohet në një institucion të përshtatshëm, me kusht që periudha e pritjes të mos jetë tepër e gjatë (*Pankiewicz kundër Polonisë*, 2008, §§ 44-45; *Morsink kundër Holandës*, 2004, §§ 67-69; *Brand kundër Holandës*, 2004, §§ 64-66).

129. Duke pasur parasysh lidhjen e brendshme ndërmjet ligjshmërisë së privimit të lirisë dhe kushteve të zbatimit të saj, shtrimi i detyruar i një personi me çrregullim mendor në bazë të vendimit fillestar të ndalimit mund të bëhet i ligjshëm, mbasi ai person transferohet nga një institucion i papërshtatshëm për pacientët me çrregullime mendore në një institucion të përshtatshëm (*Ilneher kundër Gjermanisë [DHM]*, 2018, §§ 140-141).

130. Ofrimi i terapisë së përshtatshme është bërë kërkesë e konceptit më të gjerë të "ligjshmërisë" së privimit të lirisë. Çdo ndalim i personave me çrregullime mendore duhet të ketë një qëllim terapeutik, që synon shërimin ose lehtësimin e gjendjes së tyre të shëndetit mendor, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, uljen ose kontrollin e rrezikshmërisë së tyre (*Rooman kundër Belgjikës [DHM]*, 2019, § 208).

131. Privimi i lirisë sipas nenit 5 § 1(e) ka kështu një funksion të dyfishtë: nga njëra anë, funksionin shoqëror të mbrojtjes, dhe nga ana tjetër funksionin terapeutik që lidhet me interesin individual të personit me çrregullim mendor për të marrë një formë të përshtatshme dhe të individualizuar të terapisë ose një seri trajtimi. Trajtimi i përshtatshëm dhe i individualizuar është një pjesë thelbësore e nocionit të "institucionit të përshtatshëm" (*Rooman kundër Belgjikës [DHM]*, 2019, § 210).

132. Neni 5 § 1 (e) i Konventës gjithashtu ofron garanci procedurale në lidhje me vendimet gjyqësore që autorizojnë shtrimin e detyruar të një personi (*M.S. kundër Kroacisë (nr. 2)*, 2015, § 114). Nocioni i "ligjshmërisë" kërkon një procedurë të drejtë dhe të përshtatshme që i ofron personit në fjalë mbrojtje të mjaftueshme kundër heqjes arbitrare të lirisë (*V.K. kundër Rusisë*, 2017, § 33; *X. kundër Finlandës*, 2012, § 148, në lidhje me mungesën e garancive të duhura për vazhdimin e mbajtjes në izolim të detyruar të kërkuesit).

133. Procedurat që çojnë në shtrimin e detyrueshëm të një personi në një institucion psikiatrik duhet të ofrojnë garanci efektive kundër arbitraritetit, duke pasur parasysh cenueshmërinë e personave që vuajnë nga çrregullime mendore dhe nevojën për të paraqitur arsye shumë të forta për të përligjur çdo kufizim të të drejtave të tyre. (*M.S. kundër Kroacisë (nr. 2)*, 2015, § 147).

134. Është thelbësore që personi përkatës të ketë akses në gjykatë dhe mundësinë për t'u dëgjuar qoftë personalisht, qoftë, kur është e nevojshme, nëpërmjet ndonjë forme përfaqësimi. Kjo nënkupton që një individ i mbyllur në një institucion psikiatrik duhet, përveç rasteve të posaçme, të marrë ndihmë ligjore në proceset që lidhen me vazhdimin, pezullimin ose përfundimin e izolimit të tij (*ibid.*, §§ 152 dhe 153; *N. kundër Rumanisë*, 2017, § 196).

135. Vetëm caktimi i një avokati, pa ofrimin e ndihmës ligjore nga ky avokat në procedurat gjyqësore, nuk mund të përmbushë kërkesat e "ndihmës ligjore" të nevojshme për personat e izoluar si "të sëmurë mendorisht". Një përfaqësim efektiv ligjor i personave me aftësi të kufizuara kërkon një detyrë mbikëqyrjeje të shtuar të përfaqësuesve të tyre ligjorë nga gjykatat kompetente vendase (*M.S. kundër Kroacisë (nr. 2)*, 2015, § 154; shih edhe *V.K. kundër Rusisë*, 2017, në lidhje me mungesën e ofrimit të ndihmës ligjore efektive nga një avokat i caktuar nga gjykata dhe dështimin e dukshëm të gjykatave vendase për ta marrë parasysh këtë të metë dhe *Martinez Fernandez kundër Hungarisë*, 2025, në

lidhje me dështimin e kujdestarit *ad litem* për të përfaqësuar në mënyrë efektive kërkuesin, duke pasqyruar kështu një problem sistematik).

136. Vendimi për t'i dhënë një pacienti ilaçe qetësuese, para një seance gjyqësore kërkon shqyrtim të kujdesshëm, si nga profesionistët e shëndetit mendor, ashtu edhe nga gjykatat, veçanërisht në lidhje me mënyrën se si ilaçet mund të ndikojnë në aftësinë e pacientit për të marrë pjesë në mënyrë domethënëse në proces (*Martinez Fernandez kundër Hungarisë*, 2025, §§ 71-73).

4. Ndalimi i një të alkoolizuari dhe i një narkomani

137. Neni 5 § 1 (e) i Konventës nuk mund të interpretohet sikur lejon vetëm ndalimin e një “alkoolisti” në kuptimin e ngushtë të një personi që ndodhet në gjendje klinike “alkoolizmi”, sepse asgjë në tekstin e kësaj dispozite nuk e ndalon zbatimin nga Shteti të kësaj mase ndaj një individi që abuzon me alkoolin me qëllim që të kufizohen efektet negative të përdorimit të tij për veten dhe për shoqërinë, ose për të penguar një sjellje të rrezikshme pas konsumit të alkoolit (*Kharin kundër Ruisisë*, 2011, § 34).

138. Për rrjedhojë, personat të cilët nuk janë diagnostikuar në mënyrë mjekësore si “të alkoolizuar”, por që sjellja dhe veprimet e tyre nën ndikimin e alkoolit paraqesin rrezik për rendin publik ose për veten, mund të vendosen në izolim për mbrojtjen e publikut ose të interesave të tyre, siç është shëndeti ose siguria e tyre personale (*Hilda Hafsteinsdóttir kundër Islandës*, 2004, § 42). Megjithatë, kjo nuk do të thotë se neni 5 § 1 e) i Konventës e lejon izolimin e një personi thjesht sepse ai konsumon alkool (*Petschulies kundër Gjermanisë*, 2016, § 65; *Witold Litwa kundër Polonisë*, 2000, §§ 61-62).

5. Endacakët

139. Jurisprudenca lidhur me “endacakët” është pakët. Objekti i kësaj dispozite përfshin personat që nuk kanë as vendbanim të caktuar, as mjete jetese, dhe që nuk ushtrojnë zakonisht as zanat, as profesion. Këto tre kushte, të frymëzuara nga Kodi Penal belg, janë kumulative: ato duhet të përmbushen njëkohësisht për të njëjtin person (*De Wilde, Ooms dhe Versyp kundër Belgjikës*, 1971, § 68).

F. Ndalimi i të huajve

Neni 5 paragrafi 1 (f) i Konventës

“1. ... Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet e mëposhtme dhe në përputhje me procedurat e parashikuara me ligj:

...

f) kur një person arrestohet ose ndalohet ligjërisht, me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose për një person kundër të cilit është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi;

Fjalët kyçe të HUDOC

Privimi i lirisë (5-1) – Procedura e parashikuar me ligj (5-1) – Arrestim ose burgim i ligjshëm (5-1)

Ndalim i hyrjes së paautorizuar në vend (5-1-f) - Dëbim (5-1-f) -Ekstradim (5-1-f)

1. Ndalimi për parandalimin e hyrjes së paautorizuar në territor

140. Neni 5 § 1 (f) u lejon Shtetet që të kontrollojnë lirinë e të huajve në kuadër të imigracionit (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 2016, § 89). Ndonëse pjesa e parë e kësaj dispozite lejon ndalimin e një azilkërkuesi apo të një imigranti tjetër përpara se Shteti të japë leje për të hyrë, ky ndalim duhet

të jetë në pajtim me qëllimin e përgjithshëm të nenit 5, i cili është të garantojë të drejtën e lirisë dhe të sigurojë që askush të mos privohet nga liria në mënyrë arbitrare (*Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2008, §§ 64-66).

141. Çështja se në cilin moment pushon së zbatuari pjesa e parë e nenit 5 § 1 (f), për shkak se personit të interesuar i është dhënë një leje formale hyrjeje ose qëndrimi, varet gjerësisht nga e drejta e brendshme (*Suso Musa kundër Maltës* 2013, § 97).

142. Parimi sipas së cilit ndalimi nuk duhet të jetë arbitrar duhet të zbatohet njëjloj si për ndalimin që i përket pjesës së parë të nenit 5 § 1 (f), ashtu edhe për ndalimin e parashikuar nga pjesa e dytë e tij (*Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2008, § 73).

143. “Liria nga arbitrariteti” në kontekstin e pjesës së parë të nenit 5 § 1 (f) domethënë se ndalimi duhet të kryhet në mirëbesim; ai duhet të jetë i lidhur ngushtë me qëllimin e parandalimit të hyrjes së paautorizuar të një personi në territor; vendi dhe kushtet e ndalimit duhet të jenë të përshtatshme, duke pasur parasysh se një masë e tillë nuk zbatohet ndaj personave që kanë kryer veprat penale, por ndaj të huajve që, shpeshherë duke pasur frikë për jetën, janë larguar nga vendi i tyre; kohëzgjatja e ndalimit nuk duhet të kalojë afatin e arsyeshëm të nevojshëm për të arritur qëllimin e ndjekur (*ibid.*, § 74).

144. Ndërsa kalimi i kohës nuk është vendimtar për të vlerësuar nëse ndalimi bie brenda fushëveprimit të pjesës së parë të nenit 5 § 1 (f), ai mbetet i rëndësishëm për të përcaktuar nëse ekziston një lidhje mjaftueshëm e ngushtë mes ndalimit për qëllim imigracioni dhe parandalimit të hyrjes së paautorizuar. Një shqyrtim i rreptë është i nevojshëm kur ka kaluar një periudhë më e gjatë kohe dhe personi ndodhet fizikisht në territorin e një shteti (*M.B. kundër Holandës*, 2024, §§ 74-75, ku ndalimi i kërkuesit nga imigracioni për arsye të rendit publik pas ndalimit të tij për akuza që lidhen me terrorizmin u vlerësua arbitrar; shih gjithashtu *B.A. kundër Qipros*, 2024, §§ 62-64, ku ndalimi i një azilkërkuesi për arsye të sigurisë kombëtare u konsiderua pa lidhjen e ngushtë me qëllimin e parandalimit të hyrjes së paautorizuar).

145. Gjykata ka shprehur rezerva lidhur me praktikën e autoriteteve për të vendosur automatikisht azilkërkuesit në qendër të mbyllur pa një vlerësim individual të nevojave të tyre të veçanta. (*Thimothawes kundër Belgjikës*, 2017, § 73; *Mahamed Jama kundër Maltës*, 2015, § 146).

146. Gjykata duhet ta marrë parasysh situatën e veçantë të imigrantëve të ardhshëm kur asaj i kërkohet të shqyrtojë mënyrën e zbatimit të masës së ndalimit (*Kanagaratnam kundër Belgjikës*, 2011, § 80, ku kërkuesja dhe tre fëmijët e saj u mbajtën në ambient të mbyllur të krijuar për të rriturit; *Rahimi kundër Greqisë*, 2011, § 108, në lidhje me zbatimin automatik të ndalimit ndaj një të mituri të pashoqëruar).

147. Në rastin e mbërritjeve masive të azilkërkuesve në kufijtë e Shtetit, duke pasur parasysh ndalimin e arbitraritetit, kërkesa e ligjshmërisë e nenit 5 mund të konsiderohet përgjithësisht e përmbushur nga një regjim ligjor vendas që parashikon, për shembull, jo më shumë se emrin e autoritetit kompetent për urdhërimin e privimit të lirisë në një zonë tranziti, formën e urdhrit, shkaqet e mundshme dhe kufizimet e tij, kohëzgjatjen maksimale të ndalimit dhe, siç kërkohet nga neni 5 § 4, rrugën e zbatueshme për ankimin gjyqësor (*Z.A. dhe të tjerë kundër Ruisë* [DHM], 2019, § 162).

148. Neni 5 § 1 (f) nuk i pengon Shtetet të miratojnë dispozita të së drejtës vendase që përcaktojnë shkaqe për të cilat mund të urdhërohet një kufizim i tillë, duke marrë parasysh realitetet praktike të flukseve masive hyrëse të azilkërkuesve. Në veçanti, nënparagrafi (f) nuk ndalon privimin e lirisë në një zonë tranziti për një periudhë të kufizuar kohore mbështetur në shkakun se një kufizim i tillë është përgjithësisht i nevojshëm për të siguruar praninë e azilkërkuesve në pritje të shqyrtimit të kërkesave të tyre për azil ose, për më tepër, bazuar në shkakun se ekziston nevoja për të shqyrtuar shpejt pranueshmërinë e kërkesave për azil dhe se, për këtë qëllim, në zonën e tranzitit janë krijuar struktura dhe procedura të posaçme (*ibid.*, § 163).

2. Ndalimi i një personi për qëllim dëbimi ose ekstradimi

149. Neni 5 § 1 (f) nuk kërkon që ndalimi të konsiderohet i domosdoshëm, për shembull, për të parandaluar kryerjen e një vepre penale ose arratisjen e një personi. Në këtë drejtim, neni 5 § 1 (f) ofron një nivel të ndryshëm mbrojtjeje nga neni 5 § 1 (c); ajo çka kërkohet nga nënparagrafi (f) është vetëm që “të jetë duke u kryer një procedurë me qëllim dëbimi ose ekstradimi”. Për qëllimet e zbatimit të tij, nuk ka rëndësi nëse vendimi fillestar për dëbim përlligjet sipas legjislacionit kombëtar apo Konventës (*Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1996, § 112; *Čonka kundër Belgjikës*, 2002, § 38; *Nasrullojev kundër Rusisë*, 2007, § 69; *Soldatenko kundër Ukrainës*, 2008, § 109).

Testi i domosdoshmërisë së ndalimit akoma mund të kërkohet sipas legjislacionit vendas (*Muzamba Oyaw kundër Belgjikës* (vend. pran.), 2017, § 36; *J.R. dhe të tjerë kundër Greqisë*, 2018, § 111).

150. Megjithatë, Gjykata mban parasysh situatën e veçantë të personave të ndaluar dhe çdo vulnerabilitet të veçantë (siç është shëndeti ose moshë) që mund ta bëjë të papërshtatshëm ndalimin e tyre (*Thimothawes kundër Belgjikës*, 2017, §§ 73, 79-80)

Kur përfshihet një fëmijë, Gjykata ka vlerësuar se, në mënyrë përjashtimore, privimi i lirisë duhet të jetë i domosdoshëm për të përmbushur qëllimin e ndjekur, konkretisht për të siguruar largimin e familjes (*A.B. dhe të tjerë kundër Francës*, 2016, § 120). Prania e një fëmije që shoqëron prindërit e tij ose të saj në një qendër të mbyllur do të jetë në përputhje me nenin 5 § 1 (f) vetëm kur autoritetet kombëtare të mund të vërtetojnë se kjo masë e fundit është marrë pas një verifikimi real se nuk ishte e mundur të merrej ndonjë masë tjetër që përfshin një kufizim më të vogël të lirisë së tyre (*ibid.*, § 123).

151. Ndalimi mund të përlligjet sipas pjesës së e dytë të nenit 5 § 1 (f) kur autoritetet kompetente kryejnë hetime, edhe po të mos ketë formalisht ndonjë kërkesë a vendim formal për ekstradim, meqenëse këto hetime konsiderohen si “procedurë” në kuptimin e kësaj dispozite (*X. kundër Zvicrës*, vendim i Komisionit i 9 dhjetorit 1980).

152. Çdo privim i lirisë sipas pjesës së dytë të nenit 5 § 1 (f) mund të përlligjet vetëm për aq kohë sa procedurat e dëbimit ose ekstradimit janë në vijim. Nëse këto procedura nuk ndiqen me kujdesin e duhur, ndalimi pushon së qeni i lejueshëm sipas nenit 5 § 1 (f) (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 2016, § 90; *A. dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2009, § 164; *Amie dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, 2013, § 72; *Shiksaitov kundër Sllovakisë*, 2020, § 56, me shembuj të çështjeve që tregojnë shkelje të kësaj dispozite; *Sy kundër Italisë* (vend. pran.), 2022, § 79, në lidhje me ndalimin për ekzekutimin e një Urdhri Arresti Europian).

153. Për të shmangur cilësimin si arbitrar, ndalimi sipas nenit 5 § 1 (f) duhet të kryhet në mirëbesim; ai duhet të jetë gjithashtu i lidhur ngushtë me shkakun e ndalimit ku mbështetet Qeveria; përveç kësaj, vendi dhe kushtet e ndalimit duhet të jenë të përshtatshme; kohëzgjatja e kësaj mase të mos kalojë afatin e arsyeshëm të nevojshëm për arritjen e qëllimit të ndjekur (*A. dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2009, § 164; *Yoh-Ekale Mwanje kundër Belgjikës*, 2011, §§ 117-19 me referenca të mëtejshme; *Lazër kundër Rumanisë*, 2024, §§ 108-111).

154. Ndalimi për qëllim dëbimi nuk duhet të ketë natyrë ndëshkuese dhe duhet të shoqërohet me garanci të përshtatshme (*Azimov kundër Rusisë*, 2013, § 172).

155. Autoritetet vendase kanë detyrimin të vlerësojnë nëse largimi përbën një perspektivë realiste dhe nëse ndalimi me qëllim largimin është i justifikuar që në fillim, apo vazhdon të mbetet i tillë (*Al Husin kundër Bosnjës dhe Hercegovinës (nr. 2)*, 2019, § 98). Duhet të ekzistojnë garanci procedurale të afta për të parandaluar rrezikun e ndalimit arbitrar në pritje të dëbimit (*Kim kundër Rusisë*, 2014, § 53).

156. Në vlerësimin nëse e drejta vendase ofron garanci të mjaftueshme procedurale kundër arbitraritetit, Gjykata mund të marrë parasysh ekzistencën ose mungesën e afateve kohore për ndalimin, si dhe disponueshmërinë e një mjeti juridik ankimi. Megjithatë, Neni 5 § 1(f) nuk u kërkon

Shteteve të përcaktojnë një periudhë maksimale ndalimi në pritje të dëbimit as kontroll automatik gjyqësor të ndalimit për qëllime imigracioni. Praktika gjyqësore tregon se respektimi i afateve kohore sipas së drejtës vendase ose ekzistenca e kontrollit automatik gjyqësor nuk garantojnë në vetvete se sistemi i ndalimit për qëllime imigracioni është në përputhje me kërkesat e nenit 5 § 1(f) të Konventës (*J.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2016, §§ 83-96).

Megjithatë, aty ku ka afate të caktuara, mosrespektimi i tyre mund të jetë i rëndësishëm për çështjen e "ligjshmërisë", pasi ndalimi që tejkalon periudhën kohore të lejuar nga e drejta vendase ka pak gjasa të konsiderohet "në përputhje me ligjin". (*Komissarov kundër Republikës Çeke*, 2022, §§ 50-52).

157. Ekzistenca ose mungesa e afateve kohore nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte, por duhet të shihet në kontekstin e sistemit të ndalimit në tërësi, duke pasur parasysh faktet e veçanta të secilit rast individual. Edhe kur një kërkuar është mbajtur i ndaluar për një periudhë të pacaktuar, domosdoshmëria e garancive procedurale është vendimtare për analizën e Gjykatës. (*Lazër kundër Rumanisë*, 2024, § 97; shih edhe *Matthews dhe Johnson kundër Rumanisë*, 2024, §§ 124-127, në lidhje me ndalimin sipas konceptit të *force majeure*).

158. As nënparagrafi (f) i nenit 5 § 1, as nënparagrafët e tjerë të këtij neni nuk lejojnë vendosjen e një ekuilibri ndërmjet të drejtës për liri personale dhe interesit të Shtetit për të mbrojtur popullsinë e tij nga kërcënimi terrorist (*A. dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], § 171).

159. Konventa nuk përmban asnjë dispozitë lidhur me rrethanat se kur mund të lejohet ekstradimi, as me procedurën që duhet të ndiqet përpara se ekstradimi të pranohet. Kur ekstradimi varet nga rezultati i bashkëpunimit ndërmjet Shteteve të interesuara, dhe me kusht që baza ligjore e vendimit të arrestimit, është një urdhër arresti i lëshuar nga autoritet e Shtetit të origjinës së personit të arratisur, edhe një ekstradim atipik, nuk mund të konsiderohet, në vetvete, në kundërshtim me Konventën (*Öcalan kundër Turqisë* [DHM], 2005, § 86; *Adamov kundër Zvicrës*, 2011, § 57).

160. Kur një kërkesë për ekstradim ka të bëjë me një person që përballet me akuza penale në Shtetin kërkuar, Shteti i kërkuar duhet të veprojë me kujdes më të shtuar krahasuar me rastet kur ekstradimi kërkohet për qëllime të ekzekutimit të një dënimi, me qëllim që të sigurohet mbrojtja e të drejtave të personit përkatës. (*Gallardo Sanchez kundër Italisë*, 2015, § 42).

161. Për sa u përket marrëdhënieve në fushën e ekstradimit ndërmjet një Shteti palë dhe një shteti jo-palë të Konventës, normat e parashikuara me një traktat ekstradimi ose, në mungesë të një traktati të tillë, bashkëpunimi midis shteteve përkatëse gjithashtu janë elemente të rëndësishme që Gjykata merr parasysh për të përcaktuar ligjshmërinë e arrestimit për të cilin është paraqitur më pas kërkesë përpara saj. Fakti që një i arratisur është dorëzuar si rezultat i bashkëpunimi ndërmjet Shteteve, në vetvete, nuk e bën arrestimin të paligjshëm dhe prandaj nuk ngre ndonjë problem sipas nenit 5 (*Öcalan kundër Turqisë* [DHM], 2005, § 87).

162. Zbatimi i një mase të përkohshme pasi është urdhëruar nga Gjykata për një Shtet Palë sipas së cilës do të ishte e dëshirueshme që një person të mos kthehet mbrapsht në një vend të caktuar, nuk ndikon, në vetvete, në vlerësimin nëse privimi i lirisë që ai person mund t'i nënshtrohet, është në përputhje me nenin 5 § 1 të Konventës (*Gebremedhin [Gaberamadhien] kundër Francës*, 2007, § 74). Megjithatë ndalimi duhet të jetë i ligjshëm dhe jo arbitrar (*Azimov kundër Rusisë*, 2013, § 169).

Fakti që zbatimi i kësaj mase pengon dëbimin e një personi nuk e bën ndalimin e tij të paligjshëm, për sa kohë që procedurat e dëbimit janë ende në vijim e sipër dhe kohëzgjatja e ndalimit vazhdues të tij nuk është e paarsyeshme (*S.P. kundër Belgjikës* (vend. pran.), 2011; *Yoh-Ekale Mwanje kundër Belgjikës*, 2011, § 120; *Matthews dhe Johnson kundër Rumanisë*, 2024, § 128).¹

¹ Për detaje të mëtejshme në lidhje me kontekstin e imigracionit, shih *Udhëzues për praktikën gjyqësore të Konventës – Imigracioni*.

IV. Garancitë për personat e privuar nga liria

A. Njoftimi i arsyeve të arrestimit (neni 5 § 2)

Neni 5 paragrafi 2 i Konventës

"2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.

Fjalët kyçe të HUDOC

Informacion brenda një afati sa më të shkurtër (5-2) - Informacion në një gjuhë që ai e kupton (5-2) - Informacion për akuzën.

1. Zbatueshmëria

163. Fjalët e përdorura në nenin 5 § 2 duhet të interpretohen në mënyrë autonome dhe sidomos në përputhje me objektin dhe me qëllimin e nenit 5 që është mbrojtja e çdo personi nga privimi arbitrar i lirisë. Fjala “arrestim” shtrihet përtej fushës së masave të së drejtës penale dhe shprehja “çdo akuzë” (“any charge”) nuk përbën kusht për zbatueshmërinë e dispozitës, por një eventualitet që merret parasysh. Neni 5 § 4 nuk bën asnjë dallim mes personave të cilëve u është privuar liria në varësi të faktit nëse janë arrestuar apo paraburgosur. Për rrjedhojë, nuk ka shkaqe për përjashtimin e këtyre të fundit nga fusha e zbatimit të nenit 5 § 2 (*Van der Leer kundër Holandës*, 1990, §§ 27-28) e cila shtrihet te ndalimi për qëllime ekstradimi (*Shamayev dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë dhe Rusisë*, 2005, §§ 414-15) te trajtimi mjekësor (*Van der Leer kundër Holandës*, 1990, §§ 27-28; *X kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1981, § 66) si dhe zbatohet gjithashtu kur personat rikthehen në vendet e burgimit pas një periudhe lirimi me kusht (*X. kundër Belgjikës*, vendim i Komisionit i 2 prillit 1973).

2. Qëllimi

164. Neni 5 § 2 përmban garancinë themelore sipas së cilës çdo person i arrestuar duhet të dijë arsyen pse është privuar nga liria, si garanci që është pjesë e pandarë e skemës së mbrojtjes që ofron neni 5 (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 2016, § 115). Pasi të jetë informuar për arsyet e arrestimit ose të paraburgimit të tij, personi duhet të ketë mundësi, nëse e çmon të dobishme, të kundërshtojë ligjshmërinë e paraburgimit të tij përpara një gjykate në përputhje me nenin 5 § 4 (*Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1990, § 40; *Čonka kundër Belgjikës*, 2002, § 50).

165. Çdo person, i cili ka të drejtën për të ngritur një procedurë për të vendosur mbi ligjshmërinë e paraburgimit të tij pa vonesë, nuk mund të përfitojë nga përdorimi i kësaj të drejte nëse atij nuk i bëhen të njohura, sa më shpejt e në mënyrë të përshtatshme, arsyet për të cilat ai është privuar nga liria (*Van der Leer kundër Holandës*, 1990, § 28; *Shamayev dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë dhe Rusisë*, 2005, § 413; *Grubnyk kundër Ukrainës*, 2020, §§ 97 dhe 99).

3. Cilëve persona duhet t’u jepen arsyet

166. Nga formulimi gjuhësor i nenit 5 § 2 del qartë se Shtetet janë të detyruara që t’i japin personit të interesuar ose përfaqësuesit të tij informacion specifik (*Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2006, § 53, konfirmuar nga Dhoma e Madhe në vitin 2008). Nëse kërkuesi nuk është në gjendje të marrë informacionin, detajet përkatëse duhet t’i jepen personave që përfaqësojnë interesat e tij, për shembull avokatit ose kujdestarit të tij (*X. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, raport i Komisionit i 16 korrikut 1980, § 106; *Z.H. kundër Hungarisë*, 2012, §§ 42-43).

4. Arsyet duhet të jepen “ sa më shpejt”

167. Për të përcaktuar nëse shpejtësia e njoftimit të informacionit ka qenë e mjaftueshme, duhen mbajtur parasysh rrethanat e veçanta të çështjes. Megjithatë, në momentin e arrestimit oficeri arrestues nuk e ka të nevojshme që të tregojë të gjitha arsyet (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 2016, § 115; *Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1990, § 40; *Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 1994, § 72).

168. Kërkesa për shpejtësi e diktuar nga kufizimet kohore do konsiderohet e përmbushuar kur personi i arrestuar informohet për arsyet e arrestimit të tij brenda disa orësh (*Kerr kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend. pran.), 1999; *Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1990, § 42).

5. Mënyra e dhënies së arsyeve

169. Arsyet nuk është e nevojshme të përfshihen në tekstin e vendimit që lejon paraburgimin dhe as nuk është e thënë të jepen patjetër me shkrim, ose në ndonjë formë të veçantë (*X. kundër Gjermanisë*, vendim i Komisionit i 13 dhjetorit 1978; *Kane kundër Qipros* (vend. pran.), 2011).

Megjithatë, nëse gjendja e një personi me aftësi të kufizuara intelektuale nuk merret në konsideratë siç duhet në këtë procedurë, nuk mund të thuhet se atij i është dhënë informacioni i kërkuar, duke i mundësuar atij, në mënyrë efektive dhe me vetëdije të plotë, ushtrimin e së drejtës së garantuar nga neni 5 § 4 për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit, përveç rastit kur, në vend të tij, për këtë qëllim është informuar, mbrojtjesi ose ndonjë person tjetër i autorizuar (*Z.H. kundër Hungarisë*, 2012, § 41).

170. Arsyet e arrestimit mund të jepen ose të bëhen të qarta gjatë marrjes në pyetje pas arrestimit (*Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1990, § 41; *Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 1994, § 77; *Kerr kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend. pran.), 1999; *Grubnyk kundër Ukrainës*, 2020, §§ 95 dhe 98).

171. Personat e arrestuar nuk mund të pretendojnë se nuk i kanë kuptuar arsyet e arrestimit të tyre, në rrethana kur janë kapur menjëherë pas kryerjes së një veprë penale dhe me dashje (*Dikme kundër Turqisë*, 2000, § 54) ose kur ata kanë qenë në dijeni të detajeve të veprave të dyshuara, të përfshira në urdhra arresti ose kërkesa ekstradimi të mëparshme (*Öcalan kundër Turqisë* (vend. pran.), 2000).

6. Niveli i kërkuar i arsyeve

172. Për përcaktimin nëse përmbajtja e informacionit të dhënë është e mjaftueshme, duhen pasur parasysh rrethanat e veçanta të çështjes (*Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1990, § 40). Megjithatë, dhënia e bazës ligjore për arrestimin, në vetvete, nuk është e mjaftueshme për qëllimet e nenit 5 § 2 (*ibid.*, § 41; *Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 1994, § 76; *Kortesis kundër Greqisë*, 2012, §§ 61-62).

173. Çdo personi të arrestuar duhet t'i thuhet, në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për të, arsyet juridike dhe faktike të privimit të lirisë në mënyrë që ai të mund ta kundërshtojë ligjshmërinë e tij përpara një gjykate në përputhje me nenin 5 § 4 (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 2016, § 115; *J.R. dhe të tjerë kundër Greqisë*, 2018, §§ 123-124; *Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1990, § 40; *Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 1994, § 72). Megjithatë, neni 5 § 2 nuk kërkon që informacioni të përmbajë një listë të plotë të veprave penale që i atribuohen personit të arrestuar (*Bordovskiy kundër Rusisë*, 2005, § 56; *Nowak kundër Ukrainës*, 2011, § 63; *Gasiņš kundër Letonisë*, 2011, § 53).

174. Kur personat janë arrestuar për qëllime ekstradimi, informacioni i dhënë mund të jetë edhe më pak i plotë (*Suso Musa kundër Maltës*, 2013, §§ 113 dhe 116; *Kaboulov kundër Ukrainës*, 2009, § 144; *Bordovskiy kundër Rusisë*, 2005, § 56) sepse arrestimi për këto qëllime nuk kërkon një vendim për thelbin e ndonjë akuze (*Bejaoui kundër Greqisë*, vendim i Komisionit i 6 prillit 1995). Megjithatë, këta

persona gjithsesi duhet të marrin informacion të mjaftueshëm që u lejon të bëjnë kërkesë në gjykatë për kontrollin e ligjshmërisë të parashikuar në nenin 5 § 4 (*Shamayev dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë dhe Ruisë*, 2005, § 427).

7. Në një gjuhë që kupton

175. Kur një urdhër arresti, nëse ka ndonjë të tillë, është hartuar në një gjuhë që personi i arrestuar nuk e kupton, neni 5 § 2 do të vlerësohet i respektuar nëse kërkuesi merret në pyetje më pas, dhe informohet kështu për arsyet e arrestimit të tij, në një gjuhë që ai e kupton (*Delcourt kundër Belgjikës*, vendim i Komisionit i 7 shkurtit 1967 përmendur në raportin e Komisionit të 1 tetorit 1968).

176. Megjithatë, kur për këtë qëllim, përdoren përkthyes, autoritetet duhet të sigurohen që kërkesat për përkthim të jenë formuluar me kujdes dhe saktësi (*Shamayev dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë dhe Ruisë*, 2005, § 425).

B. E drejta për t'u çuar menjëherë përpara një gjyqtari (neni 5 § 3)

Neni 5 paragrafi 3 i Konventës

"3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatësi ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore..."

Fjalët kyçe të HUDOC

Gjyqtar ose zyrtari tjetër që ushtron funksione gjyqësore (5-3) – I çuar përpara një gjyqtari ose zyrtari tjetër (5-3)

1. Qëllimi i dispozitës

177. Neni 5 § 3 i Konventës u ofron personave të arrestuar ose të paraburgosur, të dyshuar për kryerjen e një veprë penale një garanci kundër privimit arbitrar ose të pajustificuar të lirisë (*Aquilina kundër Maltës* [DHM], 1999, § 47; *Stephens kundër Maltës (nr. 2)*, 2009, § 52).

178. Kontrolli gjyqësor i ndërhyrjeve të ekzekutivit në të drejtën e lirisë së personit përbën një karakteristikë thelbësore të garancisë së parashikuar nga neni 5 § 3 (*Brogan dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1988, § 58; *Pantea kundër Rumanisë*, 2003, § 236; *Assenov dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, 1998, § 146). Kontrolli gjyqësor rrjedh nga shteti i së drejtës, "një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike..., që përmendet shprehimisht në Preambulën e Konventës" dhe "nga i cili frymëzohet e tërë Konventa" (*Brogan dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1988, § 58).

179. Kontrolli gjyqësor shërben për të dhënë garanci efektive kundër rrezikut të keqtrajtimit, i cili është më i larti në këtë fazë fillestare të ndalimit, si edhe kundër çdo abuzimi i kompetencave të dhëna oficerëve të zbatimit të ligjit apo autoriteteve të tjera, të cilat duhet të ushtrohen për qëllime ngushtësisht të kufizuara dhe në përputhje të rreptë me procedurat e parashikuara (*Ladent kundër Polonisë*, 2008 § 72).

2. Kontroll gjyqësor i shpejtë dhe automatik

180. Pjesa hyrëse e nenit 5 § 3 synon të sigurojë një kontroll gjyqësor të shpejtë e automatik të një ndalimi/arrestimi policor ose administrativ të urdhëruar sipas dispozitave të paragrafit 1 (c) (*De Jong, Baljet dhe Van den Brink kundër Holandës*, 1984, § 51; *Aquilina kundër Maltës* [DHM], 1999, §§ 48-49).

181. Kontrolli gjyqësor gjatë paraqitjes së parë të personit të arrestuar duhet të jetë, para së gjithash, i shpejtë, sepse ai duhet mundësojë identifikimin e çdo lloji keqtrajtimi dhe të ulë në minimum çdo lloj ndërhyrje të pa përligjur në lirinë personale. Kufizimi i rreptë kohor që dikton kjo kërkesë lë shumë pak hapësirë për fleksibilitet në interpretim, përndryshe garancia procedurale e ofruar nga ky nen do të dobësohej në dëm të individit rëndë dhe do të krijohej rrezik për pasoja që bien ndesh me vetë thelbin e së drejtës së mbrojtur prej tij (*McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2006, § 33).

182. Neni 5 § 3 nuk parashikon asnjë përjashtim të mundshëm nga kërkesa për ta çuar një person menjëherë përpara një gjyqtari ose një nëpunësi tjetër gjyqësor pas arrestimit ose ndalimit të tij, as edhe për shkaqe të përfshirjes së mëparshme gjyqësore (*Bergmann kundër Estonisë*, 2008, § 45).

183. Çdo periudhë që tejkalon se katër ditë është *prima facie* tepër e gjatë (*Oral dhe Atabay kundër Turqisë*, 2009, § 43; *McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2006, § 47; *Nästase-Silivestru kundër Rumanisë*, 2007, § 32). Edhe periudha më të shkurtra mund të cenojnë kërkesën për shpejtësi nëse nuk ka vështirësi të posaçme ose rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë autoritetet të sjellin

një person të arrestuar më herët përpara një gjyqtari (*Gutsanovi kundër Bullgarisë*, 2013, §§ 154-59; *Ipek dhe të tjerë kundër Turqisë*, 2009, §§ 36-37; *Kandzhov kundër Bullgarisë*, 2008, § 66).

Kërkesa për shpejtësi është edhe më e rreptë kur vendosja në izolim policor pason një periudhë të mëparshme privimi faktit të lirisë (*Vassis dhe të tjerë kundër Francës*, 2013, § 60, në lidhje me ndalimin e një ekuipazhi në det të hapur).

184. Kur një person ndalohet sipas pjesës së dytë të nenit 5 § 1 (c) jashtë kontekstit të procedimeve penale, periudha e nevojshme ndërmjet arrestimit të një personi për qëllime parandaluese dhe paraqitjes së menjëhershme të personit para një gjyqtari duhet të jetë më e shkurtër se në rastin e paraburgimit në procedimet penale. Si rregull, në kontekstin e ndalimit parandalues, lirimi në një kohë më të hershme se sa e kontrollit të menjëhershëm gjyqësor duhet të jetë çështje orësh dhe jo ditësh (*S., v. dhe A. kundër Danimarkës* [DHM], 2018, §§ 133-134).

185. Fakti që personi i arrestuar ka pasur mundësi t'i drejtohet një autoriteti gjyqësor nuk mjafton për t'u konsideruar në përputhje me pjesën hyrëse të nenit 5 § 3 (*De Jong, Baljet dhe Van den Brink kundër Holandës*, 1984, § 51; *Pantea kundër Rumanisë*, 2003, § 231).

186. Kontrolli gjyqësor i ndalimit duhet të jetë automatik dhe nuk mund të lihet në varësi të një kërkesë të bërë nga personi i ndaluar (*McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2006, § 34; *Varga kundër Rumanisë*, 2008, § 52; *Viorel Burzo kundër Rumanisë*, 2009, § 107). Një kërkesë e tillë, jo vetëm që do të ndryshonte natyrën e garancisë së parashikuar në nenin 5 § 3, garanci e cila dallohet nga ajo e parashikuar nga neni 5 § 4, kjo e fundit garanton të drejtën për të filluar një procedurë gjyqësore që të shqyrtohet ligjshmëria e ndalimit nga një gjykatë. Ajo madje mund të kundërshtojë qëllimin e garancisë sipas nenit 5 § 3 që synon mbrojtjen e personit nga ndalimi arbitrar duke siguruar që veprimi i privimit të lirisë t'i nënshtrohet një kontrolli gjyqësor të pavarur (*Aquilina kundër Maltës* [DHM], 1999, § 49; *Niedbała kundër Polonisë*, 2000, § 50).

187. Karakteri automatik i kontrollit është i domosdoshëm për arritjen e qëllimit të këtij paragrafi, pasi një person i keqtrajtuar mund të mos jetë në gjendje t'i drejtohet një gjyqtari me një kërkesë për kontroll ligjshmërie të ndalimit të tij; e njëjta vlen edhe për kategori të tjera personash të cenusëm të arrestuar, siç janë ata me çrregullime mendore ose ata që nuk e dinë gjuhën e nëpunësit gjyqësor (*McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2006, § 34; *Ladent kundër Polonisë*, 2008, § 74).

3. Natyra e zyrtarit gjyqësor të përshtatshëm

188. Shprehja “gjyqtar ose një zyrtar tjetër i autorizuar me ligji për të ushtruar funksione gjyqësore” është sinonim i “autoritetit kompetent gjyqësor”, në kuptimin e nenit 5 § 1 (c), (*Schiesser kundër Zvicrës*, 1979, § 29).

189. Ushtrimi i “funksionit gjyqësor” nuk kufizohet domosdoshmërisht me gjykimin e mosmarrëveshjeve ligjore. Neni 5 § 3 përfshin si zyrtarët e prokurorisë publike ashtu edhe gjyqtarët që janë caktuar në gjykatë (*ibid.*, § 28).

190. “Zyrtari” i përmendur në paragrafin 3 duhet të ofrojë garanci të përshtatshme për funksionet “gjyqësore” që i janë dhënë me ligj atij (*ibid.*, § 30).

191. Kërkesat formale e të dukshme të përcaktuara nga “ligji”, në krahasim me disa praktika të zakonshme, janë veçanërisht të rëndësishme për identifikimin e autoritetit gjyqësor që ka kompetencë për të marrë vendim mbi lirinë e një individi (*Hood kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 1999, § 60; *De Jong, Baljet dhe Van den Brink kundër Holandës*, 1984, § 48).

192. “Zyrtari” nuk është njëjtë me “gjyqtarin”, por gjithsesi duhet të ketë disa nga cilësitë e këtij të fundit, duke përbushur disa kushte ku secili përbën garanci më vete për personin e arrestuar (*Schiesser kundër Zvicrës*, 1979, § 31).

4. Pavarësia

193. Kushti i parë është pavarësia nga ekzekutivi dhe nga palët. Kjo nuk përjashton që "zyrtari" të ketë një shkallë varësie institucionale nga gjyqtarë ose zyrtarë të tjerë, për sa kohë që këta vetë gëzojnë pavarësi të ngjashme (*ibid*).

194. Një zyrtar gjyqësor që është kompetent për të marrë vendim mbi ndalimin mund të kryejë gjithashtu edhe funksione të tjera, por ekziston rreziku që paanësia e tij të krijojë dyshim legjitim, nëse ai ka tagra të ndërhyjë në procedurën e mëtejshme si përfaqësues i autoritetit procedues, për personat që janë objekt i vendimeve të tij (*Huber kundër Zvicrës*, 1990, § 43; *Brincat kundër Italisë*, 1992, § 20).

195. Në këtë drejtim, rëndësi kanë paraqitjet objektive në çastin e marrjes së vendimit; nëse në atë çast, duket se "zyrtari i autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore" mund të ndërhyjë në një fazë të mëvonshme të procedurës penale në emër të autoritetit procedues, paanësia dhe pavarësia e tij mund të vihen në dyshim (*ibid.*, § 21; *Hood kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1999, § 57; *Nikolova kundër Bullgarisë* [DHM], 1999, § 49; *Pantea kundër Rumanisë*, 2003, § 236).

5. Kërkesa procedurale

196. Kërkesa procedurale e nenit 5 § 3 detyron "zyrtarin" që, përpara se të japë vendimin e përshatshëm, të dëgjojë personalisht personin e sjellë përpara atij ose saj (*Schiesser kundër Zvicrës*, 1979, § 31; *De Jong, Baljet dhe Van den Brink kundër Holandës*, 1984, § 51; *Nikolova kundër Bullgarisë* [DHM], 1999, § 49; *Aquilina kundër Maltës* [DHM], 1999, § 50).

197. Prania e avokatit në seancë gjyqësore nuk është e detyrueshme (*Schiesser kundër Zvicrës*, 1979, § 36). Megjithatë, përjashtimi i avokatit nga seanca mund të ndikojë negativisht në aftësinë e kërkuarit për të parashtruar çështjen e tij (*Lebedev kundër Ruisisë*, 2007, §§ 83-91).

6. Kërkesa substanciale

a. Kontrolli i i themelit të paraburgimit

198. Kërkesa substanciale e detyron "zyrtarin" që të vlerësojë rrethanat në favor ose kundër paraburgimit dhe të vendosë në bazë të kriterëve juridike nëse ekzistojnë arsye që përligjin paraburgimin (*Schiesser kundër Zvicrës*, 1979, § 31; *Pantea kundër Rumanisë*, 2003, § 231). Me fjalë të tjera, neni 5 § 3 kërkon që zyrtari gjyqësor të vlerësojë themelin e paraburgimit (*Aquilina kundër Maltës* [DHM], 1999, § 47; *Krejčíř kundër Republikës Çeke*, 2009, § 89).

199. Kontrolli automatik fillestar i arrestimit dhe i paraburgimit duhet të mundësojë shqyrtimin e çështjeve të ligjshmërisë, si edhe verifikimin nëse ekziston dyshim i arsyeshëm se personi i arrestuar ka kryer një vepër penale, domethënë nëse paraburgimi përfshihet në përjashtimet e lejuara që të përcaktuara nga neni 5 § 1 (c) (*McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2006, § 40; *Oral dhe Atabay kundër Turqisë*, 2009, § 41).

200. Çështjet që duhet të shqyrtojnë zyrtari gjyqësor shkojnë përtej çështjes së ligjshmërisë. Meqenëse qëllimi i këtij kontrolli është të përcaktohet nëse privimi i lirisë së individit është i përligjur, shqyrtimi i kërkuar nga neni 5 § 3 duhet të jetë mjaftueshëm i gjerë për të përfshirë rrethanat e ndryshme në favor ose kundër ndalimit (*Aquilina kundër Maltës* [DHM], 1999, § 52).

201. Në rrethana të veçanta të çështjes, shtrirja e kontrollit të ligjshmërisë sipas nenit 5 § 3 mund të jetë më e kufizuar sesa ajo që parashikohet nga neni 5 § 4 (*Stephens kundër Maltës (nr. 2)*, 2009, § 58).

b. Kompetenca për të urdhëruar lirim

202. Në qoftë se nuk ka ndonjë arsye për të përligjur paraburgimin, “zyrtari” duhet të ketë kompetencën për të nxjerrë një urdhër të detyrueshëm për lirim e të paraburgosurit (*Asenov dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, 1998, § 146; *Nikolova kundër Bullgarisë* [DHM], 1999, § 49; *Niedbała kundër Polonisë*, 2000, § 49; *McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2006, § 40).

203. Për të minimizuar vonesën, do të ishte e volitshme që zyrtari gjyqësor që kryen kontrollin automatik fillestar të ligjshmërisë dhe ekzistencës së një shkakut për paraburgim të ketë gjithashtu edhe kompetencën për të vlerësuar lirim me garanci pasurore. Megjithatë, kjo nuk përbën një kërkesë të Konventës dhe nuk ka asnjë arsye, në parim, që këto çështje të mos mund të trajtohen nga dy zyrtarë gjyqësorë të ndryshëm, brenda afatit të kërkuar. Në çdo rast, si çështje interpretimi, nuk mund të kërkohej që shqyrtimi i lirit me garanci pasurore të zhvillohet më shpejt sesa kërkohej për kontrollin automatik fillestar, për të cilin Gjykata ka përcaktuar një afat maksimal prej katër ditësh (*ibid.*, § 47; shih edhe *Magee dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2015, ku mungesa e mundësisë për lirim me garanci gjatë fazave të hershme të ndalimit të kërkuarve nuk çoi në shfaqjen e ndonjë çështjeje sipas nenit 5 § 3 të Konventës).

C. E drejta për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ose për t’u liruar në pritje të gjykimit (neni 5 § 3)

Neni 5 paragrafi 3 i Konventës

"3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni,ka të drejtë të gjykohej brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet nga garanci për t’u paraqitur para gjykatës.

Fjalët kyçe të HUDOC

Gjykim brenda një afati të arsyeshëm (5-3) - Lirimi në pritje të gjykimit (5-3) - Kohëzgjatja e paraburgimit (5-3) - Arsyetimi i paraburgimit (5-3) - Lirimi me kusht (5-3) - Garanci për t’u paraqitur para gjykatës (5-3).

1. Periudha që duhet të merret parasysh

204. Për të përcaktuar kohëzgjatjen e paraburgimit në pritje të gjykimit sipas nenit 5 § 3 të Konventës, periudha që duhet të merret parasysh fillon në ditën kur i akuzuari vendoset në paraburgim dhe merr fund në ditën kur përcaktohet akuza përmes deklaramentit të fajësisë, edhe nëse jo bëhet vetëm nga një gjykatë e shkallës së parë (shih, për shembull, *Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2)* [DHM], 2020, § 290; *Štvrtecký kundër Sllovakisë*, 2018, § 55; *Solmaz kundër Turqisë*, 2007, §§ 23-24; *Kalashnikov kundër Rusisë*, 2002, § 110; *Wemhoff kundër Gjermanisë*, 1968, § 9).

205. Duke pasur parasysh lidhjen thelbësore ndërmjet nenit 5 § 3 të Konventës dhe paragrafit 1 (c) të po këtij neni, një person i dënuar në shkallë të parë nuk mund të konsiderohet më i paraburgosur “për t’u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka dyshim të arsyeshëm se ai ka kryer një vepër penale”, siç specifikohet në paragrafin e fundit, sepse ai ndodhet në situatën e parashikuar në nenin 5 § 1 (a), i cili e lejon privimin e lirisë “pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente” (*Belevitskiy kundër Rusisë*, 2007, § 99; *Piotr Baranowski kundër Polonisë*, 2007, § 45; *Górski kundër Polonisë*, 2005, § 41).

2. Parime të përgjithshme

206. Pjesa e dytë e nenit 5 § 3 nuk i jep autoriteteve gjyqësore zgjedhje tjetër, përveçse midis çuarjes së të akuzuarit për gjykim gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ose dhënies së lirimit të përkohshëm derisa gjykimi i tij është i varur. Deri në dënimin e tij, personi i akuzuar duhet të prezumohet i pafajshëm dhe qëllim i dispozitës së analizuar është që në thelb të kërkojë lirimin e përkohshëm sapo mbajtja në paraburgim të pushojë së qeni e arsyeshme.

207. Çështja nëse periudha kohore e qëndrimit në paraburgim është e arsyeshme apo jo, nuk mund të vlerësohet në mënyrë të përgjithshme abstrakte. Mbajtja e një të akuzuari në paraburgim mund të vlerësohet si e arsyeshme apo jo bazuar në faktet e secilit rast dhe sipas veçorive specifike të tij. Kështu, vazhdimi i paraburgimit, mund përligjet në një çështje të caktuar vetëm nëse ka tregues konkrete të një nevojë të mirëfilltë të interesit publik, e cila pavarësisht prezumimit të pafajësisë, ka epërsi mbi rregullin e respektimit të lirisë individuale të parashikuar nga neni 5 i Konventës.

208. Përgjegjësia i takon në radhë të parë autoriteteve gjyqësore kombëtare për të siguruar, në një çështje të caktuar, që paraburgimi i një të akuzuari të mos e tejkalojë kohëzgjatjen e arsyeshme. Për këtë qëllim, duke marrë parasysh në mënyrën e duhur parimin e prezumimit të pafajësisë, ato duhet të shqyrtojnë të gjitha faktet që tregojnë ose e hedhin poshtë ekzistencën nevojës së lartpërmendur të kërkesës së interesit publik, e cila e përligj një shmangie nga rregulli i vendosur nga neni 5 dhe t'i parashtrajnë ato në vendimet e tyre mbi kërkesat për lirim. Është pikërisht, në bazë të këtyre arsyeve të paraqitura në këto vendime dhe të fakteve të përcaktuara në parashtrimet e kërkuarit në ankimin e tij që Gjykata thirret të vendosë nëse ka pasur ose jo shkelje të nenit 5 § 3 (*Buzadji kundër Republikës së Moldavisë* [DHM], 2016, §§ 89-91; *McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2006, §§ 41-43).

209. Vazhdimësia e qëndrueshme e dyshimit të arsyeshëm është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit. Megjithatë, kur autoritetet gjyqësore kombëtare fillimisht shqyrtojnë "me shpejtësi" pas arrestimit, çështjen nëse i arrestuari duhet vendosur paraburgim ose jo, ai dyshim nuk mjafton më, dhe autoritetet duhet të japin arsye të tjera relevante dhe të mjaftueshme për të përligjur paraburgimin (*Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DHM], 2017, § 222, dhe *Buzadji kundër Republikës së Moldavisë* [DHM], 2016, § 102). Kur këto arsye vazhdojnë të përligjin privimin e lirisë, Gjykata duhet të jetë gjithashtu e bindur se autoritetet kombëtare kanë treguar "kujdes të veçantë" në zhvillimin e proceseve (*Buzadji kundër Republikës së Moldavisë* [DHM], 2016, § 87; *Idalov kundër Rusisë* [DHM], 2012, § 140).

210. Duke pasur parasysh afërsinë e ngushtë mes parimeve përkatëse të zhvilluara sipas nenit 5 §§ 1 (c) dhe 3, Gjykata mund të vendosë të shqyrtojë një ankesë lidhur me paraburgimin njëkohësisht sipas të dy dispozitave. (*Cviková kundër Sllovakisë*, 2024, § 71).

211. Argumentet në favor dhe kundër lirimit nuk duhet të jenë "të përgjithshme dhe abstrakte" (*Boicenco kundër Moldavisë*, 2006, § 142; *Khudoyorov kundër Rusisë*, 2005, § 173), por duhet të mbështeten në fakte specifike dhe rrethanat personale të kërkuarit që përligjin paraburgimin e tyre (*Aleksanyan kundër Rusisë*, 2008, § 179; *Rubtsov dhe Balayan kundër Rusisë*, 2018, §§ 30-32; *Perstner kundër Luksemburgut*, 2023, § 33).

212. Zgjatja pothuajse automatike e paraburgimit është në kundërshtim me garancitë e parashikuara nga neni 5 § 3 (*Tase kundër Rumanisë*, 2008, § 40).

213. I takon autoriteteve të përcaktojnë qëndrueshmërinë e vijimit të arsyeve që përligjin vazhdimësinë e paraburgimit (*Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DHM], 2017, § 234). Në këto çështje, nuk duhet të përmbysset barra e provës, duke i ngarkuar personit të paraburgosur detyrimin për të provuar ekzistencën e arsyeve për lirimin e tij (*Bykov kundër Rusisë* [DHM], 2009, § 64).

214. Nëse mund të ketë pasur rrethana që përligjin paraburgimin e një personi, por ato nuk janë përmendur në vendimet e gjykatave të brendshme, nuk i takon Gjykatës t'i përcaktojë ato dhe të zërë vendin autoriteteve kombëtare që kanë vendosur mbi paraburgimin e kërkuarit (*ibid.*, § 66; *Giorgi*

Nikolaishvili kundër Gjeorgjisë, 2009, § 77). Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë kontroll publik të administrimit të drejtësisë (*Tase kundër Rumanisë*, 2008, § 41).

3. Përligjja e çdo lloj periudhe paraburgimi

215. Neni 5 § 3 nuk mund të shihet sikur lejon në mënyrë të pakushtëzuar paraburgimin, nëse ai nuk ka zgjatur më shumë se kohëzgjatjeja minimale. Autoritetet duhet të vërtetojnë në mënyrë bindëse përligjen e çdo lloj periudhe paraburgimi, sado e shkurtër qoftë ajo (*Idalov kundër Rusisë* [DHM], 2012, § 140; *Tase kundër Rumanisë*, 2008, § 40; *Castravet kundër Moldavisë*, 2007, § 33; *Belchev kundër Bullgarisë*, 2004, § 82).

4. Shkaqet për paraburgimin vazhdues

216. Paraktika gjyqësore që rrjedh nga Konventa ka zhvilluar katër arsye kryesore të pranueshme për refuzimin e garancisë pasurore: (a) rreziku që i akuzuari të mos paraqitet në gjykim; (b) rreziku që, nëse lirohet, i akuzuari të ndërmarrë një veprim që dëmton administrimin e drejtësisë, ose (c) të kryejë vepra të tjera penale ose (d) të prishë rendin publik (*Buzadji kundër Republikës së Moldavisë* [DHM], 2016, § 88; *Tiron kundër Rumanisë*, 2009, § 37; *Smirnova kundër Rusisë*, 2003, § 59; *Piruzyan kundër Armenisë*, 2012, § 94). Këto rreziqe duhet të jenë të provohen siç duhet dhe arsyetimi i autoriteteve mbi këto çështje nuk mund të jetë abstrakt, i përgjithshëm ose stereotipik. (*Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DHM], 2017, § 222). Megjithatë, asgjë nuk pengon autoritetet gjyqësore kombëtare që të miratojnë ose të përfshijnë me referencë çështjet specifike të cituara nga autoritetet që kërkojnë urdhërimin e paraburgimit. (*ibid.*, § 227).

a. Rreziku i arratisjes

217. Rreziku i arratisjes nuk mund të vlerësohet vetëm mbi bazën e ashpërsisë së masës së dënimit që mund të jepet. Ai duhet të vlerësohet në varësi të një numri të caktuar elementesh të tjera të rëndësishme të cilat, ose mund ta konfirmojnë ekzistencën e rrezikut të arratisjes, ose ta bëjnë atë të duket aq i vogël saqë të mos e përligjë paraburgimin (*Panchenko kundër Rusisë*, 2005, § 106).

218. Rreziku i arratisjes duhet të vlerësohet në dritën e elementeve që lidhen me personalitetin e personit, me moralin e tij, banimin, profesionin, pasuritë, lidhjet e tij familjare, si dhe me lloje të tjera lidhjesh me vendin ku ai po ndiqet penalisht (*Becciev kundër Moldavisë*, 2005, § 58).

219. Vetëm mungesa e një vendbanimi të përhershëm nuk çon në shfaqjen e rrezikut të arratisjes (*Sulaoja kundër Estonisë*, 2005, § 64).

220. Rreziku i arratisjes ulet domosdoshmërisht me kalimin e kohës në paraburgim (*Neumeister kundër Austrisë*, 1968, § 10).

221. Kur arsyeja e vetme e mbetur për paraburgimin është frika se i pandehuri do të largohet dhe do të shmangë kështu paraqitjen në proces, ai ose ajo duhet të lirohet në pritje të gjykimit nëse është e mundur marrja e garancive që sigurojnë paraqitjen e tij (*Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DHM], 2017, § 223).

222. Ndonëse ashpërsia e dënimit që do përballej është element i rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut që një i akuzuar mund të arratiset, rëndesa e akuzave nuk mund të shërbejë në vetvete për të përligjur periudha të gjata paraburgimi (*Idalov kundër Rusisë* [DHM], 2012, § 145; *Garycki kundër Polonisë*, 2007, § 47; *Chraidi kundër Gjermanisë*, 2006, § 40; *Ilijkov kundër Bullgarisë*, 2001, §§ 80-81).

223. Ndonëse në përgjithësi, shprehja “gjendja e provave” mund të jetë element i rëndësishëm për ekzistencën dhe vazhdimësinë e treguesve të rëndë të fajsisë, e vetme ajo nuk mund të përligjë periudhën e gjatë të paraburgimit (*Dereci kundër Turqisë*, § 38).

b. Pengimi i procedimit

224. Rreziku që i akuzuari të pengojë mbarëvajtjen e procedimit nuk mund të bazohet *in abstracto*, ai duhet të mbështetet në prova faktike (*Becciev kundër Moldavisë*, 2005, § 59).

225. Rreziku i presionit që mund t'i bëhet dëshmitarëve mund të pranohet në fazat e hershme të procedimit (*Jarzyński kundër Polonisë*, 2005, § 43). Megjithatë, nuk mund të bazohet vetëm në gjasat e një mase të ashpër dënimi, por duhet të lidhet me faktet specifike (*Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DHM], 2017, § 224).

226. Sidoqoftë, me kalimin e kohës, nevojat e hetimit nuk mjaftojnë më për të përligjur paraburgimin e një të dyshuari: në zhvillimin normal të ngjarjeve, rreziqet e pretenduara zvogëlohen me kalimin e kohës, ndërsa hetimet zhvillohen, merren deklarime dhe bëhen verifikime (*Clooth kundër Belgjikës*, 1991, § 44).

227. Në rastet që kanë të bëjnë me aktivitete ose grupe të organizuara kriminale, rreziku që një i paraburgosur, nëse lirohet, mund të ushtrojë presion mbi dëshmitarët ose të bashkë-dyshuarit e tjerë, ose të pengojë procedimin në ndonjë mënyrë tjetër, shpesh është veçanërisht i lartë (*Štvrtecký kundër Sllovakisë*, 2018, § 61; *Podeschi kundër San Marinos*, 2017, § 149; *Staykov kundër Bullgarisë*, 2021, § 83).

c. Përsëritja e veprave penale

228. Rëndesa e një akuze mund të çojë që autoritetet gjyqësore ta vënë dhe ta lënë të dyshuarin në paraburgim për të parandaluar ndonjë tentativë për kryerjen e veprave të tjera penale. Por është gjithashtu e nevojshme që rreziku të jetë i dukshëm dhe masa e përshatshme, në dritën e rrethanave të çështjes, dhe veçanërisht me të kaluarën dhe personalitetin e personit përkatës (*Cloth kundër Belgjikës*, , 1991, § 40).

229. Dënimet e mëparshme mund të shërbejnë si shkak për frikën e arsyeshme që i akuzuari mund të kryejë një vepër tjetër penale (*Selçuk kundër Turqisë*, 2006, § 34; *Matznetter kundër Austrisë*, 1969, § 9).

230. Nuk mund të konkludohet, nga fakti se një person nuk ka as punë, as familje, se ai është i prirur të kryejë vepra të tjera penale (*Sulaoja kundër Estonisë*, 2005, § 64).

d. Ruajtja e rendit publik

231. Pranohet se disa vepra penale, për shkak të rëndesës së tyre të veçantë dhe të reagimit të publikut ndaj tyre, mund të shkaktojnë trazira shoqërore të afta të përligjin paraburgimin, të paktën për njëfarë kohe. Në rrethana të jashtëzakonshme, ky element mund të merret parasysh për qëllime të Konventës, sidoqoftë për aq sa e drejta vendase e njeh nocionin e trazirave të rendit publik të shkaktuar nga një vepër penale.

232. Megjithatë, ky shkak mund të vlerësohet si i rëndësishëm dhe i mjaftueshëm vetëm me kusht nëse bazohet në fakte të afta për të treguar se lirimi i të paraburgosurit do të trazonte realisht rendin publik. Përveç kësaj, paraburgimi do të vijojë të mbetet i ligjshëm vetëm nëse rendi publik mbetet efektivisht i kërcënuar; vazhdimi i tij nuk mund të shërbejë si dhënie e parakohshme e dënimit me burgim (*Letellier kundër Francës*, 1991, § 51; *I.A. kundër Francës*, 1998, § 104; *Prencipe kundër Monakos*, 2009, § 79; *Tiron kundër Rumanisë*, 2009, §§ 41-42).

233. Mbrojtja e rendit publik është veçanërisht e rëndësishme në çështje që kanë të bëjnë me akuzat për shkelje të rëndë të të drejtave themelore të njeriut, siç janë krimet e luftës kundër popullatës civile (*Milanković dhe Bošnjak kundër Kroacisë*, 2016, § 154).

5. Kujdesi i veçantë (diligjenca e posaçme)

234. Natyra e ndërlikuar (kompleksiteti) dhe veçoritë e hetimit janë elemente që duhet merrë parasysh për të vërtetuar nëse autoritetet kombëtare kompetente kanë treguar “kujdes të veçantë” gjatë ndjekjes së procedimit (*Scott kundër Spanjës* 1996, § 74).

235. E drejta e një të akuzuari në paraburgim që çështja e tij të shqyrtohet me shpejtësi të veçantë nuk duhet të pengojë përpjekjet e autoriteteve gjyqësore për të përmbushur detyrat e tyre me kujdesin e duhur (*Shabani kundër Zvicrës*, 2009, § 65; *Sadegül Özdemir kundër Zvicrës*, 2005, § 44).

236. Një pezullim i përkohshëm i procedimeve penale për një periudhë prej afërsisht tre muajsh për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme që lidhen me pandeminë Covid-19 është gjetur se është në përputhje me detyrimin e kujdesit të veçantë kur proceset janë ndjekur në mënyrë aktive si para ashtu edhe pas vendosjes së masave emergjente. (*Fenech kundër Maltës* (vend. pran.), 2021, § 96).

6. Masa alternative

237. Kur vendosin nëse një person duhet të lirohet ose të paraburgoset, autoritetet janë të detyruara të vlerësojnë nëse ka masa të tjera që sigurojnë paraqitjen e tij në gjyq (*Idalov kundër Rusisë* [DHM], 2012, § 140). Dispozita sanksionon jo vetëm “të drejtën për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ose për t’u liruar në pritje të gjykimit”, por gjithashtu parashikon se “lirimi mund të kushtëzohet me një garanci që sigurojnë paraqitjen e të interesuarit për gjykim” (*Khudoyorov kundër Rusisë*, 2005, § 183; *Lelièvre kundër Belgjikës*, 2007, § 97; *Shabani kundër Zvicrës*, 2009, § 62).

7. Garancia pasurore

238. Garancia që parashikon neni 5 § 3 i Konventës nuk është hartuar për të siguruar kompensimin e humbjes së vlerës, por veçanërisht për të garantuar paraqitjen e të akuzuarit në seancë. Prandaj, shuma e saj duhet të vlerësohet parësisht “në raport me [të akuzuarin], me pasuritë e tij, me marrëdhëniet e tij me personat që do të ofrojnë garancinë, me fjalë të tjera, në raport me shkallën e besimit se mundësia e humbjes së garancisë pasurore ose e fillimit të padive kundër garantuesve, në rast mosparaqitjeje në seancë, do të vepronte si pengesë e mjaftueshme për të larguar çdo dëshirë të personit për t’u arratisur” (*Gafà kundër Maltës*, 2018, § 70; *Mangouras kundër Spanjës* [DHM], 2010, § 78; *Neumeister kundër Austrisë*, 1968, § 14).

239. Garancia pasurore mund të kërkohet vetëm për sa kohë që mbizotërojnë arsyet që përlligjin paraburgimin (*Muşuc kundër Moldavisë*, 2007, § 42; *Aleksandr Makarov kundër Rusisë*, 2009, § 139). Nëse rreziku i arratisjes mund të shmanget nëpërmjet një garancie pasurore apo të një garancie tjetër, i akuzuari duhet liruar, duke pasur parasysh se, në rastet kur mund të paraprihet një dënim më i lehtë, ulja e prirjes së të akuzuarit për t’u arratisur gjithashtu, duhet të merret në konsideratë (*Vrenčev kundër Serbisë*, 2008, § 76). Autoritetet duhet të tregojnë po aq kujdes në caktimin e një garancie pasurore të përshtatshme sa edhe për vendimin nëse vazhdimi i paraburgimit i të akuzuarit është ose jo i domosdoshëm (*Piotr Osuch kundër Polonisë*, 2009, § 39; *Bojilov kundër Bullgarisë*, 2004, § 60; *Skrobol kundër Polonisë*, 2005, § 57).

240. Për më tepër, shuma e vendosur si garanci pasurore duhet të duhet të arsyetohet në mënyrën e duhur në vendimin për caktimin e garancisë pasurore (*Georgieva kundër Bullgarisë*, 2008, §§ 15 dhe 30-31) dhe duhen marrë parasysh mjetet financiare të të akuzuarit (*Gafà kundër Maltës*, 2018, § 70; *Hristova kundër Bullgarisë*, 2006, § 111) dhe aftësitë e tij paguese (*Toshev kundër Bullgarisë*, 2006, §§ 69-73). Në disa rrethana, nuk do të ishte e paarsyeshme që të merret parasysh edhe shuma e humbjes që do t’i atribuohet atij (*Mangouras kundër Spanjës* [DHM], 2010, §§ 81 dhe 92).

241. Fakti që një i paraburgosur vijon të qëndrojë në paraburgim edhe pasi i është dhënë garancia pasurore sugjeron se gjykatat vendase nuk kanë treguar kujdesin e nevojshëm për të caktuar një

garanci pasurore të përshtatshme (*Gafà kundër Maltës*, 2018, § 73; *Kolakovic kundër Maltës*, 2015, § 72).

242. Autoriteteve u kërkohet të zhvillojnë procedimet me “kujdes të veçantë” edhe pas dhënies formale të garancisë pasurore, ndërkohë që personi vazhdon të mbahet në paraburgim për shkak të paaftësisë së tij paguese (*Gafà kundër Maltës*, 2018, § 71; *Kolakovic kundër Maltës*, 2015, § 74).

243. Refuzimi automatik i një garancie pasurore në bazë të ligjit, në mungesë të çdo kontrolli gjyqësor, është i papajtueshëm me garancitë e nenit 5 § 3 (*Piruzyan kundër Armenisë*, 2012, § 105; *S.B.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2001, §§ 23-24). Megjithatë, kur gjykatat e brendshme kanë dhënë vendime paraburgimi të arsyetuara siç duhet, pavarësisht ligjit që kufizon tagrin e tyre për të dhënë garancinë pasurore, Gjykata nuk ka gjetur shkelje të nenit 5 § 3 (*Grubnyk kundër Ukrainës*, 2020, §§ 116-130).

8. Paraburgimi i të miturve

244. Paraburgimi i të miturve duhet të përdoret vetëm si masë e zgjidhjes së fundit; ai duhet të jetë sa më i shkurtër dhe, kur paraburgimi është rreptësisht i domosdoshëm, të miturit duhet të mbahen të ndarë nga të rriturit (*Nart kundër Turqisë*, 2008, § 31; *Güveç kundër Turqisë*, 2009, § 109).

D. E drejta për shqyrtimin pa vonesë të ligjshmërisë së paraburgimit nga një gjykatë (neni 5 § 4)

Neni 5 paragrafi 4 i Konventës

“4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.

Fjalët kyçe të HUDOC

Rishikim i ligjshmërisë së burgimit (5-4) - T'i drejtohet gjykatës (5-4) - Rishikimi nga gjykata (5-4) - Shpejtësia e rishikimit (5-4) - Garancitë procedurale të rishikimit (5-4) - Urdhër lirimi (5-4)

1. Qëllimi i dispozitës

245. Neni 5 § 4 është dispozita *habeas corpus* e Konventës. Ai i jep çdo të paraburgosuri të drejtën për të kërkuar aktivisht një shqyrtim gjyqësor të paraburgimit të tij (*Mooren kundër Gjermanisë* [DHM], 2009, § 106; *Rakevich kundër Rusisë*, 2003, § 43).

Neni 5 § 4 i siguron gjithashtu personave të arrestuar ose të paraburgosur të drejtën që gjykata të vendosë “pa vonesë” mbi ligjshmërinë e paraburgimit të tyre dhe që të urdhërohet lirimi i tyre nëse paraburgimi nuk është i ligjshëm (*Ilneher kundër Gjermanisë* [DHM], 2018, § 251; *Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 2016, § 131).

246. Fakti që Gjykata nuk ka gjetur asnjë shkelje të kërkesave të nenit 5 § 1 të Konventës nuk e përjashton atë nga detyrimi i kryerjes së një shqyrtimi për respektimin e nenit 5 § 4. Dy paragrafët janë dispozita të pavarura dhe respektimi i të parit nuk nënkupton medoemos respektimin e të dytit (*Douiyeb kundër Holandës* [DHM], 1999, § 57; *Kolompar kundër Belgjikës*, 1992, § 45).

247. Në çështjet ku personat e privuar nga liria nuk ishin informuar për arsyet e privimit të lirisë, Gjykata ka gjetur që e drejta e tyre për të kundërshtuar paraburgimin ishte privuar nga çdo thelb efektiv (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 2016, § 132).

2. Zbatueshmëria e dispozitës

248. Ndërsa neni 5 § 4 normalisht parashikon situatat kur një person ngre procedurat ndërsa mbahet nën paraburgim, dispozita mund të zbatohet edhe kur personi nuk është më në paraburgim gjatë procedurave të ankimit, rezultati i të cilave është thelbësor për përcaktimin e ligjshmërisë së paraburgimit të personit. (*Oravec kundër Kroacisë*, 2017, § 65).

Ndërsa garancia e shpejtësisë, pas liritimit të personit, nuk është më e rëndësishme për qëllim të nenit 5 § 4, garancia e efektivitetit të shqyrtimit vazhdon të zbatohet edhe më pas, sepse një ish-i paraburgosur, edhe pasi është liruar, mund të ketë një interes legjitim në përcaktimin e ligjshmërisë së privimit të lirisë së tij ose të saj. (*Kováčik kundër Sllovakisë*, 2011, § 77; *Osmanović kundër Kroacisë*, 2012, § 49). Në veçanti, një vendim mbi çështjen e ligjshmërisë mund të ndikojë në "të drejtën e zbatueshme për dëmshpërblim" sipas nenit 5 § 5 të Konventës. (*S.T.S. kundër Holandës*, 2011, § 61).

Vetë fakti i deklarimit të ankimit si pa objekt pas liritimit të të privuarit nga liria nuk bie medoemos ndesh me nenin 5 § 4 (*Coulibaly kundër Belgjikës*, 2025, §§ 47-51, ku një shtetas i huaj u riatdhësua përpara se ligjshmëria e ndalimit të tij administrativ të mund të përcaktohej nga një shkallë gjyqësore përfundimtare, por ai kishte ende mundësinë të kërkonte kompensim për privimin e paligjshëm të pretenduar).

249. Nuk lind asnjë çështje sipas nenit 5 § 4 nëse paraburgimi i kundërshtuar ndodh për një kohë të shkurtër dhe i paraburgosuri lirohet shpejt përpara se të mund të zhvillohet ndonjë shqyrtim gjyqësor i ligjshmërisë së paraburgimit të tij ose të saj (*Slivenko kundër Letonisë* [DHM], 2003, §§ 159-159, në lidhje me periudhat e paraburgimit deri në tridhjetë orë; *Rozhkov kundër Rusisë (nr. 2)*, 2017, § 65, në lidhje me paraburgimin për disa orë).

Megjithatë, nëse nuk ka asnjë mjet juridik në dispozicion të individëve për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit të tyre, shqyrtimi i një ankimi sipas nenit 5 § 4 është konsideruar i justifikuar, pavarësisht nga kohëzgjatja e paraburgimit (*Moustahi kundër Francës*, 2020, §§ 103-104, ku Gjykata gjeti shkelje të kësaj dispozite në lidhje me paraburgimin administrativ të të miturve të pashoqëruar që zgjati disa orë).

Neni 5 § 4 është gjetur se zbatohet edhe për periudha të shkurtra paraburgimi në rastet kur fushëveprimi i shqyrtimit (kontrollit) gjyqësor në dispozicion ka qenë kufizuar së tepërmi (shih *Petkov dhe Profirov kundër Bullgarisë*, 2014, §§ 67-70, në lidhje me ndalimin e kërkesave për njëzet e katër orë; *A.M. kundër Francës*, 2016, §§ 36-42, ku dispozita u zbatua për një periudhë tre ditë e gjysmë ndalimi administrativ në pritje të dëbimit).

250. Nëse një personi i privohet liria pas shpalljes së një dënimi nga një gjykatë kompetente, kontrolli i kërkuar nga neni 5 § 4 është i përfshirë në vendimin e gjykatës në përfundim të procesit gjyqësor (*De Wilde, Ooms dhe Versyp kundër Belgjikës*, § 76) dhe nuk kërkohet asnjë shqyrtim i mëtejshëm. Megjithatë, në rastet kur shkaku që përlligj privimin e lirisë mund të ndryshojë me kalimin e kohës, duhet të ekzistojë mundësia për ankim pranë një organi që përmbush kërkesat e nenit 5 § 4 të Konventës (*Kafkaris kundër Qipros* (vend. pran.), 2011, § 58).

251. Neni 5 § 4 rifillon të zbatohet edhe kur, pas një dënimi, lindin çështje të reja që prekin ligjshmërinë e privimit nga liria (shih *Etute kundër Luksemburgut*, 2018, § 25 dhe 33 në lidhje me një vendim që revokon lirimimin e të burgosurit me leje; *Ivan Todorov kundër Bullgarisë*, 2017, §§ 59-61, në lidhje me çështjen nëse dënimi i dhënë për një vepër penale rreth njëzet vjet më parë ishte parashkuar).

252. Kur Shtetet Kontraktuese parashikojnë procedura që shkojnë përtej kërkesave të nenit 5 § 4 të Konventës, garancitë e dispozitës duhet të respektohen edhe në këto procedura. Neni 5 § 4 është gjetur kështu i zbatueshëm në periudhën pas-dënimit, sepse legjislacioni vendas parashikonte që një person të mbahej në paraburgim deri sa dënimi i tij ose i saj të bëhej i formës së prerë, duke përfshirë edhe procedurat e ankimit, dhe i njihte të njëjtat të drejta procedurale të gjithë të paraburgosurve

në pritje të gjykimit (*Stollenwerk kundër Gjermanisë*, 2017, § 36; shih edhe *Yilmaz Aydemir kundër Turqisë*, 2023, §§ 40-41, ku legjislacioni vendas u siguronte garancitë e rëndësishme procedurale të paraburgosurve para dhe pas shpalljes së dënimit).

253. Edhe pse neni 5 § 4 nuk i detyron Shtetet Kontraktuese të krijojnë një nivel të dytë juridiksioni për shqyrtimin e ligjshmërisë së paraburgimit, një Shtet që krijon një sistem të tillë duhet, në parim, t'u japë të paraburgosurve të njëjtat garanci në ankim si në shkallën e parë (*Ilseher kundër Gjermanisë [DHM]*, 2018, § 254; *Kučera kundër Sllovakisë*, 2007, § 107; *Navarra kundër Francës*, 1993, § 28; *Toth kundër Austrisë*, 1991, § 84).

254. Ndonëse Shtetet Kontraktuese nuk janë të detyruara të parashikojnë një kontroll automatik periodik me karakter gjyqësor, nëse një Shtet vendos të krijojë një sistem të tillë, ai duhet ta bëjë këtë në një mënyrë të pajtueshme me nenin 14. Kur legjislacioni kombëtar garanton një kontroll automatik periodik të paraburgimit për një kategori të paraburgosurish, kjo përfshihet në fushën e zbatimit të nenit 5 për qëllimet e zbatueshmërisë së nenit 14 të marrë së bashku me të (*Spišák kundër Republikës Çeke*, 2024, §§ 72 dhe 74, në lidhje me periudhat e ndryshme të kontrollit gjyqësor automatik për të mitur dhe të rritur).

255. Neni 5 § 4 mund të jetë i zbatueshëm edhe për procedura para gjykatave kushtetuese (*Ilseher kundër Gjermanisë [DHM]*, 2018, § 254; *Mehmet Hasan Altan kundër Turqisë*, 2018, § 159).

3. Natyra e kontrollit (shqyrtimit) të kërkuar

256. Neni 5 § 4, i njeh çdo personi të arrestuar ose të paraburgosur të drejtën e fillimit të procedurave për shqyrtimin nga një gjykatë të kontrollit të kushteve procedurale dhe materiale, që janë thelbësore për "ligjshmërinë" e privimit të lirisë, në kuptim të nenit 5 § 1 të Konventës (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë [DHM]*, 2016, § 128; *Idalov kundër Rusisë [DHM]*, 2012, § 161; *Reinprecht kundër Austrisë*, 2005, § 31).

Nocioni i "ligjshmërisë" në kuptimin e nenit 5 § 4 ka të njëjtin kuptim si në nenin 5 § 1, pra çdo person i arrestuar ose i paraburgosur ka të drejtën që të kërkojë kontrollin e "ligjshmërisë" së paraburgimit të tij, jo vetëm në dritën e kërkesave të së drejtës së brendshme, por edhe të Konventës, të parimeve të përgjithshme të përfshira në të dhe të qëllimit të kufizimeve që lejon neni 5 § 1 (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë [DHM]*, 2016, § 128; *Suso Musa kundër Maltës*, 2013, § 50; shih edhe *A.M. kundër Francës*, 2016, §§ 40-41, në lidhje me fushëveprimin e kërkuar të kontrollit gjyqësor sipas nenit 5 § 1 (f)).

257. "Gjykata" ku personi i paraburgosur mund të drejtohet për qëllimet e nenit 5 § 4 nuk duhet domosdoshmërisht të jetë gjykatë e llojit klasik, e përfshirë në strukturat e zakonshme gjyqësore të vendit (*Weeks kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1987, § 61). Megjithatë, duhet të jetë një organ me "natyrë gjyqësore" që ofron disa garanci procedurale. Kështu "gjykata" duhet të jetë e pavarur, si nga ekzekutivi, ashtu edhe nga palët e çështjes (*Stephens kundër Maltës (nr. 1)*, 2009, § 95; *Ali Osman Özmen kundër Turqisë*, 2016, § 87; *Baş kundër Turqisë*, 2020, §§ 266-267; *J.B. dhe të tjerë kundër Maltës*, 2024, § 143, ku Gjykata konfirmoi se termi "gjykatë" i përdorur në nenin 5 § 4 duhet të interpretohet si një organ që gëzon të njëjtat cilësi të pavarësisë dhe të paanshmërisë siç kërkohen për "tribunalin" e përmendur në nenin 6).

258. Format e kontrollit gjyqësor që përmbushin kërkesat e nenit 5 § 4 mund të ndryshojnë nga njëra fushë në tjetrën dhe mund të varen nga lloji përkatës i privimit të lirisë (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë [DHM]*, 2016, § 129; *M.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2013, § 75).

259. Nuk përjashtohet që një sistem kontrolli periodik automatik i ligjshmërisë së një paraburgimi nga gjykata mund të garantojë respektimin e kërkesave të nenit 5 § 4. Sidoqoftë, kur kontrolli automatik është krijuar, vendimet mbi ligjshmërinë e paraburgimit duhet të ndjekin "intervale të arsyeshme" (*Abdulkhanov kundër Rusisë*, 2012, §§ 209 dhe 212-14, për një përmbledhje të praktikës gjyqësore në kontekstin e paraburgimit sipas nënparagrafit (a), (c), (e) dhe (f) të nenit 5 § 1).

Një shkelje e afateve kohore për kontrollet automatike të përcaktuara me ligj nuk përbën domosdoshmërisht shkelje të nenit 5 § 4, nëse ligjshmëria e paraburgimit të kërkuesit është shqyrtuar pa vonesë nga një gjykatë. (*Aboya Boa Jean kundër Maltës*, 2019, § 80).

260. Vulnerabiliteti i veçantë i të miturve kërkon që Shteti të sigurojë që zgjatja e paraburgimit të të rinjve të bëhet në intervale të shkurtra dhe që i riu përkatës të paraqitet rregullisht para gjykatës, gjë që mund të jetë gjithashtu një garanci e rëndësishme kundër keqtrajtimit (*Spišák kundër Republikës Çeke*, 2024, § 82).

261. Kur në legjislacionin e brendshëm nuk parashikohet asnjë kontroll automatik i ligjshmërisë së paraburgimit, ndalimi i paraqitjes së kërkesave të reja për lirim për një periudhë kohore mund të përligjet në rastet e abuzimit të dukshëm me të drejtat procedurale të të paraburgosurve. Megjithatë, u takon autoriteteve të provojnë domosdoshmërinë e një mase të tillë me arsye relevante dhe të mjaftueshme me qëllim heqjen çdo dyshimi mbi arbitraritet (*Dimo Dimov dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, 2020, §§ 84-90, ku Gjykata vendosi se ndalimi për dy muaj i paraqitjes së kërkesave të mëtejshme për lirim ishte i pajustificuar dhe në kundërshtim me të drejtën e kërkuesit që paraburgimi i tij të shqyrtohet në intervale të shkurtra e të rregullta).

262. Në bazë të nenit 5 § 4 çdo i paraburgosur ka të drejtën t'i drejtohet një "gjykate" që ka juridiksion të marrë një vendim "pa vonesë" nëse privimi i lirisë ndaj tij është ose jo "i paligjshëm" në dritën e rrethanave të reja që kanë dalë në pah pas vendimit fillestar për privimin e personit nga liria (*Abdulkhanov kundër Rusisë*, 2012, § 208; *Azimov kundër Rusisë*, 2013, §§ 151-52).

263. Nëse një person paraburgoset sipas nenit 5 § 1 (c) të Konventës, "gjykata" duhet të ketë kompetencën të shqyrtojë nëse ka ose jo prova të mjaftueshme për të ngritur dyshimin e arsyeshëm që ai ose ajo ka kryer një vepër penale, sepse ekzistenca e këtij dyshimi është thelbësore që paraburgimi sipas Konventës të jetë "i ligjshëm" (*Dimo Dimov dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, 2020, § 70; *Nikolova kundër Bullgarisë* [DHM], 1999, § 58).

264. Çdo person me çrregullim mendor, i izoluar detyrimisht në një institucion psikiatrik për një periudhë të gjatë, duhet të ketë të drejtë të nisë procedura gjyqësore "në intervale të arsyeshme" për të ngritur çështjen e ligjshmërisë së izolimit të tij (*M.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2013, § 77, për një përmbledhje të parimeve të zbatueshme). Sistemi i kontrollit periodik ku nisma i takon vetëm autoriteteve nuk është i mjaftueshëm në vetvete (*X. kundër Finlandës*, 2012, § 170; *Raudevs kundër Letonisë*, 2013, § 82; dhe *Spivak kundër Ukrainës*, 2025, §§ 136-138, ku Gjykata gjeti se, përveç mungesës së përgjithshme të mundësisë që pacientët psikiatrikë të kërkojnë shqyrtim të izolimit të tyre në kohën përkatëse materiale, kontrolli periodik gjyqësor *ex officio* në seanca të zhvilluara në mungesë të detyrueshmë të kërkuesit, u karakterizua nga mungesa e dukshme e kujdesit të duhur dhe nuk ishte në përputhje me kërkesat themelore të drejtësisë (§§ 140-148).

265. Kriteret për "ligjshmërinë e paraburgimit" sipas nenit 5 § 1 (e) nënkuptojnë se shqyrtimi i ligjshmërisë i garantuar nga neni 5 § 4 lidhur me vazhdimin e izolimit të detyrueshëm të një pacienti me çrregullim mendor duhet të bëhet në raport me gjendjen aktuale shëndetësore të pacientit, duke përfshirë rrezikshmërinë e tij ose të saj, ashtu siç provohet nga vlerësimet mjekësore të përditësuara, dhe jo duke u bazuar në ngjarje të kaluara që qëndrojnë në themel të vendimit fillestar për shtrimin e detyruar (*Juncal kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend. pran.), 2013, § 30; *Ruiz Rivera kundër Zvicrës*, 2014, § 60; *H.W. kundër Gjermanisë*, 2013, § 107).

266. Kërkesa për të përfunduar një periudhë prove, si kusht për lirim nga izolimi i detyrueshëm, mund të pengojë në parim të drejtën, e parashikuar në nenin 5 § 4, për të marrë një vendim gjyqësor që urdhëron përfundimin e izolimit nëse ka rezultuar i paligjshëm (*Denis dhe Irvine kundër Belgjikës* [DHM], 2021, § 194).

267. Fillimi i procedurave për të kundërshtuar ligjshmërinë sipas nenit 5 § 1 (f) të ndalimit administrativ në pritje të dëbimeve nuk është e nevojshme të ketë efekt pezullues në zbatimin e urdhrat të dëbimit. Një kusht i tillë, në mënyrë paradoksale, do të çonte në zgjatjen e vetë situatës së

cilës i ndaluar i kërkon t'i japë fund, duke kundërshtuar ndalimin administrativ. (*A.M. kundër Francës*, 2016, § 38).

268. Neni 5 § 4 nuk i detyron gjykatat që shqyrtojnë një ankim kundër paraburgimit që të trajtojnë çdo argument që përmban parashtrimi i ankuesit. Megjithatë, gjykata nuk mund të trajtojë si të parëndësishme, apo të mos marrë parasysh, faktet konkrete të paraqitura nga i paraburgosuri dhe që mund të vënë në dyshim ekzistencën e kushteve thelbësore të "ligjshmërisë" së privimit të lirisë, sipas kuptimit të Konventës (*Ilijkov kundër Bullgarisë*, 2001, § 94).

Nëse gjykata nuk jep arsye të përshtatshme, ose jep vendime të përsëritura dhe stereotipe që nuk japin përgjigje për argumentet e kërkuarit, kjo mund të rezultojë në shkelje duke e privuar garancinë nga thelbi i saj në kuptim të nenit 5 § 4 (*G.B. dhe të tjerë kundër Turqisë*, 2019, § 176).

269. "Gjykata" duhet të ketë kompetencën të urdhërojë lirim nëse gjen se paraburgimi është i paligjshëm; kompetenca e thjeshtë për të dhënë rekomandime nuk është e mjaftueshme (*Benjamin dhe Wilson kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2002, §§ 33-34; *Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 2016, § 128).

270. Procedurat sipas nenit 5 § 4 jo domosdoshmërisht duhet të rezultojnë në lirim, por mund të çojnë edhe në një formë tjetër privimi. Kur paraburgimi i një individi mbulohet nga të dy nënparagrafët (a) dhe (e) të nenit 5 § 1, do të ishte në kundërshtim me objektin dhe qëllimin e nenit 5 që paragrafi 4 i dispozitës të interpretohej sikur e bën izolimin në institucion shëndetësor për shëndetin mendor të imunizuar nga shqyrtimi i ligjshmërisë së tij vetëm sepse vendimi i parë që ka urdhëruar izolimin është marrë nga një gjykatë në bazë të nenit 5 § 1(a). Arsyeja për garantimin e një kontrolli sipas nenit 5 § 4 është po aq e rëndësishme për personat e mbyllur në një institucion të shëndetit mendor pavarësisht nëse ata po vuanin apo jo, paralelisht, një dënim me burgim (*Kuttner kundër Austrisë*, 2015, § 31, ku kërkesa e kërkuarit për heqjen e masës së izolimit në një institucion të shëndetit mendor mund të çonte vetëm në transferimin e tij në një burg të zakonshëm).

4. Garanci procedurale

271. Kërkesa për drejtësi procedurale që rrjedh nga neni 5 § 4 nuk dikton zbatimin e një standardi uniform e të pandryshueshëm, të pavarur nga konteksti, nga faktet dhe nga rrethanat e çështjes. Ndonëse procedura sipas nenit 5 § 4 nuk duhet të shoqërohet gjithmonë me garanci të njëjta si ato që kërkon neni 6 për mosmarrëveshjet penale ose civile, ajo duhet të ketë një karakter gjyqësor dhe të ofrojë garanci të përshtatshme sipas llojit përkatës të privimit nga liria (*A. dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2009, § 203; *Idalov kundër Rusisë* [DHM], 2012, § 161).

272. Në rastin e një personi paraburgimi i të cilit hyn në fushën e zbatimit të nenit 5 § 1 (c), nevojitet një seancë gjyqësore (*Nikolova kundër Bullgarisë* [DHM], 1999, § 58). Mundësia e një të privuari nga liria për t'u dëgjuar vetë personalisht ose nëpërmjet një forme përfaqësimi është ndër garancitë themelore procedurale që zbatohen në fushën e privimit nga liria (*Kampanis kundër Greqisë*, 1995, § 47).

Megjithatë, neni 5 § 4 nuk kërkon që një person i paraburgosur të dëgjohet sa herë që paraqet një ankim kundër vendimit që zgjat paraburgimin e tij, por duhet të jetë e mundur të ushtrojë të drejtën për t'u dëgjuar në intervale të arsyeshme (*Çatal kundër Turqisë*, 2012, § 33; *Altınok kundër Turqisë*, 2011, § 45).

273. Një seancë gjyqësore me gojë kërkohet gjithashtu në kontekstin e një procesi kundërshtar që përfshin përfaqësimin ligjor dhe mundësinë e thirrjes dhe pyetjes së dëshmitarëve, ku autoritetet gjyqësore thirren për të analizuar personalitetin dhe nivelin e pjekurisë së personit të paraburgosur në mënyrë që të vendosin rreth rrezikshmërisë së tij. Megjithatë, seanca gjyqësore nuk është thelbësore në të gjitha rrethanat, veçanërisht kur nuk ka gjasa të rezultojë në ndonjë sqarim shtesë (*Derungs kundër Zvicrës*, 2016, §§ 72 dhe 75, ku një person i mbajtur në paraburgim parandalues për

arsye psikiatrike nuk kishte dhënë asnjë informacion ose provë relevante në lidhje me personalitetin e tij që nga seanca e mëparshme që ta bënte të domosdoshme një seancë të re gjyqësore).

274. Fakti që një kërkues nuk mund të dëgjohej, personalisht ose me anë të telekonferencës ose videokonferencës, mbi ligjshmërinë e izolimit të tij nga imigracioni për shkak të problemeve fillestare të infrastrukturës që lidhen me pandeminë Covid-19, është gjetur se është në përputhje me nenin 5 § 4, duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm të shëndetit publik dhe faktin që kërkuesi ishte përfaqësuar dhe dëgjuar përmes avokatit të tij (*Bah kundër Holandës* (vend. pran.), 2021, §§ 40-45).

275. Si rregull i përgjithshëm, neni 5 § 4 nuk kërkon që seanca gjyqësore të jetë publike. Megjithatë, Gjykata nuk e ka përjashtuar mundësinë që në rrethana të veçanta të mund të kërkohej edhe seancë publike (*D.C. kundër Belgjikës*, 2021, §§ 125-126).

276. Procedurat duhet të jenë kundërshtare dhe gjithmonë duhet të garantojnë "barazinë e armëve" ndërmjet palëve (*Reinprecht kundër Austrisë*, 2005, § 31; *A. dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2009, § 204). Në rastet e paraburgimit, meqë vazhdimësia e dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari ka kryer një vepër penale është kusht *sine qua non* për ligjshmërinë e vazhdimësisë së paraburgimit, personit të paraburgosur duhet t'i jepet mundësia që të kundërshtojë në mënyrë të efektshme bazën e akuzave kundër tij. Kjo mund të kërkojë që gjykata të dëgjojë ata dëshmitarë dëshmia e të cilëve duket se mund të ndikojë në ligjshmërinë e vazhdimësisë së paraburgimit (*Turcan kundër Moldavisë*, 2007, §§ 67-70).

Barazia e armëve nuk sigurohet nëse kërkuesit ose mbrojtësit të tij i mohohet akses në ato dokumente të fashikullit të hetimeve të cilat janë thelbësore për të kundërshtuar në mënyrë efektive ligjshmërinë e paraburgimit (*Selahattin Demirtaş kundër Turqisë* (nr. 4), 2025, §§ 281-283; *Ragıp Zarakolu kundër Turqisë*, 2020, §§ 59-61; *Ovsjannikov kundër Estonisë*, 2014, § 72; *Fodale kundër Italisë*, 2006, § 41; dhe *Korneykova kundër Ukrainës*, 2012, § 68). Edhe kur të paraburgosurit nuk i është dhënë akses i pakufizuar në fashikullin e hetimeve, është gjetur se neni 5 § 4 është respektuar kur i paraburgosuri ka pasur njohuri të mjaftueshme për përmbajtjen e atyre provave që përbënin bazën për paraburgimin e tij dhe kështu ka pasur një mundësi për të kundërshtuar në mënyrë efektive paraburgimin e tij (*Atilla Taş kundër Turqisë*, 2021, §§ 151-154, me referenca të mëtejshme).

Mund të jetë gjithashtu thelbësore që personi në fjalë jo vetëm të ketë mundësinë të dëgjohej personalisht, por edhe t'i ofrohet ndihma efektive nga avokati i tij. (*Cernák kundër Sllovakisë*, 2013, § 78).

277. Një element kyç i së drejtës së personit për ndihmë efektive nga një avokat është konfidencialiteti i informacionit të shkëmbyer mes tyre. Ndërsa Gjykata ka toleruar disa kufizime të vendosura në kontaktet avokat-klient në rastet e terrorizmit dhe krimin të organizuar, shmangiet nga parimi themelor i respektimit të konfidencialitetit avokat-klient mund të lejohen vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe duhet të shoqërohen me mbrojtje të përshtatshme dhe të mjaftueshme kundër abuzimit (*Demirtaş dhe Yüksekdağ Şenoğlu kundër Turqisë*, 2023, §§ 104-106, ku kërkuesit u privuan nga ndihma efektive ligjore për të ankumuar paraburgimin e tyre për shkak të mbikëqyrjes nga autoritetet e burgut të takimeve me avokatët e tyre dhe sekuestrimit të dokumenteve të shkëmbyera mes tyre).

278. Duke qenë se procedurat lidhur me paraburgimin kërkojnë shpejtësi të veçantë, një gjyqtar mund të vendosë të mos presë derisa një i paraburgosur të përfitojë nga ndihma ligjore, dhe autoritetet nuk janë të detyruara t'i ofrojnë atij ndihmë ligjore falas në kontekstin e procedurës të paraburgimit (*Karachentsev kundër Ruisë*, 2018, § 62).

279. Parimi i procedurave kundërshtare dhe barazisë së armëve duhet të respektohet në mënyrë të barabartë në procedurat para gjykatës së apelit (*Çatal kundër Turqisë*, 2012, §§ 33-34 dhe çështjet e përmendura aty), si dhe në procedurat që Shtetet Kontraktuese, sipas zgjedhjes, u vënë në dispozicion personave të paraburgosur pas dënimit (*Stollenwerk kundër Gjermanisë*, 2017, § 44; *Yılmaz Aydemir kundër Turqisë*, 2023, §§ 42-45).

280. E drejta për procedura kundërshtare do të thotë që palët, në parim, kanë të drejtë të informohen dhe të diskutojnë për çdo dokument ose parashtrim të paraqitur në gjykatë me qëllim ndikimin në vendimin e saj, edhe nëse ai vjen nga një nëpunës ligjor i pavarur (*Venet kundër Belgjikës*, 2019, §§ 42-43, ku kërkuesi nuk ishte në gjendje t'u përgjigjej parashtrimeve me gojë të prokurorit të përgjithshëm në Gjykatën Belge të Kasacionit).

281. E drejta për procedura kundërshtare i njeh domosdoshmërisht të paraburgosurit dhe avokatit të tij të drejtën të informohen brenda një afati të arsyeshëm për datën e caktimit të një seance gjyqësore, pa të cilën e drejta do të ishte e zbrazur nga thelbi i saj (*ibid.*, § 45).

282. Terrorizmi përfshihet në një kategori të veçantë. Neni 5 § 4 nuk përjashton përdorimin e një seance të mbyllur gjyqësore, ku burime konfidenciale informacioni që mbështesin linjën hetimore të autoriteteve i paraqiten gjykatës në mungesë të të paraburgosurit ose avokatit të tij. Ajo që është e rëndësishme është që autoritetet të zbulojnë informacion të mjaftueshëm për t'i mundësuar një të paraburgosuri të njohë natyrën e akuzave kundër tij dhe të ketë mundësinë t'i hedhë poshtë ato, si dhe të marrë pjesë në mënyrë efektive në procedurat që kanë të bëjnë me vazhdimësinë e paraburgimit të tij (*Sher dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2015, § 149, ku Gjykata pranoi se kërcënimet i një sulmi të mundshëm terrorist justifikonte kufizimet mbi natyrën kundërshtare të procedurave që kishin të bënin me urdhrat për vazhdimësinë e paraburgimit për arsye të sigurisë kombëtare. Shih edhe *Al Husin kundër Bosnjë Hercegovinës (nr. 2)*, 2019, §§ 120-122, ku kërkuesit i ishte dhënë një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e tij, pavarësisht kufizimeve të aksesit të tij në provat që lidheshin me sigurinë kombëtare).

5. Kërkesa për “shpejtësi”

283. Duke u garantuar të paraburgosurve të drejtën për të filluar procedura për kundërshtimin e ligjshmërisë së paraburgimit të tyre, neni 5 § 4 shpall gjithashtu të drejtën e tyre që, pasi të ketë filluar procedura, të marrin pa vonesë një vendim gjyqësor lidhur me ligjshmërinë e paraburgimit të tyre dhe urdhërimin e përfundimit të tij nëse rezulton se është i paligjshëm (*Idalov kundër Ruisë* [DHM], 2012, § 154; *Baranowski kundër Polonisë*, 2007, § 68). Çështja nëse është respektuar e drejta për një vendim pa vonesë duhet të përcaktohet nën dritën e rrethanave të çdo rasti (*Ilseher kundër Gjermanisë* [DHM], 2018, § 252; *Rehbock kundër Sllovenisë*, 2000, § 84).

284. Mundësia për shqyrtim juridik duhet të ofrohet menjëherë pasi personi është marrë në paraburgim dhe, nëse është e nevojshme më pas, në intervale të arsyeshme (*Molotchko kundër Ukrainës*, 2012, § 148).

285. Nocioni 'pa vonesë' (“à bref délai” në frëngjisht) tregon urgjencë më të vogël se fjala "menjëherë" (*menjëherë*’ (*ausstôt / promptly*) e parashikuar në nenin 5 § 3 (*E. kundër Norvegjisë*, 1990, § 64; *Brogan dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1988, § 59).

Megjithatë, nëse vendimi që urdhëron paraburgimin e një personi është dhënë nga një autoritet jo-gjyqësor e jo nga gjykata, kriteri i “shpejtësisë” së kontrollit gjyqësor në kuptimin e nenit 5 § 4 afrohet më shumë me kriterin e “menjëhershëmërisë” në kuptimin e nenit 5 § 3 (*Shcherbina kundër Ruisë*, 2014, §§ 65-70, ku vonesa prej gjashtëmbëdhjetë ditësh në kontrollin gjyqësor e urdhrat të ndalimit të kërkuesit të dhënë nga prokurori u gjet e tepërt).

286. Standardi i “shpejtësisë” është më pak i rreptë kur bëhet fjalë për procedura përpara gjykatës së apelit (*Abdulkanov kundër Ruisë*, 2012, § 198). Kur vendimi fillestar i paraburgimit është dhënë nga një gjykatë në një proces që ofron garancitë e përshtatshme të procesit të rregullt ligjor, Gjykata është e përgatitur të tolerojë periudha më të gjata shqyrtimi në gjykatat e shkallës së dytë (*Ilseher kundër Gjermanisë* [DHM], 2018, § 255; *Shcherbina kundër Ruisë*, 2014, § 65). Këto konsiderata zbatohen aq më tepër për ankimet në lidhje me procedurat përpara gjykatave kushtetuese, të cilat janë të ndara nga procedimet në gjykatat e zakonshme (*Mehmet Hasan Altan kundër Turqisë*, 2018, § 163; *Ilseher kundër Gjermanisë* [DHM], 2018, § 274). Procedurat në gjykatat më të larta kanë të bëjnë më pak me

arbitraritetin, por ofrojnë garanci shtesë bazuar kryesisht në një vlerësim të përshtatshmërisë së vazhdimësisë së paraburgimit (*Mehmet Hasan Altan kundër Turqisë*, 2018, § 165). Pavarësisht kësaj, gjykatat kushtetuese janë njëloj të detyruara për të respektuar kërkesën e shpejtësisë sipas nenit 5 § 4 (*G.B. dhe të tjerë kundër Turqisë*, 2019, § 184; *Kavala kundër Turqisë*, 2019, § 184).

287. Megjithatë, në parim, duke qenë se liria e individit është në rrezik, Shteti duhet të sigurohet që procedurat të kryhen sa më shpejt që të jetë e mundur (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 2016, § 131).

a. Periudha që duhet të merret në konsideratë

288. Gjykata ka marrë si pikënisje çastin kur është paraqitur kërkesa për lirim ose kur kanë filluar procedimet. Periudha relevante që duhet të llogaritet merr fund në çastin kur është vendosur përfundimisht ligjshmëria e paraburgimit të kërkuarit, duke përfshirë në të edhe procedurën në apel (*Sanchez-Reisse kundër Zvicrës*, 1986, § 54; *E. kundër Gjermanisë*, 1990, § 64).

289. Në qoftë se duhet të shterohet një mjet juridik administrativ përpara se të mund të veprohet në rrugë gjyqësore, afati fillon të rrjedhë që nga data kur çështja i është paraqitur autoritetit administrativ (*Sanchez-Reisse kundër Zvicrës*, 1986, § 54).

290. Nëse procedurat janë zhvilluar në dy shkallë juridiksioni, duhet të bëhet një vlerësim i tërësishëm për të vendosur nëse është respektuar kërkesa e "shpejtësisë" (*Hutchison Reid kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2003, § 78; *Navarra kundër Francës*, 1993, § 28).

b. Elemente të rëndësishme që duhet të merren parasysh në vlerësimin e shpejtësisë

291. Shprehja "brenda një afati të shkurtër" nuk mund të përkufizohet në mënyrë abstrakte. Ashtu si edhe për kërkesën për "afat të arsyeshëm" që përcakton neni 5 § 3 dhe 6, duhet të vendoset duke pasur parasysh rrethanat e çdo rasti (*R.M.D. kundër Zvicrës*, 1997, § 42).

292. Për të bërë këtë vlerësim, rrethanat që duhet të merren parasysh përfshijnë kompleksitetin e procedimeve, zhvillimin e tyre nga autoritetet e brendshme dhe nga kërkuari, çfarë ishte në rrezik për këtë të fundit (*Ilseher kundër Gjermanisë* [DHM], 2018, § 252; *Mooren kundër Gjermanisë* [DHM], 2009, § 106; *Mehmet Hasan Altan kundër Turqisë*, 2018, § 162) dhe çdo veçori të procedurës vendase (*Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 2016, § 131; *Mehmet Hasan Altan kundër Turqisë*, 2018, § 163, dhe *Ilseher kundër Gjermanisë* [DHM], 2018, §§ 270-271 në lidhje me procedurat përpara gjykatave kushtetuese).

293. Në qoftë se, për çështjet që kanë të bëjnë me nenin 6 § 1, mund të mendohet se një kohëzgjatje njëvjeçare për çdo shkallë juridiksioni mund të shërbejë si normë e përafërt, për nenin 5 § 4, i cili ka të bëjë me çështje të lirisë, kërkohet shpejtësi e veçantë (*Panchenko kundër Rusisë*, 2005, § 117). Kur është në diskutim liria personale e një personi, Gjykata ka standarde shumë të rrepta në lidhje me respektimin nga Shteti të kërkesës për shqyrtim gjyqësor pa vonesë të ligjshmërisë së paraburgimit (shih, për shembull, *Kadem kundër Maltës*, 2003, §§ 44-45, ku Gjykata ka vlerësuar si të tepërt një afat prej shtatëmbëdhjetë ditësh për të vendosur në lidhje me ligjshmërinë e paraburgimit të kërkuarit, dhe *Mamedova kundër Rusisë* 2006, § 96, ku kohëzgjatja e procedurave të apelit, ndër të tjera prej njëzet e gjashtë ditësh, u gjentë kundërshtim me kërkesën "e shpejtësisë").

Është detyrë e Shtetit të paditur të krijojë procedurat e brendshme më të përshtatshme për të përmbushur detyrimet e tij sipas nenit 5 § 4 të Konventës (*Dimo Dimov dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, 2020, § 80, ku transferimi i dosjes hetimore në gjykatën kompetente në një qytet tjetër rezultoi në një vonesë prej njëzet e pesë ditësh në shqyrtimin e kërkesës së kërkuarit për lirim).

